

Revistë edukative-kulturore

ETIKA


Nëntor 2010 • Numri: 32 • E përmuajshme

Shqipëri: 150 Lek

Kosovë: 1 Euro

Maqedoni: 60 Den

Europa: 2 Euro



Haxhi
Ideal

EDITORIAL


O

ju njerëz! Dëgjoni çka do t'ju them.

O ju njerëz! Frikësojuni Allahut dhe respektojeni Atë. Bëhuni të njerëzishëm dhe të drejtë ndaj vetes suaj e ndaj të tjerëve. Kjo është dita e flijimeve në emër të Allahut. Me të vërtetë gjaku juaj, pasuria juaj janë të shenjta për ju, deri në kohën kur të takoheni me Krijuesin tuaj, ashtu siç është e shenjta kjo ditë, në këtë muaj dhe në këtë vend.

- Ruani, respektoni dhe nderoni vlerën e personalitetit njerëzor.
- Njeriu është vepër madhështore e Allahut dhe vajmedet për atë që përqmon nderin dhe dinjitetin e veprës së Allahut.
- Ju o njerëz, do t'i ktheheni në mënyrë të pashmangshime Allahut të Amshueshëm dhe Ai do t'ju thërrasë në përgjegjësi për veprat e për punën tuaj.
- O besimdrejtë! Ta dini, ta mbani në mend dhe të jeni të bindur se ka përfunduar koha e mosdijes dhe e traditave të këqia, të cilat i kanë sjellë aq fatkeqësi gjinisë njerëzore. Unë ju kam treguar rrugën e shpëtimit në të cilën duhet ecur.
- Gjërat që ju janë lënë amanet, ruajini si të ishin tuajat dhe kthejani besnikërisht dhe në kohën e duhur atij të cilit i përkasin.
- Gjakmarrja është e ndaluar, të gjitha akuzat, të cilat rrjedhin nga koha para ardhjes së Islamit anullohen. Dhe e para qjë e këtillë që anulohet është gjakmarrja e ungjit tim Amir B. Rebi'b Harith B. Abdulmut-talib, të cilin njerëz nga fisi Hudhej e mbytën të pafajshëm. Le të harrohet kjo gjakmarrje dhe le të falen të gjitha të tjerat në të ardhmen.
- Fajdeja dhe kamata janë të ndaluara. Huadhiënësi duhet të marrë nga huamarrësi vetëm atë që ia ka huazuar. Huatë e para që i nënshtronë këtij vendimi janë ato të ungjit tim Abbasit, i cili ka pasur mjafit borxhlinj.
- O ju besimdrejtë! Faljani kamaten borxhlinjve. Dëgjoni këshillën time dhe pasuria juaj do të shtohet, sepse ju mbetet kryeqjëja për tregti dhe punë të ndershme.
- Nëse nuk e bëni këtë, dijeni se e keni zemëruar rëndë Allahun dhe të Dërguarin e Tij.

Do të lexoni:



Ahmet Tashgetiren / 4

Mr. Zymer Ramadani / 8

/ 10

Mr. Abdulkadër Durguti / 12

Ismail Lutfi Çakan / 14

Hasan Kamil Jëllmaz / 16

Fatmir Hadri / 18

Nexhat Ibrahim / 20

/ 24

Rrustem Spahiu / 26

Ymeti që kërkon koha

Haxhi udhëtim
drejt arteve hyjnore

Hutbeja e lamtumirës së
Muhamedit (a.s.) në Arafat

Qëndrimi i Ademit (a.s.)
ndaj mëkatit

Xhihadi pa luftë Haxhi

Keutheri dhe kurbani

Të jesh njeri modest

Shëmbëlltyra dhe mësimet e
Ibrahimit (a.s.)

Këshilla të arta
nga Kurani Famëlartë

Konflikti dhe dialogu
ndërkulturor

Ahmet Tashgetiren /


Ymeti që kërkon koha



4

Ismail Lutfi Çakan /

Xhihadi pa luftë Haxhi



14

Nexhat Ibrahim /

Shëmbëlltyra dhe mësimet e Ibrahimit (a.s.)



20

Viti: V | Numri: 32 | Nëntor 2010

Administrator i Progresi botime:

Shuaip Bashhan

bashan43@hotmail.com
+355 69 20 76768

Drejtë & Kryeredaktor:

Alban Kali

albankali@yahoo.com
+355 69 24 23989

Përkthyesit:

Alban Kali / Elvira Puka

Elona Sytari / Evans Drishti

Fatmir Sulaj / Ilir Hoxha / Tasim Darsi

Redaktor letrar:

Shpëtim Kelmendi

Redaktor gjuhësor:

Ma. Irida Hoti

Dizajn - Grafik:

Bledar Xama

bledar_xama@hotmail.com

Për artikuj

e-mail: revistaetika@progresibotime.com

e-mail: kosova@progresibotime.com

e-mail: maqedoni@progresibotime.com

Nëntor 2010

32

Osman Nuri Topbash /
Haxhi Ideal



40

Mr. sci. Flamur Sofiu /
Haxhi në prizmin e jurisprudencës Islame



44

Imam Naim Drijaj /
Kurban Bajrami



/28

Parabola sufi:
Gostari dhe mysafirët
Bajazidi dhe egoisti

/30

Një Ajet - Një Hadith
Haxhi Ideal

Osman Nuri Topbash /32

Mr. sci. Flamur Sofiu /40

/48

Imam Naim Drijaj / 44

Mr. Artur Tagani / 46

Haxhi në prizmin e
jurisprudencës Islame

Hutbe të zgjedhura

Shkencat e fizikës

Enciklopedi Islame
Koncepti i zemrës

Mehmet Ali Pasha

Një shtet i vogël

Cilat ushqime me cilat ilaçë
janë të dëmshme

Udhëtimi në Mars për 39 ditë

PE votoi rezolutën

për heqjen e vizave

Mag. Ermal Nurja / 51

Familja / 54

Shëndeti / 56

Teknologji / 58

Aktualitet / 59

Adresa:

L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi
Shkodër / Albania
Tel: +355 22 254 634
Fax: +355 22 254 633

Zyra e përfaqësimit Maqedoni

Rr. Shtëpia Naumov / nr. 9 / lokal 25
Shkup / Maqedoni
+389 71 956 271

Zyra e përfaqësimit Kosovë:

Rr. Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin
Prizren / Kosovë
Tel: +381 29 222 795
Fax: +381 29 222 797
+377 441 63 651

Çmimi:

Shqipëri: 150 Lekë

Abonim (një vjetor): 1500 Lekë

Kosovë: 1 Euro

Abonim (një vjetor): 10 Euro

Maqedoni: 60 DEN

Abonim (një vjetor): 720 DEN

Europë: 2 Euro

Abonim (një vjetor): 24 Euro



Ç'YMETI QË KËRKON KOHA

Ahmet Tashgetiren

Në gjithë treguesit e robërisë, duke filluar që nga namazi e deri tek haxhi, barazia si “robër” të Zotit dhe vëllazërimi i formuar mbi bazën e kësaj barazie shfaqet mjaft qartë në të qenit një ymet. Viti 1408 Hixhri... Jemi në Arafat... Në ditën e nëntë të Dhulhixhes, i Dërguari i Allahut i flet gjithë njerëzimit, duke qenë në krye të Xhebel-i Rrahme, hipur mbi devenë Kusva.

O Njerëz!

E dini se ç'ditë është sot? Sot është dita e Kurbanit. A e dini se në cilin muaj jemi? Ky është muaji i bekuar. A e dini se cili vend është ky? Këtu është qyteti i bekuar. Ashtu sikurse kjo ditë është e shenjtë, ashtu sikurse ky muaj është i shenjtë, ashtu sikurse ky qytet është i shenjtë, dijeni se edhe shpirti juaj, pasuria dhe nderi juaj, janë të shenjta sikurse kjo ditë, ky muaj dhe ky qytet, deri në ditën e gjykimit. Çdo lloj keqtrajtimi ndaj tyre është haram.

Miqtë e mi! Mblidheni veten. Dijeni që nesër do të dilni para Allahut dhe do pyeten patjetër për çdo vepër të ndërmarrë.

Ta dini që unë do shkoj më parë dhe do ju pres atje. Unë do të krenohem me shumicën tuaj para grupimeve të tjera. Kini kujdes dhe mos bëni gjynahe, që të mos manxini fytyrën. Kini kujdes dhe mos devijoni rrugën pas

meje duke u zënë me njëri-tjetrin!

Këto këshilla që po u jap sot, ata që ndodhen këtu t'ua transmetojnë atyre që nuk ndodhen. Mundet që të dalë dikush prej atyre që nuk kanë qenë këtu dhe t'i vëre në zbatim më mirë.

Miqtë e mi!

Të gjitha gjakmarrjet e mbeturë që nga koha e injorancës janë hequr. Gjakmarrja e parë që kam pezulluar është “gjakmarrja e Rabias, mbesës së Abdulhamitit”.

Ç'YMET JEMI NE?

E dëgjojmë të Dërguarin e Allahut dhe më pas nisim të kacafytemi. Para tij sillemi sikur nuk e kemi dëgjuar asnjëherë zérin e Tij... Thuaçse nuk e kemi kuptuar aspak këshillën e Tij gjithpërfshirëse për shekuj të tërë... Ai na thotë: - Nesër do takoheni me Allahun, ndërsa ne kacafytemi me njëri-tjetrin. Ç'ymet jemi ne? Ai na thotë: - Unë do ju pres tek vendi. Unë do krenohem me shumicën tuaj, me bukurinë tuaj. Ai thotë: - Mos devijoni rrugën e drejtë dhe mos u kapni me njëri-tjetrin. Ndërsa ne derdhim gjakun e njëri-tjetrit. Ç'ymet jemi ne?

Si do dalim para Zotit? Si të mos na skuqet fytyra kur të takohemi me të Dërguarin e Allahut në Kevser? Si do japim llogari për gjakderdhjen në qytetin e sigurtë? Si do

japim llogari pér kacafytjen e qindra mijëra myslimanëve në vendet Islame?

I Dërguari i Allahut e tha këtë ligjëratë në Hutben e Lamtumirës, të cilën e bëri në vitin 10 Hixhri. Ka plot 1399 vite që ai na flet me këtë hutbe. Çdo vit i këshillon besimtarët e mbledhur në Arafat, duke u thënë: Këtë këshillë, ata që janë këtu t'ua transmetojnë atyre që nuk ndodhen këtu. Ne e dëgjojmë këtë këshillë pér 1399 vite me radhë. Dhe nga ana tjetër derdhim gjakun e njëri-tjetrit. Ç'ymet jemi ne?


SIKURSE ZËNKAT E KOHËS SË INJORANCËS

I Dërguari i Allahut pati emigruar në Medinë. Ndërkohë që nga njëra anë vëllazëroi Muhammed me Ensarët, nga ana tjetër theu akullin shekullor mes dy fiseve të rëndësishme të Ensarëve, Evs dhe Hazrekh. Evs dhe Hazrekh i harruan luftrat mes tyre, të njohura si Jevm-i Buas e që transmetohet se kanë zgjatur pér rreth 120 vite me radhë, dhe u mblodhën tek i Dërguari i Allahut duke u bërë vëllezër.

Një situatë e tillë i shqetëson jashtë mase Jahuditë e Medinës. Një jahudi i njohur me emrin Semmas bin Kajs, i cili një ditë kaloi në vendin ku mblidheshin pér biseda të rinjtë Evs dhe Hazrekh, shqetësohet me të vënë re bisedën aq miqësore të sahabeve të Profetit. I drejtohet një të riu jahudi që ndodhej aty pranë, duke i thënë: Ulu aty pranë, kujto Jevm-i Buas dhe ditët e mëparshme. Lexo poezi heroizmi që i pate thënë atëherë. S'mund të jemi të qetë pér sa kohë që këta mblidhen në këtë mënyrë.

Djaloshi jahudi ulet pranë të rinjve myslimanë. Më pas e vërtit bisedën në lidhje me luftrat e Ditëve Buas. Lexon poezi që përkujtonin heroizmat e të rinjve Evs dhe Hazrekh. Pas kësaj, të rinjtë Evs dhe Hazrekh nisin të mbështetnin heroizmat e kohës së injorancës, ndërsa pak më vonë debatet e tipit "ju jeni më të fortë, ne jemi më të fortë" përfundojnë deri në zënka. Evs bin Kajs nga grupi Evs dhe Hubar ibn Sahr nga Hazrekh nisin t'u flasin njëri-tjetrit: Nëse dëshironi, u kthehem sërisht atyre ditëve. Për këtë situatë njoftohet Pejgamberi (a.s.). I Dërguari i Allahut shqetësohet pa masë, kështu që së bashku me një pari të Ensarëve shkon tek ata dhe u thotë:

-O myslimanë! O Zot, O Zot! E gjykonit njëri-tjetrin me injorancë edhe tani që unë jam në mesin tuaj? Përsëri vijoni të mohoni, edhe pse Allahu u ka udhëzuar në Islam, ju ka shpëtuar nga kufri, edhe pasi Ai ia ka prerë rrënjet e injorancës dhe ju ka bërë të përqafoheni si vë-



llezër?

Pas fjalëve të të Dërguarit të Allahut, të vetëdijshëm pér "kurthin e shejtanit" në të cilin kishin rënë, të rinjtë Evs dhe Hazrekh u penduan dhe përqafuan njëri-tjetrin. Menjëherë pas kësaj ndodhie zbriti edhe ajeti i mëposhtëm i sures Al-i Imran:

O ju që besuat! Nëse ju i bindeni një grapi të atyre që iu është dhënë libri, ata pas besimit tuaj do t'ju kthejnë në mosbesimtarë. Si mundet të mos besoni kur po ju lexohen (po ju shpallen) ajetet e Allahut dhe kur në mesin tuaj gjendet i Dërguari i Tij? E kush i përbahet fesë së Allahut ai padashim është i udhëzuar në rrugën e drejtë.

O ju që besuat! Kini frikë Allahun me sinqueritet të vërtetë dhe mos vdisni përveç se duke qenë myslimanë. Dhe kapuni që të gjithë ju pér litarin (fenë dhe Kur'anin) e Allahut e mos u përcani. Përkujtojeni mirësinë e Allahut ndaj jush, kur ju (para se ta pranonit fenë Islam) ishit të armiqësuar, e Ai i bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntinë e Tij aguat të ishit vëllezër. Madje ishit në buzë të greminës së Xhehenemit e



Ai ju shpëtoi prej tij, Po kështu Allahu ua sqaron juve argumentet e veta që ju ta gjeni të vërtetën e lumtur.

VËLLAZËRIA, YMETI, HAXHI

Para këtyre ajeteve zënë vend ajete, të cilat nxjerrin në pah virtytet e Haxhit. Menjëherë më pas, vijnë ajete, të cilat i nxisin myslimanët të formojnë një ymet. I ndjeri Profesor Elmali Hamdi, në komentim të këtyre ajeteve thotë si vijon:

Për të qenë në rrugën e Allahut me plot bindje dhe për t'u ndarë nga kjo jetë si myslimanë, duhet të kapemi pas perit të Allahut, të mblidhemi në fjalën e Tevhudit dhe të mos përçahemi. Me sa kuptoher, detyrimi dhe obligimi i haxhit është edhe një shkak i këtij grumbullimi. Prandaj, Tevhidi i zemrave dhe tèresia e veprimitarive janë parimet më të mëdha të fesë së vërtetë. Të thuash që "Unë mund ta mbroj i vetëm fenë dhe besimin tim", është diçka e rrezikshme. Kush dëshiron të qëndrojë i vetëm, vështirë se mund të mbërrijë në një përfundim të suksesshëm mbi bazën e besimit dhe të Islamit. Individu mund të humbasë çdo gjë përpara vështirësive. Kjo sepse ndihma e Allahut është në xhematin (bashkësinë). Fryti më i madh i fesë në botë është ndikimi i këtij xhemati. Prandaj, ata që humbasin xhematin humbasin vetveten... Çdo besimtar është një shfaqje relative e së vërtetës, dhe vetë shfaqja e Zotit arrihet me nxjerrjen në pah të këtyre dukurive rela-

tive. Si përfundim, për sa kohë që të gjithë besimtarët nuk i mbledhin fuqitë dhe forcat e tyre në një fjalë të vetme, s'mund të arrijnë në devotshmërinë e vërtetë. S'mund të mbërrijnë tek Allahu.

Kështu, Allahu dhe i Dërguari i Tij e predikojnë vëllazërimin mes besimtarëve, haxhin dhe bashkimin e ymetit në të njëjtën kornizë. Çdo gjë që mund të bëhet penge-së e kësaj tèresie, është e papranueshme. Dallimet përsa i përket kombit, ngjyrës, fuqisë materiale, postit dhe prejardhjes, të cilat mund të pengojnë vëllazërimin Islam dhe tèresinë e ymetit, njihen si "**mbetje të injorancës**" dhe konceptohen si "**kthim në kufër pas besimit**". Pra të gjitha këto lloj ambicjesh, të cilat hijezojnë vëllazërinë universale të Islamit, janë një degëzim i injorancës në jetën tonë dhe të papranueshme për Islamin.

ROBËRIA DHE VËLLAZËRIMI

Islami ndërton një vëllazëri, burimi i së cilës është ideja e robërisë. Robëria është shprehje e një barazie të plotë, ashtu sikurse dhëmbëzat e një krehëri. Në momentin që jemi pjesë e radhës së kësaj robërie, nuk ka asnë kuptim as pushteti, as dija, as pasuria dhe as konsiderata e njerëzve. Nëse kemi të bëjmë me pasuri, ajo i përket vetëm Allahut, po kështu është edhe për dijen dhe konsideraten e njerëzve. Pastaj, a mund të bëhet fjalë përfuqinë e "robit" përballë pasurisë, dijes, fuqisë së Allahut? Në të gjithë treguesit e robërisë, duke filluar që nga namazi e deri tek haxhi, barazia si "robër" të Zotit dhe vëllazërimi i formuar mbi bazën e kësaj barazie shfaqet mjaft qartë në qenien tonë një ymet. Në çastin kur njeriu lidhet në namaz dhe del para Allahut, çdo lloj dallimi i kësaj bote mbetet jashtë. E njëjtë gjë është edhe kur ngelemi pa ngrënë. Kur ndan nga pasuria jote qoftë edhe një gram për hir të Allahut, ky është tregues i vetëdijes së asaj që ndahet. Thuajse i ka vënë syrin një pasurie të caktuar të Allahut dhe Allahu një pjesë të asaj pasurie dëshiron ta shpenzojë përf diçka tjetër. Ai mund të kërkojë edhe më shumë se aq. Ashtu sikurse thotë: "Sakrifiko edhe shpirtin në rrugë të Allahut", kur të nevojitet... A mund të bëhet fjalë përf dallim pasurie, pushteti, fame apo racizmi në xhihad? Kemi të bëjmë vetëm me robëri, dhe aty të gjithë janë të barabartë. Haxhi është fryt i robërisë, që qëndis në shpirtin e besimtarit këtë vëllazëri e barazi, këtë vizion universal të robërisë. Ti je njeri, ti je rob. Ku është dallimi? Tani je para Allahut dhe nuk ke asgjë tjetër me vete përveç devotshmërisë. Nëse je në gjendje t'i shmangesh kësaj robërie, vazhdo. Nëse jo, atëherë bindju parimeve

të saj. Ku është pushteti yt, pasuria, bukuria, ku janë shërbyesit e tu? Ku është fisi dhe rrethi yt?... Je para Allahut dhe e vëtmja pasuri është devotshmëria. Nëse je i vetë-dijshëm për këtë, nuk ka nevojë për zënka. Çfarë nuk po arrin të ndash? Mos vallë mëshirën e Allahut? Për çfarë e ke fjalën? Nëse Allahu të ka bërë vëlla me atë që të qëndron mbi krye, a ka mirësi më të madhe se kjo? Domethinë Allahu të ka respektuar.

Do ishe i lumtur nëse do mund ta ndaje këtë mirësi... dhe vetëm atëherë bëhesh ymet. Bëhesh një “yмет i dobi-shëm”, siç e ka përcaktuar vetë Allahu, një ymet që ngrihet në këmbë, që ringjallet, i drejtë, që ulet në sexhde netëve, që lexon ajetet e Allahut, që garon në mirësi, që urdhëron të mirën dhe ndalon të keqen. Atëherë bëhesh i fuqishëm. Shihni si e shpejgon “yметin”, i ndjeri Elmalit:


Fjala ymet është shumësi i fjalës imam dhe ka kuptimin e një bashkësie që u bindet shoqërive njerëzore dhe shkon pas tyre. Pra, kemi të bëjmë me një grupim social, i cili në prirje të një imami mblidhen në një unifikim të fuqishëm, duke vënë në jetë zbulimet e mrekullueshme, duke mbikëqyrur gjatë këtij procesi klasa të ndryshme dhe grupime njerëzish. Thënë ndryshe, ymeti është xhemati që mbart prijësin e madh. Krahasuar me xhematin, ymeti është sikurse imami krahasuar me individët, gjë që do të thotë se ymeti është një grupim social i përbërë nga njerëz më cilësi të mira të përbashkëta.

NË VETËDIJE TË YMETIT

Kurani kërkon të formojmë një ymet të përcaktuar në këtë drejtim. “**Grupime njerëzish që u binden grupimeve të njerëzve dhe që shkojnë pas tyre**”, pra grupime njerëzish që drejtojnë kohën. Një “**popull mbizotëruesh...**”. Këtë do e formojnë besimtarët... Ky do jetë një grupim besimtarësh që i ngjajnë një muri të fortë të lidhur fort me njëri-tjetrin... Ky do të jetë ymeti Islam...

Ky ymet do ndërtohet me namaze, zeqate, haxhe... Do ndërtohet mbi bazën e vetëdijes së robërisë... Individët, grupet, shoqëritë dhe fiset që formojnë ymetin do veprojnë të vetëdijshëm si robër të Allahut dhe dojenë vellezër me grupimet e tjera që formojnë të njëjtin ymet.

A i vëmë re pushtetin dhe pozitën e njerëzve me të cilët falemi dhe rreshtohemi në një rresht? A ndikon negativisht në ndjenjat tonë ngjyra e njeriut të veshur me të bardha në Haxh? Ndërkohë që gjithë së bashku themi “lebejk Allahumme: Lebbejk”, ndërkohë që i jemi bindur urdhërit të Allahut dhe i jemi falur mëshirës së Tij, a mund të shfa-



qim shenja xhelozie a smire ndaj një besimtarë tjetër, apo edhe t'i shkelim këmbët? Dhe pikërisht aty, në atë Arafat, aty ku miliona njerëz mblidhen në një zë të vetëm, besimtarët mblidhen me njëri-tjetrin duke lindur si një fuqi dhe si ymet i vetëm. Të gjithë të pranishëm nga Sejlani, Eritre, Romë, të bardhë, të verdhë... Arabë, Axhemë dhe Turq... të varfër e të pasur... padronë apo punëtorë... kryetarë shteti apo njerëz të thjeshtë... japin e marrin nga njëri-tjetri vetëm dashuri. Edhe vetë i Dërguari i Allahut, në këtë mënyrë e ka ndërtuar ymetin e Tij. Edhe ymeti i Tij ka qenë si një trup i vetëm, të bardhë e të zinj, arabë e jo arabë. Ky ymet e përcollë Islamin përqej kohëve. I parapriu njeriut për një jetë njerëzore. U bë prijësi i njerëzimit.

Allahu i quan ato vende “**qyteti i sigurisë**”. Që në krijimin e saj, bota është një “qytet i sigurtë” dhe zemra e ymetit Islam nisi të rrahte në këtë qytet të sigurtë. Ky qytet i sigurtë rreh ashtu si shpirti i ymetit Islam. Prej aty mund të përhapet meltemi i sigurisë për të gjithë vendet Islame dhe prej aty në gjithë botën. Por, nëse mund të bëhem i një ymet i duhur për atë rreth sigurie..., vetëm nëse shpirti ynë rreh si shpirti i atjeshëm...

Një ymet, i cili i jep siguri botës që ka humbur sigurinë në vetvete, ashtu e mbytur në anarkinë e mjeteve që ka prodhuar vetë, është ymeti që kërkon koha.

Haxhi

udhëtim drejt arteve hyjnore

Mr. Žymer Ramadani

Një prej mrekullive më mahnitëse që ka krijuar Allahu (xh. sh.) për njerëzit, është edhe obligimi i tyre që, sipas mundësive financiare dhe fizike, të vizitojnë një herë në jetën e tyre Shtëpinë e Allahut – Bejtullahin. Sipas kuptimit leksikor, haxh- do të thotë drejtim, qëllim, një vizitë që bëhet shumë herë, ndërsa kuptimi i tij në të drejtën islame është "Udhëtimi i një myslimanit në një kohë të caktuar nga shtëpia e tij drejt Qabesë me qëllim të kryerjes së obligimit të Allahut dhe me synim ibadetin – adhurimin dhe nënshtrimin ndaj Krijuesit duke i zbatuar rregullat, të hyjë në ihram, të qëndrojë në Arafat, të bëj tavafin rrëth Qabesë duke i kryer edhe disa norma tjera të nevojshme". Vizita e Qabesë është bërë obligim që nga viti i nëntë hixhri. Ky obligim ceket në ajet dhe përmendet edhe në hadithin e Pejgamberit (a.s.), ku theksohen pesë shtyllat themelore të Islamit. Për këtë shtyllë të Islamit, në mënyrë lutjeje dhe kërkese, Allahu i Madhëruar u drejtohet njerëzve në këtë mënyrë:

"Për hir të Allahut, vizita e shtëpisë (Qabes) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi te ajo, e kush nuk e beson (ai nuk e viziton); Allahu nuk është i nevojshëm për (ibadetin që e bëjnë) njerëzit. (Ali Imran, 97)

Siç dihet, kjo shtyllë e fesë islame ka qenë obligim edhe më herët, obligim edhe për popujt e tjerë para ymetit të Muhamedit (a.s.), gjë e cila daton qysh nga koha e Ibrahimit (a.s.) Posaçërisht edhe në lidhje me këtë çështje, Kurani Fisnik paralajmëron për një obligim të mëhershëm:

"Thirri njerëzit për haxhillëk: ata do të vijnë në këmbë dhe me deve prej të gjitha viseve të largëta." (Haxhxh, 27)

Duke u përqendruar te vendi i shenjtë, pra te Qabeja, dimë

se shenjtërinë si vend e ka marrë shumë herët, sepse daton edhe më herët se periudha e Ibrahimit (a.s.), por në mënyrë më konkrete Kurani na tregon se themelet e saj i vendosi Ibrahimi (a.s.) me të birin Ismailin. Pikaqërisht për këtë datim të rëndësishëm fetar dhe historik, në lidhje me ndërtuesit e Qabesë Allahu thekson në Kuran: *"Kur Ibrahimi dhe Ismaili ngritet themellet e Qabes, u lutën: "O Zoti ynë! Pranoje prej nesh (këtë vepër)! Me të vërtetë, Ti je Ai që dëgjon dhe di gjithçka!"* (Bekare, 127). Që nga ajo kohë, me ndërtimin e themeleve dhe mureve të Shtëpisë së Shenjtë, për çdo vit e në mënyrë të pandërrerë, duke mos dalluar racat dhe gjinjëtë njerëzore, duke mos ndarë të varfrin nga i pasuri, duke mos i dhënë përparësi të madhit ndaj të voglit, e po ashtu duke mos bërë dallim vendasit dhe atij që vjen nga larg, Shtëpia e Allahut u vizitua nga njerëz të ardhur prej çdo këndi të botës. Kjo vizitë u kurorëzua dhe u vulos edhe më tepër deri në ditën e kiametit, gjatë pejgamberllëkut të Muhamedit (a.s.). Dhe që nga ajo periudhë, këtë shenjtëri e përvetësuan myslimanët e mbarë botës, ngase aty u lejohet të hyjnë vetëm ata që janë të pastër fetarisht, të pastër në besim – tevhid – duke qenë vetëm besimtarë të fesë islame, e jo edhe ijtiharetë të ndonjë feje tjeter.

Në mënyrë që vizita e Qabesë të jetë e vlefshme dhe e pranuar, sipas rregullave të fesë islame, personi që ka bërë nijetin për të shkuar atje, duhet që mes tjerash të plotësojë edhe disa kushte si: të jetë mysliman, të ketë pasuri të mjaftueshme, të mos ketë pengesa të rënda shëndetësore, të mos jetë i zhytur në borxhe etj. Kjo vizitë është caktuar një herë në vit dhe në një muaj të caktuar. Nëse një mysliman e viziton Qabenë jashtë këtyre ditëve të caktuara, ai nuk llogaritet si haxhi, por thjesht si vizitor i zakonshëm. Në këtë rast, kjo

Iloj vizite quhet Umre. Për zbatimin e rregullave të Haxhit, Allahu i Madhëruar dhe Pejgamberi (a.s.) na kanë dhënë sqarime të hollësishme, shkelja e të cilave e bën haxhin të pavlefshëm. Allahu (xh.sh.) thotë:

“Koha e haxhillëkut éshtë në muaj të caktuar. Kush vendos të kryejë haxhillëkun, le të largohet nga marrëdhëni (me gruan), grindjet dhe sharjet. Ndërkaq, Allahu di çdo vepër të mirë që bëni. Pajisuni me gjërat që ju nevojiten përrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë éshtë devotshmëria. Prandaj, kini frikë prej Meje, o njerëz të mençur!” (Bekare, 197)

Këtyre normave Pejgamberi (a.s.) ia ka bashkangjitur edhe shpjegimet e veta, duke i stimuluar dhe nxitur myslimanët që ta kryejnë haxhin, po ashtu duke i përgëzuar për shpërblime të mëdha që nuk mund t'i fitojnë dot në jetën e tyre nëpërmjet ndonjë mënyre tjeter. Në një hadith që transmetohet në Sahihun e Imam Buhariut, Muhamedi (a.s.) ka thënë: “*Kush bën haxhin për hir të Allahut, largohet nga sjelljet dhe fjalët e liga, po ashtu nuk bën mëkate; ai do të kthehet nga haxhi (i pastër) ashtu sikurse ka lindur nga nëna e tij, pa mëkate – përveç të drejtave njerëzore.*” (Buhari, Haxhxh, 4) Vlejnë të theksohen edhe disa përgëzime tjera të Muhamedit (a.s.) në lidhje me Haxhin:

a. Haxhi i pranuar tek Allahu nuk ka ndonjë shpërblim tjetër përveç xhenetit, dhe se një umre e bërë nga umreja tjetër po ashtu fshin mëkaten. (Muslim, Haxhxh, 437)

b. I pyetur për punën më të begatshme të kësaj bote, Pejgamberi (a.s.) éshtë përgjigjur: “Besimi në Allahun dhe Pejgamberin e Tij”. Po pastaj, cila? Pastaj: “Xhihadi – orvatajë në rrugën e Allahut” Pastaj: “*Haxhi i Pranuar*”. (Buhari, Haxhxh, 4)

Vizita e Shtëpisë së shenjtë – Qabesë ka begati të mëdha, ngase kjo éshtë mënyrë më e përshtatshme që robi të vett-mohet në lutjen e tij duke iu lutur Allahut. Me kryerjen e farzeve të haxhit dhe syneteve të tjera, ai arrin në një shkallë devotshmërie që nuk mund ta arrijë as në ndonjë vend tjetër, as në ndonjë kohë tjetër. Nevojitet që çdo mysliman t'i kalojë këto ditë të haxhit në ibadeti dhe në lutje sa më të shumta e të frytshme, sepse çdonjëri nga ata që vizitojnë shtëpinë e Allahut duhet të dijë se nuk ka ndonjë vend tjetër më të shenjtë në botë përveç Qabesë, qytetit të Pejgamberit (a.s.) Medines, dhe Mesxhidu'l-Aksasë në Palestinë. Prandaj, udhëtimi me nijet ibadeti mund të bëhet vetëm drejt këtyre tri vendeve, përndryshe do të ishte mëkat nëse dilet në udhëtim me qëllim ibadeti në ndonjë xhami tjetër.

Për ta plotësuar haxhin e tij dhe për ta kurorëzuar atë, përveç kushteve të tjera, në mënyrë të patjetërsueshme haxhiu duhet të bëjë: a) Veshjen e Ihramit; b) Tavafin – rrotullimin shtatë herë pranë Qabesë duke filluar nga Haxheru'l-Esvedi dhe; c) Qëndrimin një pjesë të ditës në fushën e Arafatit, sepse Pejgamberi (a.s.) ka thënë “Haxhi éshtë (qëndrimi në

Arafat”.

Çdo mysliman duhet ta kuptojë rëndësinë e këtyre vendeve të shenjta dhe duhet t'i shohë gjithë ato mrekulli dhe arte të Allahut, në mënyrë që kryerja e haxhit të ndikojë përgjithmonë në jetën e tij, e që jetës së tij t'i bashkangjitet diçka të veçantë, e cila mund të nxisë një ndryshim pozitiv tek ai. Në këtë mënyrë, ai person që bën nijet të kryejë haxhin duke iu përbajtur rregullave të haxhit, do të arrinte shpërblimin e madh dhe do të pastrohej nga mëkaten duke u bërë sikurse ka lindur nga nëna e tij. Po ashtu, ai duhet të kryejë edhe rregullat e tjera, që nuk u cekën në këtë artikull, rregulla të cilat e zbukurojnë dhe e begatojnë haxhin: të therin kurbanët e tyre, të bëjnë vizitë në vende të tjera në Meke, në Hudejbiye, në Kodrën Hira, në Xhaminë Ten'ime etj., të kalojnë në qytetin e bukur të Pejgamberit (a.s.), në Medinen e Shndritshme për t'i dhënë selame Muhamedit (a.s.), të falin së paku dy rekate në kopshtin e xhenetit – Ravdadu'l-Xhenneh, të shijojnë aromën e këtij qyteti të bekuar dhe gjithashu të bëjnë vizitë në vende të tjera të këtij qyteti. Më pas, ai duhet të plotësojë një kapitull të rëndësishëm të jetës së tij, për t'u kthyer pastaj në shtëpinë e tij në mënyrën më të gjëzuar, në mënyrë që të ketë çfarë t'u shpjegojë myslimanëve të tjerë për artin, mrekullinë dhe zanafillën e haxhit.

Për rëndësinë e qytetit të bekuar të Mekes, Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “*Pasha Allahun! Ti je vendi më i mirë i Allahut, ti je vendi më i dashur i Allahut, dhe sikur të mos më nxjerrin banorët e tu prej teje (me dhunë) kurrë nuk do të të lija*”. (Ahmedi dhe Tirmidhiu) Për këtë shkak, Mekja e ka marrë shenjtërinë deri në ditën e kiametit, sepse éshtë Allahu, Ai që deshi ta begatojë atë. Po këtu u plotësua duaja e Ibrahimit (a.s.), e po këtu ndodhë gjëra që nuk kanë ndodhur në ndonjë vend tjetër. Për këtë arsy, edhe Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Fisnik:

“Me të vërtetë, Faltorja e parë e ngritur për njerëzit, éshtë ajo në Bekkë (Mekë), e bekuar dhe udhërrëfyese për popujt.” (Ali Imran, 96)

Kjo pra éshtë mrekullia hyjnore, e cila mundëson që ky vend i bekuar të fitojë një rëndësi të tillë. Ndoshta në shikim të parë ky vend duket sikur nuk ka ndonjë rëndësi, sepse gjendet në një zonë të shkretëtirës, por nga ky vend buron uji më me vlerë në rruzullin tokësor, uji i zemzemit, ujë që hanxhinjtë dhe vizitorët e tjerë e bartin me litra të tërë për në vendet e tyre, me një dashuri dhe entuziazëm të madh, që të mund t'i gjëzojnë edhe të tjerët. Kjo, pra éshtë një panoramë arti, të cilin Allahu (xh.sh.) e shfaqi midis njerëzve në një vend me gurë, pa lumenj, pa male dhe pa ndonjë veçanësi dynjallëku, përveç asaj që i dha bereqetin hyjnor, artin më të mirë në botë, ngase Allahu éshtë krijues dhe shpikës i gjithçkaje që ne shohim.



Hutbja e lamtumirës së Muhamedit (a.s.) në Arafat

O ju njerëz! Dëqjoni çka do t'ju them, sepse nuk e di nëse do të mund t'ju takoj në këtë vend pas këtij viti.

O ju njerëz! Frikësojuni Allahut dhe respektojeni Atë. Bëhuni të njerëzishëm dhe të drejtë ndaj vetes suaj e ndaj të tjerve. Kjo është dita e flijimeve në emër të Allahut. Me të vërtetë qjaku juaj, pasuria juaj janë të shenjta për ju, deri në kohën kur të takoheni me Krijuesin tuaj, ashtu siç është e shenjtë kjo ditë, në këtë muaj dhe në këtë vend.

- Ruani, respektoni dhe nderoni vlerën e personalitetit njerëzor.

- Njeriu është vepër madhështore e Allahut dhe vajmedet për atë që përqmon nderin dhe dinjitetin e veprës së Allahut.

- Ju o njerëz, do t'i ktheheni në mënyrë të pashëmangshme Allahut të Amshueshëm dhe Ai do t'ju thërrasë në përgjegjësi për veprat e për punën tuaj.

- O besimdrejtë! Ta dini, ta mbani në mend dhe të jeni të bindur se ka përfunduar koha e mosdijes dhe e traditave të këqia, të cilat i kanë sjellë aq fatkeqësi gjinisë njerëzore. Unë ju kam treguar rrugën e shpëtimit në të cilën duhet ecur.

- Gjërat që ju janë lënë amanet, ruajini si të ishin tuajat dhe kthejani besnikërisht dhe në kohën e dushur atij të cilat i përkasin.

- Gjakmarrja është e ndaluar, të gjitha akuzat, të cilat rrjedhin nga koha para ardhjes së Islamit anullohen. Dhe e para gjë e këtillë që anulohet është gjakmarrja e ungjit tim Amir B. Rebi' b Harith

B. Abdulmut-talib, të cilin njerëz nga fisi Hudhej e mbytën të pafajshëm. Le të harrohet kjo gjakmarrje dhe le të falen të gjitha të tjerat në të ardhmen.

- Fajdeja dhe kamata janë të ndaluara. Huadshënesi duhet të marrë nga huamarrësi vetëm atë që ia ka huazuar. Huatë e para që i nënshtrohen këtij vendimi janë ato të unqjit tim Abbasit, i cili ka pasur mjaft borxhlinj.

- O ju besimdrejtë! Faljani kamaten borxhlinjve. Dëqjoni këshillën time dhe pasuria juaj do të shtohet, sepse ju mbetet kryeqjëja për tregti dhe punë të ndershme.

- Nëse nuk e bëni këtë, dijeni se e keni zemëruar rëndë Allahun dhe të Dërguarin e Tij.

- Nëse borxhliu juaj është në vështirësi, shtyjani afatin e pagimit, por nëse jeni në gjendje t'ia falni borxhin, atëherë kjo është edhe më e mirë për ju.

- O ju besimdrejtë! O ju njerëz! Frikësuhuni asaj dite, e cila me siguri do të vijë, kur të gjithë do të vini para Allahut, i cili është i vetmi gjykatës Suprem, dhe ku ju pret drejtësia absolute.

- Kur të ngarkoheni me detyrimin për ta paguar një borxhi me kohë dhe kur të bëni marrëveshje, të gjitha duhet t'i bëni me shkrim e në mënyrë të saktë, duke e theksuar afatin e pagimit...

- O të vdekshëm! Duajeni dhe dëgjojeni Zotin, Krijuesin e tërë materjes dhe jomaterjes, i cili krijoi meshkuj dhe femra, prej të cilëve zhvillohet gjinia njerëzore.

- Frikësoniu Allahut, në ndihmën, prehjen dhe më-

shirën e të Cilit jemi të gjithë të udhëzuar. Ne jemi të vdekshëm dhe në çdo rast jemi përherë e më afër vdekjes dhe takimit me Të, me Allahun e Amshueshëm, me Gjykatësin e Drejtë.

- Respektoni farefisin. Përbushni besnikërisht detyrat dhe obligimet që ekzistojnë ndërmjet burrit dhe gruas, ndërmjet prindërvë dhe fëmijëve. Fëmija e fiton Xhenetin nën këmbët e nënës së tij.

- Ruajuni prostitutacionit, tradhëtisë bashkëshortore dhe xhelozisë. Prostitucioni dhe tradhëtia bashkëshortore janë mëkat i rëndë, ndërkaq xhelozia të çon drejt prishjes së martesës.

- Martohuni me ato që doni, e kur vuillneti i Zotit t'ju bashkojë, atëherë respektojeni e duajeni njëritjetrin në dashuri e harmoni.

- O bashkëshortë! Silluni ndaj grave tuaja me shumë mirësi dhe dashuri...

- O besimdrejtë! Largojuni nga ngatërrresat dhe përgojimi.

- Ata që u bëjnë shpifje grave të ndershme, le të jenë të mallkuar në të dy botërat. Ata që akuzojnë gratë e ndershme për tradhëti në martesë ose për imoralitet, pa mundur të sjellin katër dëshmitarë të besueshëm në lidhje me këtë çështje, dënojini me tetëdhjetë dhe asnjëherë në të ardhmen mos iu besoni për asgjë, sepse ata janë njerëz të poshtër dhe të këqinj.

- Nëse ndieni se ju është pakësuar dashuria ndaj grave tuaja, mos nxiton, mendohuni mirë, se mbasë nëpërmjet këtij sprovimi Allahu ju udhëzon në rrugët e fatit të ri të madhi, me të cilin dëshiron t'ju përgjëzojë. - Mos kërkoni shkurorëzim pa pasur shkaqe të arsyeshme, sepse prej të gjitha gjérave që Allahu ka lejuar, më shumë nga të gjitha urren shkurorëzimin.

- Gratë tuaja janë dorëzuar në besë të Zotit. Respektojeni këtë amanet të Zotit, o besimdrejtë.

- O ju njerëz! Sot djallë i mallkuar është i dëshpëruar, sepse ka pasur humbje dhe nuk mundet më të ndikojë tek ju. Megjithatë, bëhuni të kujdesshëm, me qëllim që ai i mallkuar të mos ju lajthitë as në gjërat më të vogla.

- O besimdrejtë! Kur e caktoni trashëgiminë apo kur e drejtoni vetë atë, bëhuni të drejtë dhe përbajuni Librit të Allahut. Ruajeni pasurinë e të miturve, pasurinë e të paafteve dhe të të marrëve.

- Zoti i ka dhënë çdo njeriu të drejtën e vet, prandaj nuk ka nevojë t'u lihet testament trashëgimtarëve;

ndërsa me testament nuk mund të lihet më tepër se një e treta e pasurisë.

- Fëmija i takon atij në shtratin e të cilit është sëndur. Atë që pohon se fëmija i takon tjetërkujt përvëç prindit, atë do ta zërë mallkimi i Zotit.

- Gruas nuk i lejohet të japë dëçka nga pasuria e burrit të saj pa lejën e tij.

- Borxhi duhet paguar, ndërsa sendi i huazuar duhet kthyer. Dhurata duhet kthyer me dhuratë. Kush hyn dorëzanë për dikë, ai ngarkohet me përgjegjësi për dorëzaninë e tij...

- O ju njerëz! Dëgjoni gfarë po ju them dhe mbajeni mend mirë. Unë po ju lë Librin e Allahut - Kuranin, i cili, nëse ju i përbaheni, do t'ju ruajë gjithnjë që të mos humbni rrugën e drejtë, rrugën e drejtësisë dhe të së vërtetës. Kurani është Libër i qartë dhe i shenjtë, vepër e vërtetë e Allahut, Fjalë e Tij në vërtetësinë e së cilës nuk ka dyshim.

- Pas vetes e keni tërë jetën time, fjalët dhe veprat e mia. Gjithçka që kam folur e që kam punuar, jam përpjekur të jetë në përputhshmëri të plotë me urdhërat e Allahut. Vërtet që ju nuk do të lajthitni për sa kohë që t'i përbaheni Kuranit dhe Sunetit tim.

- O besimdrejtë! Flitni gjithë të vërtetën e pastër. Urrejtja nuk duhet t'ju largojë asnjëherë nga rruga e të drejtave dhe e drejtësisë. Drejtësia është motra e devotshëmisë. Frikësojuni Allahut! Ai e sheh punën tuaj.

- O ju njerëz! Tani që e dëgjuuat porosinë time, futeni në zemrat tuaja e në jetën tuaj. Të gjithë ata që i dëgjuan fjalët e mia, le t'ua përcjellin atyre që nuk i kanë dëgjuar! Sepse midis tyre mund të ketë njerëz edhe më të kuptueshëm se sa vetë dëgjuesit.

Pas një pushimi të shkurtër, Pejgamberi (a.s.) tha me zë të butë:

- O Zoti im! A e kam përbushur detyrën time dhe misionin e besuar?

- O i dërguari i Allahut! Ti e ke përbushur besnikërisht misionin tënd dhe na ke komunikuar atë çka të ka urdhëruar Allahu, -u përgjigjën më se 100.000 haxhinjtë e pranishëm në këtë tubim.

Atëherë Muhamedi (a.s.) tha me zë solemn:

O Zoti im, dëshmo (në këtë)! (Atë ditë Allahu i Lartmadhëruar shpallë ajetin e Kuranit:)

"Sot ju kam përkryer fenë tuaj, dhe begatinë time ndaj jush e kam plotësuar, dhe jam i kënaqur që Islami të jetë fe e juaj." (El-Maide, 3)



Qëndrimi i Ademit (a.s.) ndaj mëkatit

Mr. Abdylkader Durgutı

Sipas gjithë librave të shenjtë, njeriu e ka prejardhjen nga Ademi (a.s.). Po ashtu, të gjitha librat e shenjtë e cekin prejardhjen e njeriut të parë në etapat e krijimit të tij. Pavarësisht se etapat e krijimit të njeriut transmetohen me disa ndryshime, prapëseprapë të gjitha fetë e pranojnë prejardhjen e njerëzimit nga Ademi (a.s.). (Süleyman Hayri Bola, "Adem", DIA, I, 358)

Veç kësaj, në konsensusin e librave të shenjtë vërehet gjithash tu edhe historia e mëkatit të parë që kish kryer njeriu i parë, Ademi së bashku me bashkëshorten e tij Havanë. Mëkatit i parë i Ademit (a.s.) dhe i bashkëshortes Hava ndodhi atëherë kur ata morën për të ngrënë pemën që u ishte ndaluar. Këtë ngjarje Kurani e përmend me hollësi të shumta, duke përmendur po ashtu edhe nxitësin e këtij mëkatit, që ishte shejtani i cilësuar si armiku i njeriut, i cili luajti rolin kryesor për nxitjen në këtë mëkat. Këtë ngjarje Kurani e trajton nga këndvështrime të shumta në 7 sure të ndryshme. Në çdonjëren nga këto sure njeriut i mundësohet të marrë shembuj dhe mësimë të ndryshëm prej kësaj ngjarjeje të emërtuar si ngjarja e krijimit.

Pasi e krijoi Ademin dhe bashkëshorten e tij Havanë (Bekare, 30; Nisa, 1), Allahu i vendosi që të dy në Xhenet, duke ua tërhequr vërejtjen se çdo gjë në atë vend të mrekullueshëm ishte e lejuar për ta, përvëç një pemë së cilës duhej t'u qëndronin larg, sepse përndryshe do të bëhezin mëkatarë apo gjynahqarë. (Bekare, 35; A'raf, 19) Kurani

e tregon kështu ngjarjen e Ademit (a.s.): "*Ndërsa Ademit i tha: "O Adem! Bano ti dhe bashkëshortja jote në Xhenet dhe hani ç'të dëshironi, por mos iu afroni kësaj peme, se bëheni keqbërës!" Djalli u pëshpëriti, për t'ua zbuluar pjesët e turpshme të mbuluara të trupit të tyre dhe u tha: "Zoti juaj tua ka ndaluar pemën, vetëm që të mos bëheni engjëj ose të pavdekshëm."* Duke iu betua atyre (duke thënë): "*Vërtet, Unë jam për ju këshillues i sinqertë!*" Duke i mashtroi me dinakérinë e tij. Pasi e shijuan frutin, atyre iu zbuluan vendet e turpshme dhe nisën të mbulohen me gjethet e Xhenetit dhe Zoti i tyre i thirri: "*A nuk tua kisha ndaluar atë pemë? A nuk ju pata thënë se djalli është vërtet armiku juaj i hapët?*" Ata thanë: "*O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet që do të jemi nga të humburit.*" Allahu tha: "*Zbritni! Ju do të jeni armiq me njëri-tjetrin. Në Tokë do të banoni dhe do të jetoni deri në një kohë të caktuar.*" (A'raf, 19-24)

Ky ishte mëkatit i parë i kryer nga njeriu i parë që ra në kurthin e shejtanit. Në shikim të parë kjo duket thjesht si një ngjarje historike që ndodhi me krijimin e njeriut të parë. Mirëpo Kurani, përveçse cek një ngjarje historike, tregon urtësitë e kësaj ngjarjeje, prej së cilës duhet të marrim mësim, por po ashtu tërheq vërejtjen ndaj faktorëve të këtij gjynahu, mes të cilëve në rend të parë armiku më kryesor dhe më i përbetuar i njeriut ishte dhe do mbetet shejtani. (A'raf, 22; Jusuf, 5)

KRIJIMTARIA E NJERIUT NDAJ MËKATIT

Për nga natyrshmëria e tij njeriu është cilësuar si krijesa që harron. Ky cilësim mund të dëshmohet me rrjedhën e ngjarjes së Ademit dhe të Havasë. Kjo sepse ata të dy harruan vë-rejtjen e Allahut dhe ranë në kurthin e shejtanit. Ata të dy e panë mëkatin e tyre pasi që e hëngren pemën e ndaluar. Ashtu siç theksohet në ajetin e lartpërmendur, kur ata e shijuan pemën u zbulua vendi i tyre i turpshëm, arsy për të cilën filluan ta mbulojnë atë duke vënë gjethë mbi gjethë, të marra nga gjethet e pemëve të Xhenetit. Zbulimi i vendturpit të tyre ishte edhe një lloj ndëshkimi i Allahut për ata të dy. Sepse pas këtij gabimi, Allahu iu drejtua atyre: **"A nuk juua kisha ndaluar atë pemë? A nuk ju pata thënë se djalli është vërtet armiku juaj i hapur?"** (A'raf, 22)

Por përsëri ngjarja rroddhi në favor të njeriut, sepse mençuria e njeriut u mbështet në rastin kur gabimin dhe mëkatin që kreu e mori mbi vete, duke e pranuar dhe duke kërkuar falje për atë që kishte vepruar para Allahut. Kështu që **ata thanë: "O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet që do të jemi nga të humburit.** (A'raf, 23) Prandaj lutja që Ademi (a.s.) kishte bërë para Allahut për mëkatin e kryer mori vend në Kuran dhe llogaritet si lutja e çmueshme dhe e preferuar për njeriun që gabon apo për gjynahqarin. Themi se është e preferuar sepse kjo është një prej lutjeve të pranuara nga Allahu ndaj mëkatin të bërë nga Ademi dhe Havaja, me përgjigjen e dhënë nga vetë Allahu: **Mandej Zoti i vet e bëri atë të zgjedhur, ia pranoi pendimin dhe e vuri në rrugën e drejtë** (të vendosur) (Taha, 122; Bekare, 37). Nga ky ajet mësojmë se Allahu, përveçse ua fali mëkatin Ademit dhe Havasë, i bëri ata prej robërve të Tij të zgjedhur.

Këto ishin themelët e para, ku filloj armiqësia ndërmjet njeriut dhe shejtanit. Allahu pasi ia fali Ademit dhe Havasë mëkatin, shejtani që nga atëherë vazhdoi të insistonte në mashtime e kurthe të ndryshme vetëm e vetëm që ta zhyste njeriun në mëkate.

Pas këtij mëkati që bënë Ademi dhe Havaja, për shkak të qëndrimimit të tyre fisnik pasoi edhe falja e tyre. Mirëpo, si përfundim i ngjarjes së krijimit dhe të mëkatin të parë, mund të ceket se për ta pasoi një jetë tjetër e mbushur me përpjekje të shumta dhe përballje me vështirësitetë në tokë. Veç kësaj, ata do të duhet të ballafaqoheshin në të ardhmen me:

1. Fillimin e jetës në tokë.
2. Përballjen me armikun (shejtanin).
3. Përpjekjen për t'u përshtatur dhe mbijetuar në tokë.

Jeta e tyre filloj me ndryshime atëherë kur Allahu iu drejtua duke iu thënë: Zbritni në tokë, jeni armiq të njëri-tjetrit. Ur-dhri **"zbritni"**, përveçse u drejtohet Ademit dhe Havasë, nën-

kupton po ashtu se i drejtohet edhe shejtanit dhe llojit të tij që janë xhindët. Të gjithë do të jetojnë në tokë deri në një kohë të caktuar, dhe që të gjithë do të janë armiq të njëri-tjetrit. Por këtu nuk duhet kuptuar se të gjithë xhinët janë kundërshtarë ndaj njeriut, apo që të gjithë njerëzit janë kundërshtarë të xhinëve. Kundërshtarët e njeriut apo armiqtë e njeriut janë xhinët që bëjnë pjesë në grupin e shejtanit apo shejtanët.

Si përfundim i ngjarjes së krijimit dhe i qëndrimimit ndaj mëkatin të parë, pa dyshim që duhet të theksohet edhe çështja e ndëshkimit për mëkatarin. Siç është vërejtur edhe nga ngjarja e lartpërmendur, mëkatari ndëshkohet sipas llojit të mëkatin, e përvëç kësaj ndëshkohet vetëm mëkatar. Sipas parimeve Islame, si mëkati ashtu edhe ndëshkimi janë individuale e jo kolektive. Askush nuk ndëshkohet për mëkatin e tjetrit. **"kushdo që bën diçka, punon për vete dhe askush nuk ngarkohet me barrën e tjetrit".** (En'am, 164) Pranimi i lutjes së Ademit nga Allahu thjesht nënkupton se Ademi dhe Havaja ishin të parët që gabuan dhe u penduan. Për këtë shkak, po të kishte ndonjë ndëshkim për ta, ai do të ishte vetëm për ata të dy, jo edhe për pasardhësit e tyre. Po ashtu, ky parim i Islamit e përgjënjeshtron ideologjinë krishtere në të cilën pohohet se Ademi ishte mëkatar i parë, kështu që edhe zemërimi i Allahut binte ndaj mëkatarit të parë, ndaj Ademit. Prandaj, sipas ideologjisë krishtere, për shkak të mëkatin të Ademit, të gjithë fëmijët që do të lindin deri në ditën e kiametit janë mëkatarë. Që të gjithë do të vazhdojnë të jetojnë si mëkatarë, derisa sa të pagëzohen. Për këtë ideologji, sot praktikohet një ceremoni e veçantë për pagëzimin e fëmijës pas lindjes. Po ashtu, për shkak të këtij mëkatin që kreu Ademi, për të larë mëkaten e tij dhe për të shpaguar mëkaten e pasardhësve të tij u kryqëzua dhe u flijua Isa (a.s.) në vend të Ademit e gjithë të tjerëve. (Süleyman Hayri Bola, "Adem", DIA, I, 362)

Kjo na bën të kuptojmë se sado mëkate që të bëjë gjithësecili deri në ditën e kijametit, do t'i falen nga shkaku i kryqëzimit të Isait. Apo së paku nënkuptonet se mëkatari nuk është i varur nga mëkati i tij, por është ndonjë tjetër ai që do të japë llogari apo do të ndëshkohet për mëkatin e tij.

Kjo ideologji u bie ndesh plotësisht parimeve Islame dhe atyre logjike. Në radhë të parë nuk është aspak logjike që një fëmijë i porsalindur të bartë barrën e paraardhësit apo të përgjigjet për mëkatin e tjetrit. Prandaj, në lidhje me këtë, Muhamedi (a.s.) thotë: **Çdo fëmijë që lind, lind në natyrë të pastër, (fitreh) pastaj prindërit e bëjnë atë krishterë, çifut...** (Buhari, Xhenaiz, 23) Islami këtë e përgjënjeshtron plotësisht, sepse **"...askush nuk e merr të keqen e tjetërkujt. Ne nuk dënojmë asnjë popull, para se të çojmë të dërguar!"** (Isra, 15), **"Asnjë gjynahqar nuk do t'i mbartë gjynahet e tjetrit".** (Zumer, 7)



Xhihad i pa luftë Haxhi

Ismail Lufti Çakan

Transmetohet se Aisheja (r.a.) e ka pyetur Resulullahun (a.s.):

- O i Dërguar i Allahut! A ka xhihad pér femrat?

Resulullahu (a.s.), urdhëroi kështu:

“Po, pér ato ka xhihad pa luftë, haxhi dhe umreja!”
(Ibën Maxhe, menasik 8.)

Është një e vërtetë që dihet se myslimani në jetën e tij të besimit dhe të adhurimit, jeton një xhihad të shumanshëm, të vazhdueshëm dhe të vërtetë. Si rrjedhojë, ashtu siç u pa edhe në hadithin e mësipërm, Profeti ynë (a.s.) e konsideron haxhin dhe umren si “**xhihad pa luftë**”. Sipas një transmetimi të muhadithit të madh Imam Buhariut, Aisheja (r.a.) e ka pyetur Resulullahun (a.s.):

- O i Dërguar i Allahut! Xhjadi është puna më me vlerë pér ne. A nuk mundemi ne femrat të bëjmë xhihad?

Resulullahu (a.s.) urdhëroi:

“Jo! Xhjadi më i mirë pér ju femrat është haxhi mebrur (i pranuar).” (Buhara, Haxh, 4)

Në transmetimin e Buhariut, “umreja” nuk përmendet, ndërsa haxhi cilësohet si “mebrur”. E njëjtë gjë vihet re edhe në transmetimin e Nesaiut. (shih. Nesai, haxh, 4). Veçanërisht, dihet se të njëjtës pyetje Resulullahu (a.s.) i është përgjigjur kështu: “Juve ju mjafton haxhi (si xhihad)”. (shih. Abdurrezzak, el-Musannef, V,8)

Të gjitha këto thënie dhe vlerësimë që i takojnë Resulullahut (a.s.), janë me të vërtetë interesante dhe të bëjnë të mendohesh. Pikë së pari, ky përcaktim i jep haxhit një peshë të njëjtë me xhadin e pér rrjedhojë vë në pah edhe urtësinë e tij (haxhit). Nga ana tjetër, del në pah se parë nga këndvështrime të ndryshme, çdo adhu-

rim në Islam ka të njëjtën vlerë me xhihadin.

Në këtë vlerësim të përgjithshëm, veçanërisht të haxhit, vihet re se nga pikëpamja e xhihadit, haxhi zë një vend të veçantë dhe të ndryshëm. Pra, del në pah si rruaga dhe si mjeti më gjithëpërfshirës e më ndikues në luftrën e ftohtë, në propagandë dhe në luftën e kulturave.

Sipas asaj që mësojmë nga një hadith tjetër, “**xhihadi është pika më e lartë e ndërtesës së fesë**” (shih. Tirmidhi, Iman 8.) Ndërsa femrat nuk futen në klasën e luftëtarëve. Për ato, riti i haxhit (dhe i umres) është në vend të xhihadit. Pra, haxhi është “xhihadi pa luftë”. Kjo është ajo që i përshtatet më mirë femrës nga natyra, por edhe nga ana e sheriatit (ligjit Islam). Atëherë është e mundur që nga ky hadith të nxjerrim përfundimin se femrat mund të marrin detyra të rëndësishme në luftën e ftohtë. Thënë ndryshe, është e qartë se myslimanët meshkuj dhe femra kanë shansin dhe përgjegjësinë e një xhihadi në dimensione botërore. Si rrjedhojë, Profeti ynë (a.s.) e këshillon kështu një mysliman, i cili ankohej për dobësinë dhe frikën e tij:

“Eja merr pjesë në haxh, në xhihadin që nuk kërkon fuqi dhe heroizëm.” (Abdurrezzak, el-Musannef, V, 7-8.) Në një hadith tjetër, Profeti ynë (a.s.) ka urdhëruar kështu:

“Haxhi dhe umreja është xhihadi i të gjithë të dobtëve, i të moshuarve, i fëmijëve dhe i femrave.” (shih. Nesaî, haxh 4; Ibën Maxhe, menasik 8.) Me këtë hadith, Profeti ynë (a.s.) ka dekluaruar hapur se ajo pjesë e shoqërisë që nuk mund të marrë pjesë fizikisht në xhihadin e vërtetë, i ka të gjitha mundësitë për të marrë pjesë në një lloj tjetër xhihadi.

Duhet të sqarojmë menjëherë se me shprehjet e mësipërme nuk duam të themi se haxhi është një rit vetëm për të paaftët, të dobëtit dhe femrat, por se ky është një rit shumë i rëndësishëm, që konsiderohet si xhihad përkëto kategori njerëzish, të cilët kanë shansin të fitojnë sevapet e xhihadit në një rrugë më të lehtë. Nga kjo pikëpamje mund të themi se përkëto kategori të shoqërisë ky lloj xhihadi përbën një mirësi dhe ndër të madh.

LUFTA E FTOHTË

Haxhi është një aktivitet me dimensione botërore, i cili mbledh nën një flamur dhe në një qendër një numër të madh myslimanësh, pas një udhëtimi të gjatë, pas sakrificash e vështirësish të mëdha. Për botën Islame,

kjo është një mundësi jashtëzakonisht e rëndësishme e komunikimit të fesë, që ka një ndikim të madh. Ndërsa komunikimi i fesë është një xhihad më vete. Haxhinjtë, kjo ushtri muxhahidësh të paarmatosur, megjithëse rrugët për t’iu dhënë dëshirave dhe rehatisë së tyre i kanë të hapura, preferojnë ta harxhojnë pasurinë dhe jetën e tyre në rrugë të Allahut, pa shfaqur dhunë, duke u shqërituar me gjithë ndryshimet fizike dhe racore që kanë midis tyre, si dhe duke shprehur me të njëjtat fjalë dhe mënyra besimin dhe ndjenjat e tyre. Padyshim që kjo pamje përcjell një mesazh të fortë dhe mbase tronditës për zemrat pa besim. Gjithashtu, nuk është i kotë as kthimi i syve të të gjithë botës për nga bota Islame, për të parë këta muxhahidë të paarmatosur gjatë kohës së haxhit.

Riti i haxhit, i cili përmban në vetvete aktivitete që i bëjnë ballë çdo lloj simboli të së keqes, është një mënyrë e vërtetë edukimi, sa i takon pikëpamjes së ruajtjes prej të keqes. Ndërsa iħrami është uniforma e përbashkët ushtarake e këtyre ushtarëve të xhihadit pa luftë.

Haxhi është komunikimi i besimit monoteist që i bëhet botës prej Bejtullahut me tekbire (Allahu Ekber), me teħlile (La ilāha illallah) dhe telbije (Lebejke Allahu Lebejk). Disiplina, bindja dhe sakrifica janë gjërat më kryesore në ushtri. Vetëm kështu marrin kuptim armët dhe edukimi. Edhe xhihadi pa luftë ka disiplinën, praktikën dhe sakrificën e vet. Mungesa e disiplinës shkakton përqarjen e umetit dhe përkëto gjynah do të mbahet përgjegjësi. Ky gjynah është jashtëzakonisht i rëndë, prandaj askush nuk duhet as edhe ta provojë një gjë të tillë.

Përsosmëria e përfundimeve varet drejtpërdrejt nga punët parapërgatitore. Padyshim që instruksionet që do të merren përpara haxhit do të eliminojnë një sëri gabimesh dhe do të shtojnë kënaqësinë shpirtërore të haxhit. Prandaj, për asnjë arsyé nuk duhet të braktisen. Në një hadith të nderuar urdhërohet: **“Haxhiu që i plotëson të gjitha kérkesat (e haxhit) dhe prej gjuhës e dorës së të cilit nuk dëmtohen Myslimanët, do t’i falen të gjitha gjynahet e kaluara.”** (Abdurrezzak, el-Musannef, V, 11) Ashtu siç ka nevojë për edukim në planin individual që të mund të arrihet ky përfundim i lumtur, po ashtu është i nevojshëm edhe edukimi i mjaftueshëm dhe rrënjosor i umetit që të arrihen këto përfundime.



Keutheri DHE KURBAN

Hasan Kamil Jellmaz

Keuther është një fjalë arabe, rrënja e së cilës është "kethret", e që do të thotë bollëk, mbushulli, begati etj. Në të njëjtën kohë, fjalë "Keuther" është edhe emri i një lumi të xhenetit ku do të takohet Profeti (a.s.) me umetin (popullin) e tij. Ky lumë ku do të mblidhet umeti i Muhamedit (a.s.) simbolizon numrin e madh të umetit të Muhamedit (a.s.) dhe gradën e tij të lartë në krahasim me umetet e tjera.

Surja e Kuranit Famëlartë, që njihet me emrin "Keuther" është zbritur për shkak të fjalës "ebter" që e përdorën mushrikët në kohën kur ndërroi jetë djali i fundit i Resulullahut; me qëllim që të talleshin me Profetin ata e thirrën "ebter - farëshuar, pra pa pasardhës". Liderët e mushrikëve si As bin Uail, kujtonin se, nëse Profeti nuk do të kishte djalë, nuk do të kishte kush ta vazhdonte misionin e tij, e kështu mësimet e tij do të humbnin njëherë e përgjithmonë. Gjithashtu, ata mendonin se edhe emri e fama e Muhamedit (a.s.) dhe e Kuranit do të harroheshin. Pronari i asaj ftese hyjnore kishte dëshiruar që ajo (ftesë) të zgjaste si mëshirë deri në ditën e kiametit. Prandaj, kjo sure zbriti për t'i shpallur botës këtë të vërtetë, duke ngushëlluar zemrën e Profetit (a.s.) dhe duke forcuar besimin e myslimanëve. Allahu i Madhëruar urdhëron: "Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty shumë të mira, andaj, falu (vetëm) për Zotin tënd dhe ther kurban! Sigrisht, ai që të urren ty, ai vetë është farëshuar". (El-Keuther 1-3) Dhe si përfundim, ashtu ndodhi. Fara dhe fisi i atyre që i thanë Profetit (a.s.) "ebter" u shua dhe u harrua, ndërsa fara

e besimit të tij (Profetit) u shtua dhe do të vazhdojë deri në ditën e kiametit.

Në suren el-Keuther, përveç mirësisë që i është dhënë Resulullahut (a.s.), mirësi e cila simbolizon begatinë e umetit të tij në emër të Profetit (a.s.), umetit të tij i ngarkohet edhe urdhri i namazit dhe i kurbanit.

Fjalë "Kurban" do të thotë "t'i afrohesh diçkaje". Ndërsa si term fetar do të thotë therja e një kafshe në një kohë të caktuar, me qëllim afrimin ndaj Allahut. Në Kuranin Famëlartë Allahu Teala urdhëron: "*Tek Allahu nuk arrin as mishì, as gjaku i tyre, por arrin përkushtimi juaj...*" (El-Haxhxh, 37)

Kurbani përmban një kuptim që tregon ndjenjën e sakrifisës. Si rrjedhojë, kurbani u ofrua si zgjidhje për përplasjen midis dy djemve të Ademit (a.s.), Habilit dhe Kabilit. Siç e dimë, gruaja e Ademit (a.s.), nëna jonë Havaja, në çdo barrë lindte fëmijë binjakë, një mashkull dhe një femër. Sipas ligjit të asaj kohe, djali i barkut të parë mund të martohej me vajzën e barkut të dytë, ndërsa vajza e barkut të parë me djalin e barkut të dytë. Për shkak të bukurisë që kishte motra e tij binjake, Kibili u bë xheloz, kundërshtoi ligjin dhe këmbënguli që të martohej me motrën e tij binjake. Ai nuk i mori parasysh këshillat e babait të tij Ademit (a.s.). Më në fund, për të zgjidhur këtë çështje, që të dy i ofruan Allahut nga një kurban. Në Kuranin Famëlartë kjo ngjarje tregohet kështu: "*Lëxoju (o Muhammed) saktësish ngjarjen e dy bijve të Ademit, kur ata bënë nga një kurban, njërit iu pranua, kurse tjetrit jo. Njëri i tha tjetrit:*

"Ty gjithsesi do të të vras". Tjetri tha: "Allahu pranon vetëm prej të devotshmit." (El-Maide, 27) Në këtë ajet i jepet më te-për rëndësi dimensionit shpirtëror të kurbanit se sa atij fizik.

Një ngjarje tjetër, e cila përmendet në Kur'anin Kerim në lidhje me "kurbanin", është edhe ngjarja e Ibrahimit (a.s.) me të birin e tij Ismailin (a.s.). Ibrahimi (a.s.) ishte një nga profetët e mëdhenj, që Allahu i madhëruar e kishte zgjedhur si mik duke i dhënë edhe titullin "Halil". (Shih. En-Nisa, 125)

Lufta e tij (Ibrahimit (a.s.) me Nemrudin ishte sprovë ndaj nefsit (egos) të tij, dhurimi në rrugë të Allahu i gjithçkaje që kishte, ishte sprovë për pasurinë e tij, ndërsa sakrifiki i djalit ishte sprovë për atë që kishte më të dashur. Ai doli me sukses nga të trija këto sprova, duke arritur kështu të fitonte titullin "Halil". Të sprovohesh me jetën, pasurinë dhe fëmijën nuk është diçka e thjeshtë. Të rezistosh ndaj tu-ndimive të nefsit dhe shejtanit dhe t'i kapërcesh kurthet që përgatitin ata, është një arritje shumë e madhe. Këtë ngjarje Kurani Kerim e tregon në këtë mënyrë: **"Dhe Ne i dhamë lajmin e gjuar për një djalë të mbarë! Kur fëmija u rrit aq sa ta ndihmonte në punë, Ibrahimi i tha: "O djali im, kam parë èndërr se duhet të të flipoj. Çfarë mendon ti?" – I biri i tha: "O ati im, vepro ashtu siç je urdhëruar! Dashtë Allahu, unë do të jem i durueshëm!" Pasi iu nënshtuan që të dy urdhrit, (Ibrahimi) e vuri (Ismailin) me ballë përtokë. Ne e thirrëm: "O Ibrahim, ti e përmbushe èndrrën." Vërtet, Ne kështu i shpërblejmë punëmirët! Kjo, me të vërtetë ka qenë një sprovë e qartë! Dhe Ne e zëvendësuam atë (Ismailin) me një kurban të madh, dhe i lamë atij (Ibrahimit) kujtim të mirë në brezat e mëvonshëm. "Paqja qoftë mbi Ibrahimin!" Ja, kështu, Ne i shpërblejmë punëmirët. Ai ka qenë vërtet një nga robërit Tanë besimtarë."** (Es-Saffat, 101-111)

Pa dyshim që kjo ngjarje ishte një sprovë. Sprovimi i një Profeti apo i dikujt tjetër me fëmijën e vet, përbën me të vërtetë një sprovë të vështirë. Me luftën e tij për triumfin e teuhidit dhe në çeshtjet e haxhit dhe kurbanit, Ibrahimi (a.s.) u bë simboli i umetit Islam. (shih. el-Mumtehine, 4)

Kurbania është një praktikë që njerëzimi e njeh që nga koha e Ademit (a.s.) dhe mbart në vetvete cilësi me dimensione të mëdha shpirtërore. Por, nëse zhvishet nga qëllimi i pastër, nga devotshmëria, nga pastrimi i shpirtit dhe kënaqësia e Allahut, kthehet thjesht në një vrasje dhe jo kurban.

Kurbania gjatë haxhit, si edhe kurbani jashtë kohës së haxhit, të dy kanë shumë dobi shpirtërore, sociale dhe ekonomike për njerëzit. Pikësëpari, kurbani tregon dorëzim dhe bindje ndaj urdhavrave të Allahut. Nuk është e lehtë që një njeri të therë me duart e veta kafshën që e ka rritur me mundime. Riti i kurbanit nënkuption se çdo gjë që kemi në këtë botë është vetëm një amanet për të cilin duhet të kujdesemi, dhe se përveç dashurisë ndaj Allahut asnjë dashuri tjetër nuk mund të jetë e pakufishme. Njëkohësisht, nëpërmjet këtij



riti njeriu bën kurban edhe ndjenjat njerëzore që e lidhin me këtë botë të përkohshme.

Kurbania është pranimi i dobësisë përballë fuqisë madhëshe-tore të Allahut. Kurban do të thotë të japësh prej asaj që e do më tepër dhe të zhvishesh prej pasioneve. Të jetosh me zemër mirënjojen ndaj mirësisë së dhënë dhe të jesh i vë-tëdijsëm se kjo mirësi të është dhënë për t'u ndarë me të tjerët. Kurbania është një lloj pendimi për të mbrojtur zemrën nga orientime që i përkasin të përkohshmes. Është mbrojtja e shpirtit duke e parandaluar mundësinë që epshet e egos të mposhtin zemrën. Pra është devotshmëri. Ajo që do të na neget prej kurbanit është vetëm ndjenja e devotshmërisë. Për rrjedhojë, mund të themi se, ashtu sikundër qëllimi i agjërimit është devotshmëria, ai i namazit është dhikri (përmendja e Allahut) dhe qetësia e shpirtit, ndërsa ai i zekatit është pastrimi shpirtëror e material, ashtu edhe urtësia e kurbanit është devotshmëria.

Kurbania që pritet për hir të Allahut duhet të ndahet me të tjerët, me qëllim që të bëhet shkak përfitimin e sevapeve. Ky është edhe përfitimi shpirtëror i kurbanit. Një herë, Resulullahu (a.s.) preu një kurban dhe urdhëroi që ai të shpërndahej. Në mbrëmje, kur i pyeti njerëzit e shtëpisë se "çfarë ngeli prej kurbanit?", nëna jonë Aishja (r.a.) iu përgjigj: "Për-veç kockës së kurrizit, u shpërndi i gjithi." Atëherë Resulullahu tha: "Pse nuk thua, përveç kurrizit të gjitha na paskan ngelur neve." (Tirmidhi, Kiamet, 33) Në këtë hadith shprehet qartë se shpërblimi shpirtëror i asaj që jepet për hir të Allahut do të shkruhet njësoj si fitimi që merret direkt në dorë.

Si përfundim, mund të themi se jo vetëm prerja dhe shpërndarija e kurbanit, por edhe shit-blerja e tij mundëson një gjallëri shumë të rëndësishme në jetën sociale. Si rrjedhojë, njerëzit që e sigurojnë jetën me anë të blektorisë, duke u fokusuar në përfitimet nga kafshët e shitura për kurban, mbarështojnë gjatë gjithë vitit dele ose lopë, ndërsa kohën e kurbanit e konsiderojnë si stinën e të korrave.

Të jesh njeri modest

Fatmir Hadri

M

Mendjemadhësia dhe kryelartësia janë veçoritë e moralit të keq, që krijojnë shqetësim dhe dëm të madh te njeriu. Ndërsa e kundërtë e saj, modestia, i sjell njeriut qetësi, kënaqësi dhe lumburi. Një njeri mendjemadh pretendon përherë se të gjitha cilësitë e bukura i përkasin vetëm atij. Për shembull: në vend që ta falënderojë Allahun për mendjen që i ka dhënë, ai mburret e vetëlavdërohet me atë. Kësosoj, duke u lavdëruar me veçoritë e mendjes së vet, ai mundohet gjithmonë t'i poshtërojë dhe t'i shohë të vegjël njerëzit e rrëthit të vet. Ai që sillet në një mënyrë të tillë nuk merr respekt dhe nuk konsiderohet i këndshëm në rrëthin ku jeton. Mbase të krijohet përshtypja se njerëzit e rrëthit mund ta duan, mund ta respektojnë, mund ta nderojnë, mund ta lavdërojnë, por ama respekti, nderimi, dashuria dhe lavdërimi i njerëzve të tjerë për këtë njeri nuk buron asnjeherë nga zemra, por vetëm nga frika dhe interes. Si rrjetohojë e kësaj, njerëzit kryelartë nuk kanë asnjeherë miq të sinqertë. Kështu që në rrëthin e tij ka gjithmonë njerëz që shtihen se e duan.

Një prej dëmeve më të mëdha që i bën vetes njeriu kryelartë, eshtë përpjekja për t'u parë nga njerëzit e rrëthit si njeri i patëmeta dhe pa mangësi. Për shembull, ashtu siç e përmendëm edhe më sipër, një njeri kryelartë që lavdërohet me mendjen e tij pretendon gjithmonë se eshtë më i

dituri në mesin e njerëzve. Për këtë arsy, ai nuk e pranon kurrë gabimin. Po edhe kur bën ndonjë gabim, mundohet ta fshehë prej njerëzve tjerë, madje eshtë në gjendje edhe të gënjejë, vetëm e vetëm që gabimi i tij të mos vihet re nga të tjerët. Ndërkaq, njeriu eshtë një kriesë shumë e dobët, ka mangësi dhe eshtë një kriesë që sprovohet në çdo çast të jetës së tij. Prandaj, gabimet dhe mangësitë e njeriut janë shumë të natyrshme. Kurse përpjekjet për t'i fshehur mangësitë para njerëzve të tjerë eshtë diçka shumë e panevojshme dhe e pakuptimtë.

Një ndjenjë tjetër që gjendet në epshin e njerëzve e që u shkakton më shumë brengosje, eshtë ndjenja e të qenit më të dobishëm sipas të tjerëve, për shkak të disa veçorive të tyre. Në të vërtetë, kjo eshtë një veçori e shejtani. Kur e krijoi Ademin (a.s.), Allahu i pati urdhëruar engjëjt dhe shejtani që t'i përruleshin Ademit (a.s.) në shenjë respekti. Engjëjt, duke qenë kriesa të krijuara me moral të bukur iu përulen menjëherë Ademit (a.s.), kurse shejtani e kishte refuzuar përuljen duke u justifikuar me këto fjalë:

Iblisi tha: "Unë jam më i mirë se ai. Mua më ke krijuar prej zjarrit, kurse atë prej balte." (Sad, 76)

Sic u njoftua edhe në ajetin kuranor, për arsy se e kishte parë veten e tij më të lartë se krijesat tjera, shejtani e teproi

aq shumë sa kundërshtoi edhe urdhrin e Allahut.

Kurani bën fjalë edhe për ata të cilët kanë devijuar ngaqë e kanë parë veten e tyre më të lartë. Për shembull, Jahudinjtë dhe të krishterët kanë devijuar duke thënë: **“Ne jemi bijtë e Allahut dhe të dashurit e Tij”**. (Maide, 18) Vetëm se ata, ashtu si dhe të gjithë njerëzit janë krijesa të dobëta e të mangëta, të krijuara nga Allahu. Prandaj asnjë njeri nuk mund të thotë: unë i fitova këto veçori dhe tani e tutje jam njeri i vlefshëm në rrëthin ku jetoj, sepse vlefshmëria fitohet vetëm duke iu afruar Allahut dhe duke kryer obligimet e fesë së lehtë, Islamit.

Përgjigja që Allahu u jep në Kuran atyre, të cilët e konsiderojnë veten e tyre më të lartë e më të privilegjuar është kështu:


“...Thuaj: Atëherë, përse Ai ju dënon për shkak të gjynave tuaja? Jo! Jujeni njerëz nga ata që Ai ka krijuar. Ai fal kë të dojë dhe dënon kë të dojë. Vetëm Allahut i përket sundimi i qiejve, i Tokës dhe i çdo gjëje që gjendet midis tyre. Dhe vetëm tek Ai kthehen të gjithë.” (Maide, 18)

Pretendimi për pamangësi dhe pagabueshmëri është një barrë shumë e rëndë për njeriun. Mundohen të bëhen të privilegjuar mes njerëzve, për këtë arsy mundohen ta mbajnë nën kontroll çdo gjë, dhe çdo herë përpiken të shfaqin sjellje këmbëngulëse. Për shembull, kur marrin pjessë në ndonjë mbledhje dëshirojnë ta tregojnë veten e tyre të mençur, të veshur mirë, dëshirojnë të flasin bukur dhe të bëhen zgjidhës të çështjes. Madje, edhe teksa janë brenda ndonjë mjedisi shoqëror mundohen të mburren, të dallohen prej të tjerëve dhe të tregojnë kulturë më të lartë, pa pranuar të përzihen asnjëherë me njerëzit që janë në dhomë apo me ndonjë kallaballëk tjetër. Për këtë arsy duket sikur janë “mbi gjemba (ferra)”. Asnjë lëvizje e tyre nuk vjen nga brendësia e shpirtit dhe nga natyrshmëria. Çdo gjë që bëjnë, e bëjnë në mënyrë të planifikuar dhe të përllogaritur, me qëllim që të mund të arrijnë synimin e tyre. Se sa torturë e madhe duhet të jetë kjo, dhe se sa e madhe duhet të jetë ngarkesa e barrës për njeriun, është diçka e dukshme.

Mirëpo, duhet të dihet se njerëzit mendjemëdhenj nuk do t'i arrijnë asnjëherë gjérat që synojnë. Sepse ata, sa më shumë mendjemëdhenj që bëhen, aq më shumë fitojnë edhe urejtjen e zemërimin e njerëzve të rrëthit të tyre. Në një ajet kuranor, Allahu e tregon kështu mosarritjen e qëllimit të mendjemëdhenjve:

Ata që polemizojnë për shpalljet e Allahut, pa pasur kurrfarë prove, kanë në zemrat e tyre vetëm mendjemadhësi, e cila nuk do t'i shpjerë në qëllimin e tyre. Prandaj kërko mbrojtje prej Allahut! Me të vërtetë, Ai i dëgjon të gjitha dhe i sheh të gjitha. (Gafir, 56)

Ashtu si nuk arrijnë të përm bushin asnjë dëshirë në jetën



e kësaj bote, njerëzit mendjemëdhenj nuk mund ta arrijnë as dashurinë e Allahut. Në një ajet kuranor, Allahu thotë kështu:


Mos i trajto njerëzit me nënçmim dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemëdhenjtë e mburracakët! (Llukman, 18)

Kurse njerëzit modestë nuk e përjetojnë asnjëherë pressionin dhe brengosjen që përjetojnë njerëzit mendjemëdhenj. Sigurisht, çdo njeri dëshiron të bëjë më të mirën, më të bukurën dhe më të vlefshmen e çdo gjëje. Vetëm se ata që i bëjnë këto për t'u rënë në sy njerëzve dhe për t'u ngorë me lakmitë e dynjasë, ata janë brenda një humbjeje të madhe. Kurse përsa i takon njeriut modest, ai e bën çdo gjë vetëm për ta fituar kënaqësinë, dashurinë dhe mëshirën e Allahut. Kur arrin diçka, apo kur bëhet zotërues i një gjëje të bukur, ai e di se këto nuk janë gjëra që i ka fituar vetë, por dhunti të Zotit që ia ka dhuruar vetes së tij. Po edhe kur e godet diçka e pakëndshme, apo kur humbet diçka, ai nuk shprehet në kundërshtim me atë që e ka urdhëruar Allahu. Kësosoj, ai e di se kjo situatë është një sprovë për të, andaj edhe i mbështetet Allahut për ta fituar më të mirën që rrjedh nga ajo sprovë. Në këtë mënyrë, ai e jeton qetësinë e ëmbëlsisë së besimit, duke mos u brengosur për gjérat e pakëndshme që i ndodhin.

Si përfundim, ai që e pëlqen vetveten gjen belanë (fat-keqësinë) dhe bie në vështirësi, kurse ai që nuk e pëlqen veten gjen qetësinë dhe shkon në mëshirë.

Këtë temë po e përfundojmë me një thënje të Muhammedit (a.s.) ku thotë:

“Nuk do të hyjë në xhenet ai që ka në zemrën e tij mendjemadhësi, qoftë dhe sa një grimcë e vogël e atomit.”



Shembëlltyra dhe mësimet e IBRAHIMIT (A.S.)

Nexhat Ibrahimi

Emri, personaliteti dhe veprimtaria e të Dërguarve të hershëm të Allahut (xh.sh.) është shembëlltyrë dhe thesar i pashtershëm për gjithë njerëzimin e sidomos për dijetarët myslimanë, për orientimin e tyre në rrugën e fesë së mirëfilltë. Por, ndër pejgamberët më të veçantë është Ibrahimit (a.s.), i cili është quajtur si një ndër pejgamberët e vendosur, kyç (ulu'l-azm).

Kurani i madhërishtëm i kushton Ibrahimit (a.s.) një vend shumë të veçantë. Suret kuranore si El-Bekare, El-En'am, El-Enbija, Merjem e të tjera, shpalosin jetën e tij plot vështirësi dhe sprova, të cilat ai i kalon me fuqinë e besimit të tij të pathyeshëm. Jeta e Ibrahimit (a.s.), është jetë sfide e tmerri, sprove e dhembjeje, jetë e cila thyen të gjitha stereotipet njerëzore dhe i ofron gjithë njerëzimit frymëzim të pafund.

KURESHTJA, RRUGË NJOHJEJE DHE BESIMI

Që në rininë e tij, Ibrahimi (a.s.) nuk pajtohej me gjenden ekzistuese besimore, etike dhe ekonomike të popullit të tij. Duke medituar e përsiatur, ai orvatet ta njohë Krijuesin e mirëfilltë. Natyra e pastër, intelekti i pakorrupturnar dhe besimi i tij i fuqishëm (që edhe para pejgamberisë së tij gjendej i struktur brenda tij), bën që ai të fitonte dritën e Allahut: “**Dhe kështu, Ne ia treguam Ibrahimit**

mbretërinë e qiejve dhe të Tokës, që ai të bëhej nga ata që besojnë vendosmërisht.” (El-En'am, 75).

Kureshtja e tij për të vërtetën, e provokuar me shikimin e yllit në qiell të hapur, e shtyu të thoshte “*Ky është Krijues im!*” (El-En'am, 76), e pastaj të hiqte dorë nga ai “krijues” sapo të konstatonte perëndimin e yllit, duke thënë: “*Nuk i dua ata që perëndoijnë.*” (El-En'am, 76).

E njëjtë gjë ndodhi edhe me Hënën e Diellin. Meqë populli i tij në Haran adhuronte Hënën e Diellin, Ibrahimi (a.s.) qorton:

“*Kur vërejti Diellin duke lindur, ai thirri: “Ky është Zoti im, ky është më i madhi!” Por, pasi dielli perëndoi, ai tha: “O populli im, unë jam larg nga idhujt që ju ia shoqëroni Allahut në adhurim!”*

“*Unë e kthej fytyrën time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë, dhe nuk jam nga idhujtarët!*” (El-En'am, 78-79.)

VEPRIMI, SENDËRTIM I BESIMIT

Banorët e Babilonisë adhuronin idhujt. Njëri prej tyre ishte edhe babai /xaxhai/ i Ibrahimit (a.s.), Azeri, siç e quan Kurani, apo Tarahu siç e quajnë judeo-kristianët,

por edhe disa dijetarë myslimanë.¹ I vetëdijshëm përgjendjen e babait, ai i drejtohet atij me tërë fuqinë e tij të besimit: *“Ai i tha të atit: “O babai im, përse adhuron atë që as nuk dëgjon, as nuk sheh e as që mund të të sjellë ndonjë dobi?”* (Merjem, 42).

Më tej, në suren El-En’am, Ibrahimim (a.s.) i drejtohet babait të tij, Azerit me dëshpërim e brengosje: *“...kur ai i tha të atit, Azerit: “A do t’i adhurosh idhujt si zotat e tu?! Unë vërtet po shoh se ti dhe populli yt jeni në humbje të madhe”.* (El-En’am, 74).

Edhe pse në shikim të parë Ibrahimim (a.s.) manifeston vrazhdësi dhe rreptësi ndaj idhujve, ai shpërthen nga dhembshuria, butësia e kujdesi për të gjithë, e sidomos përbabain. Edhe pse tregonte nënshtrim ndaj babait, në çështjen e besimit e këshillonte, sepse besimi kapërcen lidhjet biologjike: *“O babai im, mua më ka ardhur prej diturisë çfarë s’të ka ardhur ty; andaj ndiqmë mua dhe unë do të t’i udhëzoj në rrugën e drejtë!”* (Merjem, 43). *“O babai im, unë kam frikë se mos të vjen ndonjë dënim nga i Gjithëmëshirshmi...”* (Merjem, 45.)

Mirëpo, babai refuzoi thirrjen e të birit, madje refuzimi i tij karakterizohet me urrejtje, pezmatim dhe kërcënim: *“O Ibrahim! Si guxon t’i hedhësh poshtë zotat e mi?! Nëse nuk heq dorë, unë do të t’i mbys me gurë; andaj, largohu prej meje për një kohë të gjatë!”* (Merjem, 46)

Edhe pse kërcënimini ishte real, Ibrahimim (a.s.) nuk hoqi dorë nga përkujdesja përbabain e tij. Madje premtoi se do t’i lutet Zotit përtë: *“Shpëtimi qoftë mbi ty! Do t’i lutem Zotit tim që t’i falë. Me t’i vërtetë, Ai eshtë i mirë me mua.”* (Merjem, 47)

Shembulli i sjelljes së Ibrahimit (a.s.) ndaj babait të tij jobesimtar manifestojnë njeriun plot besim, dhembshuri e shpresë, por edhe këmbëngulës në idealet e tij: besimin në Zotin Një dhe të Vetëm.²

THYERJA E IDHUVJE

RRËNIMI I AMULLISË BESIMTARE TRADICIONALE

Kur nuk dha rezultat as fjala e mirë, as sjellja e mirë

1. Abdullah ibn Abbasi mendon se babai /xaxhai/ i Ibrahimit (a.s.) quhej Tarah, deri sa Ibn Kethiri mendon se këtë emër e ka marrë në bazë të idhullit të cilin e adhuronte. Shih: <http://www.iltizam.org/index.php?ime=tekstovi&tekstovi=tekst&id=2145541245>.

2. Shih: <http://www.iltizam.org/index.php?ime=tekstovi&tekstovi=tekst&id=2145541245>.

me babain dhe me vendasit e tij, ai ndërmori hapa më të fuqishëm, por edhe më të rrezikshëm, ashtu siç vepron mjeku me rastin kur sëmundja mund të mjekohet vetëm me operim: ai i përqmoi e pastaj edhe i rrënoi idhujt e popullit të tij. Së pari ai pyeti: *“C’janë këta idhuj, që ju po i adhuronin kaq shumë?”* (El-Enbija, 52)

Kurse përgjigjja e tyre ishte manifestimi i një gjendjeje besimi të trashëguar, i shpirtit letargjik dhe i gjendjes shpirtërore e intelektuale të verbuar dhe apatike. Ata këshin si kriteri vlerat tradicionale, duke shpërfillur vlerat e vërteta besimtare, ato racionale e të tjera: *“Baballarët tanë i adhuronin këta.”* (El-Enbija, 53)

Në këtë polemikë, Ibrahimim (a.s.) vendosi kritere të reja kundrejt bindjes së verbër dhe imitimit të të parëve, të cilat janë kritere dhe koncepte të Krijuesit, të treguara qartë në shpalljet e Tij: *“Me t’i vërtetë, ju dhe baballa-rët tuaj keni qenë në humbje të qartë.”* (El-Enbija, 54)


Të mësuar nga mirësjellja e deriatëhershme e Ibrahimit (a.s.), babai dhe bashkëvendasit pyesin të hutuar: *“A po na sjell të Vërtetën, apo je nga ata që tallen?”* (El-Enbija, 55)

Mirëpo, përgjigjja plot vendosmëri e Ibrahimit (a.s.) tregon epërsinë kundrejt popullit të tij: *“Jo, por Zoti juaj eshtë Zoti i qiejve dhe i Tokës. Eshtë Ai që i ka krijuar ato, ndërsa unë jam njëri prej atyre që e dëshmojnë këtë.”* (El-Enbija, 56)

Megjithatë, metodat e deritashme ishin pasive; ato nuk e provokuan më thellë ndërdijen e popullit të tij. Për këtë arsy, ai vendosi t’i radikalizonte veprimet, me qëllim që ata të mund të ndërgjegjësohen rrëth besimit të mirëfilltë: *“(Betohem) për Allahun, se do t’i flak idhujt tuaj, posa të largoheni ju!”*

“Dhe i bëri ata copa-copa, përveç idhullit të tyre më t’i madh, kështu që ata t’i drejtoheshin atij.” (El-Enbija, 57-58). Diskutimi filloj, por jo në një rrash cilësor, por në atë të mëparshmin: *“Ti i bëre kështu zotat tanë, o Ibrahim?”* (El-Enbija, 62)

Me mençuri e largpamësi, por edhe me një dozë ironie e rreziku, Ibrahimim (a.s.) u tha atyre: *“Jo! Këtë e ka bërë ky i madhi i tyre. Pyetini ata, nëse flasin!”* (El-Enbija, 63). Veprimi i Ibrahimit (a.s.) i detyroi ata që së paku të mendojnë për një çast: *“Me t’i vërtetë, ju vetë jeni keqbërësit.”* (El-Enbija, 64) Ata vazhduan në amullinë



dhe terrin e vjetër, sepse drita e vogël që për një çast vezulloi, nuk mjaftoi për ta zbutur indiferencën dhe letargjinë e tyre: ***"Sigurisht që ti e di, se këta nuk flasin!"*** (El-Enbija, 65).

Meqë populli i tij nuk shfaqi shenja serioze meditimi dhe as bëri përpjekje për t'u shkëputur nga e vjetra, Ibrahim (a.s.) e ngacmoi drejtpërdrejt atë hutimin e tyre momental, me shpresën se ata do ta pranonin propozimin e tij: ***"Mos vallë, ju adhuroni në vend të Allahut gjëra që nuk mund t'ju sjelljn kurrfarë dobie e as dëmi! Mjerë ju dhe mjerë ata që ju i adhuroni në vend të Allahut! A nuk arsyeton?"*** (El-Enbija, 66-67)

HEDHJA NË ZJARR,

SIMBOL I SPROVËS DHE BESIMIT KONSEKUENT

Mungesa e argumenteve e bën njeriun të dhunshëm. Kjo ndodhi edhe me popullin e Ibrahimit (a.s.). Ata nuk gjenin dot përgjigje përkatëse për sfidat e Ibrahimit (a.s.). Ata nuk mund të largoheshin nga tradita e gjatë idhujtare, edhe pse të bindur se është e pavlerë; nuk mund ta pranonin besimin e pastër, për shkak të injo-

rancës dhe të inatit që zgjonte injoranca. Në këtë gjende, ata thirrën në mënyrë të dhunshme: ***"Digjeni atë dhe ndihmoni zotat tuaj, nëse doni të bëni ndonjë vepër!"*** (El-Enbija, 68).

Të gjithë u përpoqën të jepnin ndihmën e tyre duke mbledhur dru për zjarrin e madh. Përmasat e zjarrit ishin të papara deri atëherë. Pas shpërthimit të zjarrit përcëllues, banorët e vendosën Ibrahimin (a.s.) në katapult, me këmbë dhe duar të lidhura, ndërsa ai pëshpériste: ***"Nuk ka zot tjetër përveç Allahut, qofsh i lavdëshëm o Krijues i botëve. Ty të takon tërë falënderimi dhe pushteti dhe Ti nuk ke rival!"*** Në çastin e hedhjes në zjarr, Ibrahim (a.s.) ka thënë: ***Hasbij>All-llahu ue ni'me'l-uekil*** (Allahu është i mjaftueshëm dhe Ai është mbrojtës i mrekullueshëm).³

Jo vetëm Ibrahimini e Muhamedi (a.s.), por edhe të gjithë thirrësit në të vërtetën do të hasin vështirësi dhe probleme të mëdha, andaj përgjigja duhet të jetë në frymën dhe shembullin e pejgamberëve.

ME BESIM TË PATHYESHËM DREJT KAPËRCIMIT TË SPROVAVE

Kjo botë është sprovë për njeriun. Kapërcimi i sprovave, eliminimi i pengesave në jetë dhe cilësia e angazhimit tonë janë parakushte për ndihmën e Allahut (xh. sh.) Besimi i çeliktë i Ibrahimit (a.s.), vullneti i ndërgjegjshëm dhe inteligjenca e mirëfilltë, janë disa nga faktorët që e thirrën ndihmën e Allahut, edhe pse çdo gjë dukej e pazgjidhshme.⁴

Veprimi i Ibrahimit (a.s.) na mëson se ndihma nuk kërkohet nga Lindja apo Perëndimi, nga partitë politike apo forcat relevante të kohës, por vetëm nga Allahu, Krijuesi i botës: ***"Ne thamë: O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin!"*** (El-Enbija, 69)⁵

3. Këto fjalë i tha Ibrahimini (a.s.) me rastin e hedhjes në zjarr. Por, këto i tha edhe Muhammedi (a.s.) në çastin kur i qe thënë: "Armiqët po tubohen për shkakun tuaj, duhet t'ju ruheni, kjo ua forcoi besimin dhe thanë: Hasbun>Allahu ue ni'me'l-uekil (Neve na mjafton Allahu dhe Ai është mbrojtës i mrekullueshëm). (Ali Imran, 173)

4. Se'id ibn Xhubejri transmeton nga Ibn Abbasi (r.a.) se meleku i shiut e priste me padurim urdhërin e Allahut të lëshojë shi për ta fikur atë zjarrë të madh e përcëllues, por urtësia e Allahut ishte që Ibrahim i t'i plotësojë kushtet njerëzore dhe ta meritonte ndihmën e Allahut f.p.

5. Ibn Abbasi (r.a.) thekson se sikur Allahu mos të kishte thënë "dhe shpëtim për Ibrahimin", ai do të ngrivej nga ftohtësia.

**SHFRYTËZIMI LARGPAMËS I METODAVE
BESIMTARE-PRAKTIKE DHE IKJA PËRBALLË
ASIMILIMIT**

Nga shqyrtimi dhe analizimi i ajeteve kuranore rezulton se Ibrahim (a.s.) ka shfrytëzuar diturisht, urtësisht dhe shkathësisht një varg metodash të da'ves: *"A nuk ke dëgjuar ti (Muhammed) për atë që bëri fjalë me Ibrahimin për Zotin e tij, sepse Allahu i kishte dhënë pushtet? Kur Ibrahim i tha: "Zoti im është Ai që jep jetë dhe shkakton vdekje"- ai u përgjigj: "Edhe unë mund të jap jetë e të shkaktoj vdekje". Ibrahim pastaj i tha: "Allahu e sjell Diellin nga lindja. Sille ti nga perëndimi!" Atëherë, ai (mohuesi) mbeti me gojën hapur. Allahu nuk i udhëzon ata që janë keqbërës."* (El-Bekare, 258)

Ibrahim (a.s.) pas shpëtimit nga zjarri dhe pas daljes nëpër mjedise, zhvilloi këtë dialog të zjarrtë. Ai synonte ta bindte mbretin e Babiloninë, sepse bindja e tij në Islam do të thoshte pranim i Islamit nga shumë banorë të Perandorisë. Mirëpo, këmbëngulësia e Nemrudit (apo e klasës sunduese në histori, si çdoherë) e refuzoi ftesën, duke pretenduar madje se ai mund t'uaj jepte dhe t'uaj merrte shpirrat njerëzve.⁶

Mirëpo, metodat e shkëlqyera të Ibrahimit (a.s.) lanë pa prova mbretin babilonas, e bënë konfuz dhe e lanë gojëhapur; ai kishte forca ushtarake, por përballë forcës së argumenteve hyjnore u tregua tërësisht i pasigurtë dhe dështues.

Prandaj, Ibrahim (a.s.) është shembelltyrë edhe në misionin e thirrjes. Përdori shumë mënyra, sinqerisht dhe këmbëngulësish. Edhe sot, thirrësi do të jetë parimor në thirrjen e tij, qoftë edhe i vëtmuar apo pakicë në idenë që ndjek: *"Po largohem nga ju dhe nga gjithçka që ju adhuronin në vend të Allahut. Do t'i lutem Zotin tim, sepse jam i sigurt se nuk do të jem fatkeq me lutjet që ia bëj Zotit tim."* (Merjem, 48.)

Nëse manifestohet minimum i besimit, Allahu e kompenson atë me vlera shumëfish më të bollshme se sa ato që kemi pasur. Rasti i Ibrahim (a.s.) është më eklatant: *"Dhe, kur u largua nga ata dhe nga idhujt që i adhuronin në vend të Allahut, Ne i dhuruam atij Is'hakun*

6. Katade dhe Ibn Is'haku thonë se Nemrudi i nxori dy persona nga bu-gu, njërin e mbyti e tjeterin e la në jetë. Kjo e nxiti të klithë se "Unë ngjalli e mbyti".



dhe Jakubin dhe që të dy i bëmë profetë. Ne u dhuruam atyre mëshirën Tonë dhe bëmë që ata të lavdërohen e të përmenden me nder." (Merjem, 49-50)

Duke u vënë në kërkim të vendit ku besimi do të gjente shtrirje më të mirë, Ibrahim (a.s.) e lëshoi vend-lindjen, familjen dhe popullin, por Allahu i Lartësuar ia kompensoi këtë sakrificë me një vend tjetër më të mirë se i pari. Pasardhësit e rinj u bënë më të shumtë se ata të parët, kurse nga familia e tij Allahu bëri shumë pej-gamberë (Is'hakun dhe Ismailin etj.), të cilët drejtuan botën dhe përhapen të mirën. Allahu i solli fund të mirë Ibrahimit (a.s.), çfarëdo që të dëshironte çdokush para dhe pas tij.

Jeta e Ibrahimit (a.s.), ashtu si edhe e tërë pejgamberëve është thesar i pashtershëm për të gjitha kohët dhe hapësirat, prandaj e kemi për detyrë që në angazhimet tonë besimore dhe praktike t'i shfrytëzojmë këto metoda, për prezantimin sa më të lehtë e më të frytshëm të fjalës së Allahut (xh. sh.).

Këshilla të arta nga Kurani Famëlartë



“Bëni tavaf Qabenë, përmendni Allahun tek vërshoni duke zbritur nga Arafati”

QABJA:

“Kujtoni kur Ne e bëmë Qabenë vend grumbullimi dhe sigurie për njerëzit, duke thënë “Bëjeni vendin e Ibrahimit si vendfaljeje!” Ne i urdhëruam Ibrahimin dhe Ismailin: “Pastrojeni Shtëpinë Time (Qabenë) për ata që e vizitojnë, që rrinë aty për adhurim dhe që falen duke u përkulur dhe përulur.”” (**Bekare, 125**)

HAXHI: NË MUAJ TË CAKTUAR

“Kryeni haxhin dhe umren për hir të Allahut! Nëse në këtë rrugë pengoheni, atëherë therni kurban, sipas mundësisë, dhe mos i rruani kokat tuaja, derisa të arrijë kurbani në vend! Cilido prej jush që është i sëmurë ose që ka ndonjë plagë në kokë (dhe si i tillë, nuk mund ta rruajë kokën), le ta zëvendësojë me agjërim, lëmoshë ose kurban. Kur të jeni të sigurt (nga armiqtë), ai që prej jush kryen umren deri në haxh, le të therë kurban, sipas mundësisë. Ndërsa ai që nuk ka mundësi, është i detyruar të agjerojë tri ditë në haxh dhe shtatë ditë pas kthimit nga haxhi; këto janë dhjetë ditë të plota. Kjo është për ata që nuk banojnë në Mekë. Ta keni frikë Allahun dhe dijeni se Ai dënon ashpër.”

Koha e haxhillëkut është në muaj të caktuar. Kush vendos të kryejë haxhillëkun, le të largohet nga marrëdhëni (me gruan), grindjet dhe sharjet. Ndërkaq, çdo vepër të mirë që bëni, Allahu e di. Pajisuni me gjërat që ju nevojiten për rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria. Prandaj, kini frikë prej Meje, o njerëz të

mençur!”

Nuk është gjynah të kërkoni nga Zoti juaj ndonjë të mirë. E, kur të ktheheni nga Arafati, përmendni Allahun në vendet e shenja! Përmendni Atë që ju ka udhëzuar në rrugën e drejtë, sepse ju më parë ishit të humbur!”

Pastaj, kthehuni, siç kthehen të gjithë të tjerët dhe kërkoni ndjesë prej Allahut! Se Allahu është Falës i madh dhe Mëshirëplotë.”

Pasi t'i kryeni ritet e haxhillëkut, përmendni Allahun ashtu siç i kujtoni prindërit tuaj, madje edhe më tepër! Disa njerëz thonë: “Zoti ynë, jepna të mira në këtë botë!” Por, për këta, s'ka asnjë të mirë në botën tjeter.”

Por ka dhe të tjerë që thonë: “Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në botën tjeter dhe na ruaj nga dënim i Zjarrit (të Xhehenemit)”.

Këtyre do t'u jepet shpërblim për atë që kanë bërë. Allahu është i shpejtë në llogari.” (**Bekare, 196-202**)

HAXHI:

“Vërtet, ata që nuk besojnë dhe pengojnë njerëzit nga rruga e Allahut dhe nga Xhamia e Shenjtë, të cilën Ne e kemi bërë të njëjtë për të gjithë njerëzit, si përvendasin ashtu edhe për atë që vjen nga tjetër vend dhe, ata që synojnë ta përdhosin (Xhaminë), me të keq, Ne do t'i bëjmë të shijojnë dënim të dhembshëm.”

Kujtoje kur Ne vendosëm për Ibrahimin vendin e Fal-

tores (duke e urdhëruar): "Mos më shoqëro asgjë (në adhurim) dhe pastroje Shtëpinë Time (nga idhujtaria), për ata që vijnë rrotull saj (në shenjë adhurimi) dhe për ata që rrinë në këmbë, përkulen dhe bien në sexhde duke u falur."

Thirri njerëzit për haxhillëk: ata do të vijnë në këmbë dhe me deve prej të gjitha viseve të largëta, që të dëshmojnë dobitë e tyre dhe të përmendin Emrin e Allahut në ditët e caktuara mbi kafshët (për kurban), të cilat ua ka dhuruar Ai. Hani nga ato (mishin) dhe ushqeni nevojtarin e varfër!"

Pastaj, haxhinjtë le të pastrojnë trupin e tyre, le t'i kryejnë zotimet e tyre dhe le t'i vijnë rrotull Shtëpisë së lashtë." (**Haxhxh, 25-29**)

GJATË IHRAMIT:

"O besimtarë! Plotësoni detyrimet! Ju është lejuar ngrënja e kafshëve, përveç atyre që do t'ju njoftohen. Derisa të gjendeni në Ihram gjatë haxhit, nuk ju lejohet gjuetia. Vërtet, Allahu vendos çfarë të dëshirojë."

O besimtarë! Mos e cënoni shenjtërinë e simboleve të Allahut, as të muajve të mëdhenj, as të kurbanit të Qabesë, as të kurbanëve të shënuar me gjerdan, as (mos i pengoni) ata që janë nisur të vizitojnë Shtëpinë e Shenjtë, duke kërkuar mirësinë dhe kënaqësinë e Zotit të vet. Pas heqjes së Ihramit, gjuani. Dhe, të mos ju nxisë urrejtja ndaj disa njerëzve, që ju penguan të viziton Qabenë,



pra, kurrsesi të mos ju nxisë që t'i sulmoni! Ndihmojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat dhe jo në gjynahë dhe armiqësi! Frikësojuni Allahut, sepse Ai dënon ashpër." (**Maide, 1-2**)

NËSE NUK I BINDENI NDALESAVE GJATË IHRAMIT

"O besimtarë! Mos gjuani, duke qenë në Ihram! Kushdo që e vret gjahun me paramendim, për dënim duhet të therë si kurban në Qabe, një kafshë shtëpiake të ngashme me kafshën e gjuajtur, sipas vlerësimit të dy njerëzve të drejtë midis jush; ose të ushqejë disa të varfër pér të larë gjynahun; ose të agjerojë në atë masë, që ta ndiejë ndëshkimin pér gjynahun e bërë. Allahu e fal atë që ka kaluar (para ndalimit). Ndërsa atë që vepron pas ndalimit, Allahu do ta ndëshkojë. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Zoti pér shpagim." (**Maide, 95**)

"Bëni kurban me emër të Allahut"

KURBANI: PËR ÇDO POPULL

"Për çdo popull, Ne kemi caktuar një ritual, që ata të përmendin emrin e Allahut gjatë flijimit të kafshëve, që Ai ua ka dhuruar pér ushqim. Zoti juaj është një Zot i vetëm, prandaj vetëm Atij péruljuni. Dhe jepu lajme të mira atyre që janë të pérulur." (**Haxhxh, 34**)

"Devetë dhe gjedhët i kemi bërë pér ju si një nga ritet e Allahut pér flijim dhe ju keni dobi nga ato. Prandaj, përmendeni emrin e Allahut mbi ato, ndërsa i radhisni në këmbë (pér t'i therur). Kur ato të bien në tokë, hani prej (mishit të) tyre dhe ushqeni edhe atë që lyp, edhe atë që nuk lyp. Kështu pra, Ne i kemi vënë ato në shërbimin tuaj, që ju të jeni mirënjosës."

Tek Allahu nuk arrin as mishi, as gjaku i tyre, por arrin përkushtimi juaj. Kështu, Ai i ka vënë ato në shërbimin tuaj që ju ta madhëroni Allahun sepse ju ka udhëzuar. Dhe, jepu lajmin e mirë, punëdrejtëve!"

Allahu, në të vërtetë, i mbron besimtarët. Ai nuk i do tradhëtarët mohues." (**Haxhxh, 36-38**)

... DHE THER KURBAN

"Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty shumë të mira, Andaj, falu (vetëm) pér Zotin tënd dhe ther kurban! Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është fatprerë." (**Keuther, 1-3**)



Konflikti dhe dialogu ndërkulturor

Rrustem Spahiu

Fetë nuk pajtohen me njëra-tjetrën jo vetëm në bazë të cilësive të tyre teologjike, por as në bazat e doktrinës fetare. P.sh.: Krishterimi dhe Islami shpesh herë konfrontohen në planin e doktrinave të tyre teologjike. Krishterimi nuk e pranon Muhamedin (a.s.) si të dërguar të Zotit, ndërsa Islami nuk e pranon Jezu Krishtin si birin e Zotit. Këto janë thjesht dallime.

Në thelb këto dy religjione nuk mund të pajtohen. Kështu, e vëmja gjë që mbetet është toleranca dhe mirëkuptimi ndërmjet pjesëtarëve të këtyre feve. Ta tolerojmë dhe ta mirëkuptojmë besimtarin e besimit tjetër, duke pasur kujdes që të mos i cungohen të drejtat e tij për të besuar ndryshe në Zot, ose për të mos besuar fare.

Është e mundur që në mesin e dy ose tri religjioneve të ekzistojë toleranca me sistematizimin e parimeve të tyre themelore. P.sh.: Dhjetë urdhëresat – janë një shembull i të vërtetave të përbashkëta. Dhjetë urdhëresat – përbënë një begati që respektohet nga të krishterët, myslimanët dhe hebrenjtë.

Mirëpo, kur është fjala për konfliktin dhe dialogun, konsiderojmë se secila kulturë sot është një hapësirë për takim me njerëzit e tjerë, me ata njerëz të cilët nuk i takojnë fesë tuaj. E posaçërisht na begatojnë ato kultura, të cilat janë paraqitur si prodhim i punës shumëvjeçare universale të shpirtit religjioz. Ne kënaqemi me letërsinë, artin dhe arkitekturën e tyre. Nuk i shikojmë se prej cilit besim fetar burojnë, por në radhë të parë shikojmë vlerën e vërtetë universale që kanë arritur.

Sot duhet të afirmohet biseda, takimi dhe mirëkuptimi i njerëzimit nëpërmjet kulturave të ndryshme. Sidomos tani, kur në disa pjesë të hemisferës perëndimore janë shpërngulur me miliona myslimanë, çështja e takimit dhe dialogut të

kulturave përbën ndoshta një prej çështjeve kryesore me të cilën duhet të merren filozofët, teologët dhe letrarët myslimanë që jetojnë në perëndim. Kjo është detyra e tyre më e rendësishme.

Sot duhet të jemi të vetëdijshëm se teknika ka arritur t'i zbulojë ose t'i bëjë të dukshme të gjitha religionet.

Fakti është se teknika është këtu e po ashtu edhe fakti i globalizimit. E tërë kjo gjendet në mesin tonë. Ky është produksi ynë, i cili shpesh herë punon vetveti, duke prodhuar rezultate pa dëshirën tonë. Me faktin e teknikës dhe të globalizimit,jeta ndërthuret me shumë shanse të mira, por gjithashtu edhe në shumë rreziqe.

Mirëpo, ashtu si Krijuesi ynë, Zoti e ka pranuar riskun – që me krijimin e njeriut – për të parë se si krijesat e Tij gabojnë e i kundërvihen, po kështu edhe ne, duke kultivuar globalizimin dhe teknikën, duhet t'i pranojmë patjetër të gjitha rreziqet e veprave tona e të përpinqemi t'i çojmë gjérat në drejtimin pozitiv dhe drejt veprave të mira.

Duhet ta pranojmë patjetër faktin se sot teknika dhe globalizimi kanë hapur shanse të pa paramenduara për takimin e kulturave, por gjithashtu kanë krijuar edhe hapësirë për ndeshjen e kulturave.

Sot të gjithë jemi të dukshëm për të gjithë. Sot është e vështirë të gjendet diku ndonjë botë tradicionale e paprekur, tek e cila nuk ka arritur ende makina jonë ose e huaj, kamera, syri ose veshi elektronik.

Takimi i kulturave dhe dialogu ndërmjet tyre përbën sot imperativin e kohës. Pse? Sepse sot religionet dhe kulturat e tjera nuk janë më enigmë. Askush nuk mund ta përjetojë më përvojën e Marko Polos, i cili ishte një ndër udhëtarët e rrallë të krishterë që udhëtuan nëpër Persi, Mongoli dhe në Kinë e

vjetër, por as që mund t'i përsërisin përjetimet e El-Biruniut, i cili ishte një ndër myslimanët e rrallë që pati qëndruar në pagodat budiste të Indisë. Siç u tha më lart, tema e takimeve ose e konfrontimeve mes kulturave të shtë një çështje me shumë rëndësi për Islamin dhe myslimanët bashkëkohorë. Në pozitën e vet të kartës religjioze të botës, sot myslimanët janë përfshirë në procesin e fuqishëm të ndeshjes me kultura dhe religjione të reja.

Po përmend faktin se duke filluar që prej rrafshnaltës së Uralit e deri në Los Angeles ka më shumë se 50 milionë myslimanë. Disa janë autoktonë, si për shembull shqiptarët e boshnjakët në Ballkan; disa janë të ardhur në numër të madh prej valëve të shumta të migrimit ekonomik, arabët në Francë, Bangladeshasit në Britani të Madhe; disa janë konvertuar, ndërsa kategoria e katërt, por dhe e tretë mbeten myslimanët në perëndim. Te këta të fundit, pra te myslimanët në perëndim, gjuha e tyre amtare të shtë shpesh herë anglishtja, gjermanishtja, ose frëngjishtja.

Jemi dëshmitarë të kundërthënive në mes të myslimanëve në perëndim dhe shoqërisë shekullore në perëndim, por këto fërkime më shumë paraqiten në rastet kur emigracioni mysliman e shpreh kulturën e vet, shpesh edhe kulturën e tij fisnore, të cilën e ruan me nostalги. Këtu myslimanët lokalë bien në kundërshtim me atë që në perëndim të shtë konsideruar si plotësisht universale.

Në perëndimin e sotëm, kjo paraqitje klanore e lokale, sado që disa myslimanë mendojnë se ajo të shtë vetë burimi dhe thelbi i kulturës së tyre islame, në të vërtetë i getoizon, i izolon dhe i marginalizon ata.

Të kuptohemi, nuk dëshirojmë të ndalojmë askënd që t'i përbahet traditës lokale. Dëshirojmë të vëmë në pah se ne myslimanët duhet të përzicjmë lokalën me atë që e bën islamin universal, ose me atë që në Islam të shtë universale. Tradita lokale të shtë përdorimin privat, kurse universalja të shtë përdorim të përgjithshëm. Lokalja i jep hapësirë të ngushtë, kurse universalja i jep hapësirë të gjerë e të begatshme.

Sot në Evropë dhe përgjithësisht në perëndim, shohim se nuk ekziston ndonjë xhami në mënyrë universale, por ekzistojnë xhamia e Bangladeshit, e Turqisë, arabe, shqiptare etj. Ne myslimanët i habisim perëndimorët më shumë islam, dhe kështu jemi inferior në raport me aftësitë që kishin myslimanët klasikë në Bagdad, Kordovë, Kajro, Isfahan, Istambull, Buhari dhe Samarkand, sepse myslimanët e kohës klasike kishin në tokat tradicionale islame xhami të organizuara në mënyrë universale.

Sot edhe në mesin e vetë myslimanëve ekzistojnë fërkime kulturore mes asaj që të shtë universale myslimanë dhe të asaj që shtë klanore.

Jemi dëshmitarë, se sot bota myslimanë shtë e përblytur me propaganda të ndryshme, por më shumë bota arabe, propagandistë, të cilët pohojnë me agresivitet se një tip i pantallovanë shtë islam ndërsa të tjerat jo, se vetëm një tip i ngjyrës

se rrobave shtë islame e tjerat jo, se vetëm një tip i mjekrës shtë islame e të tjerat jo, se vetëm një tip i uljes shtë islame e tjerat jo, se vetëm një tip i shamisë ose i frizurës shtë islame e tjerat jo etj.

Konsiderojmë se ky tip i monizmit brutal të ideologjisë islame në kulturë nuk na sjell asnjë dobi. Këtu kemi të bëjmë me një radikalizëm të rrezikshëm, i cili e privon fenë tonë islame nga freskia, lehtësia, akomodimi, çiltërsia.

Duhet theksuar fakti se myslimanët e sotëm janë akoma të paftë që ta bëjnë perëndimin mysliman në planin e kulturës...

Kur themi perëndimin mysliman, nuk mendojmë që në një anë gjeografike të botës që quhet perëndim, duhet të jenë vetëm myslimanët. Jo! Me nacionin perëndimi mysliman aludojmë, që entitetin kulturor, së bashku me shkëmbimin e kulturave, të jetojë në harmoni me bashkësinë krishtere, me bashkësinë hebreje e me bashkësinë sekulare të qytetërimit perëndimor etj.

Po e cekim edhe një tezë të rëndësishme mbi të cilën mund të debatojmë gjatë. Sa më shumë universale të jetë një kulturë, sa më shumë që përqafohet jo vetëm prej atyre që e konsiderojnë të vetën, por edhe nga të tjerët, aq më pak do të kemi kundërthënie e fërkime ndërmjet kulturave universale.

Gjithsesi, kur të shtë fjala për myslimanët në perëndim, duhet të cekim edhe kundërthënet në planin politik dhe në atë të programeve politike.

Shumë politika dhe politikanë në perëndim mund t'i theksojnë se kanë paragjykime ndaj myslimanëve në perëndim, sikur të ishte rrethimi i Vjenës nga forca osmane. E pra ky të shtë vetëm njeri prej shkaqeve që sot myslimanët integrohen me shumë vështirësi në politikë në shoqëritë perëndimore.

Qëndrimi ynë shtë se myslimanët në perëndim sot nuk duhet t'i ikin formimit të partive klerikale, religjioze ose nacionale, sepse kjo përbën një shans për integrimin në partitë politike dhe në forumet qytetare në perëndim. Aty duhet të integrohen dhe të marrin pjesë në shoqëri si qytetarë të barabartë.

Çdokush që shpalos sot flamin politik islam në perëndim, vepron pa përgjegjësi edhe ndaj vetë myslimanëve, duke iu fshirë shanset që ata myslimanë kanë para vetes në planin e afirmimit universal të fesë, të kulturës dhe civilizimit të tyre.

Besimi i të vërtetave Islame – e ato nuk janë shumë dhe nuk janë të komplikuara – në asnjë mënyrë nuk varen nga fakti se ekziston apo nuk ekziston halifa, se jemi në atë zonë kulturore e gjuhësore. Ajo që na nevojitet për aplikimin e besimit tonë shtë liria. Në pesëdhjetë vitet e fundit Europa ka treguar se në të shumtën e rasteve di ta sigurojë lirinë e të gjitha feve.

Kultura shtë edhe dhënie e marrje. Me besimin e tyre universal dhe kulturën e tyre universale, myslimanët në Evropë kontribuojnë në zhvillimin e këtyre paraleleve. Me veten e tyre ata e evropianizojnë Islamin në mënyrë natyrale, por gjithashtu në mënyrë natyrale dhe pa konflikte, ata në vete dhe për vete islamizojnë Evropën.

Gostari dhe mysafirët

Mësuesi është si gostari në shtëpinë e vet. Nxënësit e tij janë ata që përpiken të mësojnë Rrugën, por që nuk kanë qenë kurrë ndonjëherë në shtëpi. Ata kanë vetëm një ide të vagullt rreth imazhit të shtëpisë, e megjithatë shtëpia ekziston. Kur mysafirët hyjnë në shtëpi dhe shohin përsëpari sallonin, dhe pyesin: "Çfarë është?", marrin përgjigjen: "Është vendi ku rrighet". Atëherë ata ulen nëpër karrige, por prapë kanë vetëm një ide të turbullt rreth funksionit të karriges.

I zoti i shtëpisë, gostari, i zbavit, por ata nuk reshtin së bëri pyetje, ndonjëra prej të cilave është e papërfillshme. Por gostari i mirë nuk i qorton për këtë; për shembull, ata duan të dinë ku dhe kur do të hanë. Nuk e dinë se askush nuk është vetëm, që pikërisht në atë çast ca njerëz të tjerë janë duke gatuar në kuzhinë, e që ekziston një tjetër dhomë ku ata do ulen për të ngrënë. Janë në dilemë, sepse nuk po e shohin as ushqimin dhe as procesin e përgatitjes së ushqimit, ndoshta dyshues e nganjëherë edhe në siklet.

Gostari i mirë, i cili i njeh problemet e mysafirëve, bën çmos që ata të ndihen mirë, me qëllim që të mund ta shijojnë ushqimin kur të vijë. Në fillim, miqtë nuk janë në gjendje t'i afrohen ushqimit.

Disa mysafirë janë më të shkathët se të tjerët për të nxënë, dhe i kuptojnë marrëdhëniet mes elementeve të ndryshëm të shtëpisë. Këta ia dalin të komunikojnë me miqtë që janë më të ngadalshëm. Në këtë rrethanë, gostari i jep çdo mysafiri atë përgjigje që i përshtatet af-

tësise për të kuptuar unitetin dhe funksionimin e shtëpisë. Nuk është e mjaftueshme që shtëpia të ekzistojë, të jetë e gatshme për të pritur mysafirë e që gostari të jetë i pranishëm. Duhet që ndokush ta ushtrojë në mënyrë të gjallë detyrën e gostarit, me qëllim që të huajt, që janë mysafirë e për të cilët gostari merr përsipër përgjegjësitet, të mund të mësohen me shtëpinë. Fillimisht, shumë prej tyre nuk e kanë vetëdijen e të qenit mysafirë ose, më saktë, nuk janë të vetëdijshëm se ç'do të thotë të jesh mysafir: pra, ç'është ajo që mund të japid e ajo që mund të marrin në një gjendje të tillë. Mysafiri me përvojë, që i ka njojur shtëpitë, me kalimin e kohës ndihet rehat në kushtet e të qenit mysafir, e veç kësaj është në gjendje të kuptojë më mirë çdo gjë që lidhet me shtëpitë dhe situatat e ndryshme të jetës nëpër shtëpi. Përsa kohë që është i përkushtuar për të kuptuar se ç'është shtëpia ose për të sjellë ndërmend rregullat e etikës, vëmendja e tij është tepër e zënë prej këtyre faktorëve që të mund të jetë në gjendje të vëzhgojë, për shembull bukurinë, vlerën, apo funksionimin e objekteve që gjenden aty.

Thuhet se kjo parabolë e nderuar, e shkëputur nga mësimet e Nisamudin Awlia (shek. XIV), mund të funksionojë në disa rrafshë kuptimore. Lidhet me rendin e funksionimeve të ndryshme të mendjes, që mund të na lejojë njëfarë perceptimi të epërm për t'u zhvilluar. Versioni i paraqitur këtu, vjen nga një dorëshkrim, sipas të cilit thuhet se është rrëfyer nga mjeshtri Amir-Sajed Kulal Sokhari, që pati vdekur në vitin 1371.

Bajazidi dhe egoisti

Një ditë, një njeri shkoi të takonte Bajazidin, mistikun e madh të shekullit IX, me qëllim që ta qortonte. Njeriu i tha se, kishte agjëruar, ishte lutur dhe se i kishte zbatuar një për një këshillat e tij për plot tridhjetë vite, por pa e mbërritur lumninë për të cilën Bajazidi i kishte pasë folur dikur. Bajazidi i tha se edhe nëse do vijonte kështu edhe për treqind vjet të tjera, prapëseprapë nuk kishte për ta mbërritur atë që kërkonte.

-Si është e mundur?- , pyeti njeriu që mëtonte të ndriçohej.

-Sepse krenaria jote të pengon-, u përgjigj Bajazidi.

-Tregomë ndonjë zgjidhje-, iu lut burri.

-Një zgjidhje është, por nuk mund ta realizosh-.

-Ma thuaj gjithsesi.

Atëherë Bajazidi tha:

-Shko te berberi dhe rruaje mjekrën tënde të adhuruar. Hiqi të gjitha rrobat dhe lidhe belin me një litar. Mbush një trastë me arra, vare në qafë, dhe vërtitu nëpër sheshin e tregut duke thënë: "I jap një arrë çdo çunaku që ma ngjesh me një shpullë qafës". Në fund, paraqitu në gjyq me qëllim që gjyqtarët të mund të të shohin.

-Por unë nuk mund t'i bëj tërë këto! Të lutem, më jep ndonjë mësim tjetër që mund të ketë të njëjtin efekt.

-Ky është hapi i parë dhe i vetëm,- tha Bajazidi. Të thashë se nuk do mund ta realizoje. Kësisoj, ti e ke të pamundur të kurohesh.

Rrëfyer nga: El-Gazali. Sufiu që përmendet në këtë parabolë, duhet të jetë i madhi Bajazid Bistamî.



Një Ajet

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!

“Në të ka shenja të qarta (që janë): Vend i Ibrahimit (mekami Ibrahim); (fakti që) kush hyn në të është i sigurt; dhe vizita (për haxh) e kësaj Faltoreje (e cila është detyrë) për këdo që ka mundësi ta përballojë rrugën. E kush nuk beson, Allahu nuk ka nevojë për askënd.” (Ali Imran, 97)

Fjala “Haxh” do të thotë të synosh diçka, të bësh një vizitë diku. Sipas terminologjisë islame haxh do të thotë: “Qëndrimi për një kohë në Arafat nga dita e Arefesë e deri në lindjen e diellit ditën e bajramit dhe më pas tavafi i Qabes”. Shprehja që kalon në ajetin e mësipërm “për këdo që ka mundësi ta përballojë rrugën” ka të bëjë me fuqinë dhe mundësinë e duhur që duhet të ketë besimtari për të kryer këtë obligim aq të rëndësishëm. Siç dihet haxhi përbën një nga pesë kushtet e Islamit duke qenë edhe i fundit që është bërë farz. Për këtë dëshmon edhe ajeti në fjalë.

Pejgamberi (a.s.) në lidhje me shprehjen “Mundësi përballimi” është shprehur se bëhet fjalë për ushqim dhe kafshë udhëtimi” (Shihni Tirmidhi, Haxh, 14; Ibn-I Maxhe, Menasik, 6, 16) Sipas një transmetimi të Tirmidhiut Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Kush nuk bën haxh edhe pse ka mundësi të gjejë ushqim dhe kafshë udhëtimi për të mbërritur deri në shtepinë e Allahut, në Qabe, është njësoj si të vdesë jahudi apo i krishterë”

Shprehja “e kush nuk beson” është komentuar si: “Kush nuk bën haxh edhe pse i ka kushtet dhe mundësitë”. Shah Velijullah ed-Dihlevi ka thënë: Të lësh pa plotësuar njërin prej kushteve të Islamit është e njëjtë si të dalësh nga feja. Përsa i përket kuptimit të hadithit të lartpërmendur domethënë duhet të ketë të bëjë me jahuditë dhe të krishterët e kohës së pejgamberit të cilët edhe pse falmi namaz nuk bën haxh apo e mushrikëve arabë të cilët bën haxhit të kundërtën, pra edhe pse bën haxh nuk falmi namaz. Haxhi është një **farz** për t'u kryer për ata që kanë mundësinë qoftë edhe një herë të vetme në jetë. Kryerja e haxhit të dedikuar dhe kazaja e haxhit **nafile** është **vaxhip**. Haxhi kondiderohet nafile kur dikush e ka kryer atë nëpërmjet dikujt që akoma nuk i është bërë farz kryerja e haxhit.

Një Hadith

Transmetohet nga Ibn Omeri radijallahu anhu se

Resulullahu sallallahu alejhi ve sellem ka thënë:

“Feja Islame është ndërtuar mbi pesë baza: Dëshmia se s’ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij, falja e namazit, dhënia e zekatit, shkuarja në Qabe dhe agjërimi i ramazanit.”

(Buhari, Muslim)

Shpjegime

Qëllimi kryesor i adhurimit është zbatimi i urdhërave të Allahut si dhe lartësimi i fesë së Tij. Adhurimi i haxhit kryhet në bashkësi, pasi haxhi i cili bëhet përreth Qabes, si vendi i pare i fesë së Tevhidit, është treguesi më i lartë i unititetit të ymetit islam lidhur me besimin dhe praktikimin e fesë. Ndjesinë e haxhit mund ta kuptojnë vetëm ata që e kryejnë atë.

Përsa i përket aplikimit ka tre lloje haxhi:

Haxhi Ifrad: Hyhet në Ihram me qëllim vetëm për të bërë haxh. Kryhet “tavafi kudum” i cili nënkupton një lloj falënderimi të mbërritjes sonë në Qabe dhe rrotullimin shtatë herë përreth Qabes e realizojmë duke i bërë tre rrotullimet e para më të ngadalta. Ndërkohë shtatë herë bëhet lëvizja mes kodrave Safa dhe Merve e ashtëquajtur ndryshe edhe Sa’j, qëndrohet në Ihram, me të ardhur koha kalohet në Arafat, gjuhet me gurë shejtani, kryhet qethja, dhe tavafi i Qabes.

Haxhi Temettu: Gjatë muajit të haxhit, më parë, hyhet në Ihram në një nga vendet e quajtura Mikat me qëllimin e kryerjes së Umres. Bëhet tavafi, Sa’ji, kryhet rruarja dhe dilet nga Ihrami. Kur të vijë koha e duhur, hyhet përsëri në ihram, por këtë herë me qëllimin e kryerjes së haxhit. Ata që kryejnë këtë lloj Haxhi, duhet të presin kurban.

Haxhi kiran: Hyhet në Ihram në Mikat me qëllim edhe për umre edhe për haxh. Fillimisht bëhet Umre siç u shpjegua më lart duke pritur më pas në Ihram. Me të ardhur dita bëhet Haxhi. Ata që kryejnë këtë lloj Haxhi duhet të presin kurban.

Në haxh është e njohur thënia me zë të lartë e lutjes “Lebbejk Allahumme Lebbejk”

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Haxhi si një nga pesë kushtet e Islamit është një adhurim i quajtur Farz-i ajn për ata që i plotësojnë kushtet.
2. Kush mohon Haxhin bëhet qafir.

Nga lulishtja e zemrës

Osman Nuri Topbashi

HAXHI IDEAL

**Haxhi, si një nga shtyllat e Islamit
është një adhurim finansiar dhe tru-
por.**

Për ta kryer ashtu siç duhet këtë adhurim të shumëvlershëm, nevojitet një zemër e pjekur, një besim i plotësuar dhe një aftesi e madhe perceptuese.

Haxhi është një ibadet i shenjtë, i praktikuar që nga Ademi (a.s.), si i pari i vargut Profetik, e deri tek Muhamedi (a.s.), i fundit i këtij vargu. Të gjithë realizuan një mahsher të ngjashëm me atë të botës tjetër, duke provuar brenda vetes "vdekjen para vdekjes".

Ademi (a.s.) së bashku me Havanë (a.s.), njerëzit e parë prej ku buroi njerëzimi, shenjtëruan Qaben në Meke si Xhaminë e parë, për të përhapur fenë e për të jetuar në klimën e saj. Pasardhësit e tyre ndërruan vendndodhje si rezultat i ndryshimit të kushteve të jetës. Më vonë, me kalimin e kohërave dhe gjeneratave, njerëzimi ndryshoi. Ai u largua nga feja e vërtetë, prandaj edhe Qabja me humbjen e shenjtërimit të saj, u shkatë-

rrua. Më vonë Ibrahimi (a.s.) e rindërttoi dhe u lut për të. Në lidhje me këtë çështje, Allahu (xh.sh.) thotë në Kur'an:


(Kujtoje) kur Ibrahimi tha: O Zoti im! Bëje të sigurt këtë qytet dhe më ruaj mua dhe pasardhësit e mi nga adhurimi i idhujve!

O Zoti im, ata kanë shmangur shumë njerëz (nga rruga e drejtë). Ai që më pason mua, është i fesë sime; ndërsa për atë që më kundërshton mua, Ti, me të vërtetë, je Falës dhe Mëshirëplotë.

O Zoti ynë, unë kam vendosur disa nga pasardhësit e mi në një luginë që nuk mbillet, afér Shtëpisë Tënde të Shenjtë, që të falin namazin. Prandaj, bëj që zemrat e njerëzve të ndiejnë dashamirësi për ata dhe jepu fruta, me qëllim që ata të të falënderojnë. (Ibrahim, 35-37)

Adhurimi i haxhit ishte edhe para Islamit. Mirëpo mushrikët e kishin kthyer atë në një ceremoni zyrtare të shfaqjes së imoralitetit që bëhej për parinë e tyre. Përveç kurejshëve, të cilët e bënин haxhin të veshur në përputhje me rregullat e moralit, pjesa tjetër e arabëve e kryenin këtë peligrinazh të zhveshur e të përzier së bashku burra e gra. Mbulimi i pjesëve të turpshme të grupeve që vinin në Qabe varej nga bujaria e kurejshëve. Pra, nëse kurejshit do t'u jepnin rroba, ato do të mbuloheshin e nëse jo, do ta bënин tavafin lakuriq. Ndërsa me gjakun e kurbanit që pritnin, përljenin murat e Qabes, kurse mishin e digjin.

Më në fund, aty ku filloj të përhapej mesazhi hyjnor erdhi edhe pejgamberi i fundit i njerëzimit, Muhamedi (a.s.). Ai përsosi profetësinë dhe zhduku këto zakone të turpshme e bestytnitë, duke i kujtuar njerëzimit se qëlliimi i të gjitha adhurimeve ishte përmendja e Zotit dhe



pendimi ndaj Tij.

Pejgamberi (a.s.) jetoi dhe ndërtoi asr-i saadetin me vendër Meken dhe Medinen. Kështu që këto qytete u bënë qendrat e Islamit e të myslimanëve.

Vendet e haxhit janë begatuar me zemrat e mbushura me besim dhe me lotët e derdhur për Zotin të haxhinje, duke filluar që nga Ademi (a.s.) e deri në ditët e sotme. Ata që bëjnë haxhin me përkushtim shpirtëror i kushtojnë kujdes faktit të mësipërm; ata kërkojnë gjurmët shpirtërore të pejgamberëve aty dhe duke kujtuar këto, pajisen me një kënaqësi të thellë. Këto vende të shenja janë një burim i veçantë qetësie e kënaqësie, sepse janë të mbushur me kujtimet e vargut të pejgamberëve. Atje të bie ndërmend vazhdimisht mëshira, falja dhe begatia e Allahut (xh.sh.).

Me qëllimin e mirë për ta kryer haxhin ose umren, vizituesit e Qabes bëhen merituesit e kënaqësive shpirtërore, duke recitar duanë e Ibrahimit (a.s.):

O Zot! Na fal mëkatet tona! Ti je më i madhi mëshirues e mëshirëbërës. O Zot! Bëje ithtar e udhëtar të fesë sime fëmijën tim!

Kështu, zemrat e besimtarëve janë ndezur nga malli e dashuria për këto vende, dhe shpesh kanë thurur vargje dashurie:

U verbova, nuk shoh as afër e as larg,
duke të mbërritur, o e bukura Kabetullah.
O fllad i mëngjesit, të rëntë rruga Haramejnit,
Ma dërgo selamin tek Resuli i Thekalejnit.

Këto shfaqje të dashurisë u thelluan e u jetuan aq shumë, saqë u bë traditë që haxhiu të përcillet me porosinë e dërgimit të selameve ngado që shkon. Këto amanete të mbushura me dashuri, që i pëshpëriten haxhiut në

vesh, poeti, i përshkruan kështu:

Rrugëve ku kaloni
Buqeta selamesh dërgoni!
Njerëzve që përmendin Zotin
Dërgojini selam prej nesh!...

Kryerës së haxhit
si bora, të pastrit
Profetit Muhamed
Dërgojini selam prej nesh!...

Mekes dhe Medines
Dy thesareve të vetme
Profetit Muhamed
Na i jepni selam!...

Duke thënë lebbejk
Vraponi kah zemzemi
Fisit Beni Hashim
Na i jepni selam!...

Hyrësve në ihram
Të panjollosurve me haram
Sahabeve të ndershëm
Na i jepni selam!...

Përgjërues ndaj Zotit
Bani dua edhe për ne
Qabes së shenjtë
Përcilluani selamet tona!..

Hyrësve në kopshtin e dashurisë
që s'bien në helmin e pavetë-dishmërisë

Atij mali të nurtë
Përcilljuani selamet tona!...

Hyrësve në zemrën e hatimit
Bëjini sexhde Rrahimit
Makamit të Ibrahimit
Përcilljuani selamet tona!...

Shpëtimit që vjen nga Zoti
Të gjitha flatrave të hapura
Minasë dhe Arafatit
Jepini selam...

Parajsës së përhershme
Trëndafilishtes së bekuar
Trëndafilishtes së pastër
Jepini selam...

Shumë dijetarë të Islamit,
të djegur nga dëshira dhe
dashuria për këto vende të



shenja, nuk ndiheshin të qetë derisa të gjenin mundësinë të shkonin e t'i vizitonin, derisa të arrinin të kryenin faljen e namazeve, gjë që e bën me një kënaqësi të madhe shpirtërore. Madje, disave, që nuk kishin mundësitë e mjaftueshme ekonomike për ta bërë këtë udhëtim, u dhurohej një mundësi shpirtërore për ta realizuar haxhillëkun. Dihet rasti që u bë shkak për t'i hapur krahët qiejve të tasavvufit Aziz Mahmut Hydajit. Me të ndodhi kështu:

Në vitet kur Aziz Mahmut Hydaji ishte kadi i Bursës, i erdhë një çështje shumë e rrallë që duhej ta zgjidhte. Një grua, e cila kish ardhur të ankohej për të shoqin, i tha:

– Zotëri gjykatës! Bashkëshorti im planifikon çdo vit të shkojë në haxh, por nga varfëria nuk mund ta realizojë. Edhe këtë vit dëshiroi të shkonte dhe më tha: Në qoftë se nuk shkoj në haxh edhe këtë vit, do të të ndaj. Pastaj, në kohën kur po afrohej festa e Kurban-Bajramit, ai u fsheh diku e s'u duk fare. Pas pesë gjashtë ditësh erdhë e më tha se kishte qenë në haxh. Si mund të ndodhë një gjë e tillë? Zotëri gjykatës! Unë dua të ndahem nga kyneri gënjeshtar!...

Për ta studiuar edhe më mirë ankesën e gruas, gjykatës Mahmuti thirri bashkëshortin e saj dhe e pyeti nëse ankesa e bashkëshortes së tij ishte e vërtetë. Burri iu përgjigji:

– Zotëri gjykatës! Thëniet e gruas sime janë të vërteta, por edhe të miat janë të tillë. Dijeni mire se unë kam qenë në haxh. Atje kam takuar edhe disa haxhinj nga Bursa dhe i kam lënë porosi të më sjellin disa dhurata prej atje.

Gjykatësi Mahmut e pyeti i çuditur:

– Si mund të ndodhë diçka e tillë, zotëri?!



Burri u përgjigj:

– Si çdo vit tjetër, edhe sivjet u pushtova nga një mërzi e madhe prej pamundësisë së shkuarjes në haxh. Shkova tek Mehmed Dede. Ai më mori duart dhe më tha që t'i mbyllja sytë. Kur i hapa, e pashë veten në Qabe!...

I habitur nga një ngjarje e tillë, e cila ishte edhe e para e këtij lloji, Mahmut Efendiu nuk e besoi.

Burri, i cili ishte akoma nën ndikimin e haxhit, iu përgjigj shumë thjesht, por saktë këtij qëndrimi mosbesues:

– Zotëri gjykatës! Armiku i Zotit, shejtani, mund të shëtisë gjithë botën për një moment. E si s'mundet të shkojë në Qabe një mik i Zotit?!

Gjykatësi pa se përgjigja e dhënë kishte logjikë, prandaj e shtyu për më vonë vendimin në lidhje me këtë çështje. Kur u kthyte karvani i haxhinjve, Mahmut Efendiu e studioi çështjen edhe një herë dhe arriti në përfundimin e vërtetësisë së fjalëve të burrit. Çështja u mbyll, por në zemrën e tij u ndez një zjarr i madh misteri. Me ndihmën e Mehmet Dedesë, ai hyri në grupin e nxënësve të mësuesit Yftade, prej ku doli si një nga dijetarët më të mëdhenj shpirtërorë.

Malli dhe nevoja për të parë vendet e shenja nuk lidhet shumë me dheun e shkretëtirës. Qëllimi i shkuarjes atje lidhet me dëshirën për të parë vendin e Ibrahimit (a.s.), atdheun e Ismailit dhe të bijve të tij, për të parë vendlindjen e Muhamedit (a.s.), vendin prej nga ku u përhap Islami, si dhe për të mbushur mushkëritë dhe shpirrat tanë me ajrin që thithi Profeti i fundit i njerëzimit. Sikurse thotë edhe poeti i madh:

Kudo ku hedh sytë, vetëm mrekulli, përkrah zemrës ajo më thotë: Vendi i vërtetë është pikërisht ky.

**"Zoti ynë, na bëj besimtarë
të sinqertë ndaj Teje dhe nga
pasardhësit tanë njerëz të
bindur ndaj Teje.
Na i mëso rregullat e ibadetit
(adhurimit) dhe na fal. Vërtet Ti
fal shumë, je mëshirues!"**

(el-Bakara, 128)

Këto shprehje nuk janë vetëm një frysëzim poetik, por në të njëjtën kohë edhe një e vërtetë kuranore. Allahu (xh.sh.) thotë:

"Aty ka shenja të qarta..." (Ali Imran, 97)

Prandaj, kur njerëzit i shohin me sytë e zemrës ato vende të shenjta, tek ata zgjohen vlerat e besimit dhe dashuria hyjnore rrok çdo kriesë. Ngado që ato hedhin shikimin, preken nga frysëzime dehëse dhe nga sytë u rrjedhin lotë e gjuhët u lëvizin vetëm për të përmendor Zotin (xh.sh.). Në ato vende të shenjta, e gjithë koha kalohet me një moral të lartë. Për këtë Allahu (xh.sh.) thotë në Kuran:

"...kush madhëron shenjat e fesë së Allahut, tregon përkushtimin e zemrës së tij." (el-Haxhxh, 32)

Parë nga ky aspekt, haxhi nuk është vetëm një adhurim material. Ai është më shumë adhurim shpirtëror. Ajo që Muhamedi (a.s.) kishte për qëllim me "haxhxhu'l-mebrur", ishte pikërisht haxhi i pajisur me këto vlera shpirtërore. Pra, haxhi është mëshirimi i shpirtrave nga Zoti (xh.sh.); furnizimi me virtute të larta nëpërmjet lutjeve, tevbeve dhe pendimeve; mpleksja e jetës me vepra të mira; fjalë që i jepen Zotit për vazhdimësinë tonë në këtë rrugë edhe pas haxhit.

Sa bukur tingëllon duaja e Ibrahimit (a.s.):

"Zoti ynë, na bëj besimtarë të sinqertë ndaj Teje dhe nga pasardhësit tanë njerëz të bindur ndaj Teje. Na i mëso rregullat e ibadetit (adhurimit) dhe na fal. Vërtet Ti fal shumë, je mëshirues!" (el-Bakara, 128)

Kështu haxhinjtë brumosen me këtë dua duke kujtuar se Pejgamberi (a.s.) ka jetuar e shëtitur aty përreth. Aty janë gjurmët e tij, përpjekjet e pafundme që ai bëri për të përhapur Islamin... e... sa e sa ndodhira të tjera. Kuj-

tojnë kohën kur Muhamedi (a.s.) ligjëroi para mushrikëve në kodrën Safa. Ato kujtojnë pejgamberin që duke i treguar mekasve malin Ebu Kubejs, tha:

– Në qoftë se unë ju them se prapa këtij mali ndodhet një armik që është drejtuar për t'ju vrarë dhe duhet të organizoheni për të mbrojtur vetveten, a do të më besonit?

Ato iu përgjigjën:

– Do të të besonim, edhe nëse nuk do të mund të shihnim pas malit. Ti je "Muhammedu'l-Emin", ne nuk dyshojmë aspak tek ti.

Pas kësaj Muhamedi (a.s.) tha:

– Nëse nuk dyshoni aspak tek unë, atëherë besoni se Krijuesi i gjithësise është një! Idhujt që adhuroni janë vetëm gurë. Largojuni atyre dhe adhuroni Allahun si një të vetëm. Dijeni se Allahu (xh.sh.) më dërgoi mua si pejgamber tek ju.

Mushrikët, me në krye Ebu Lehebin, thanë:

– Për këtë na thirre, o Muhammed?

Pastaj u larguan duke i përgjënjeshtruar fjalët e Muhamedit (a.s.), edhe pse ndërgjegjja e tyre i pranonte ato.

Por Zotëria i botërave nuk u thye para këtyre devijimeve e kundërshtimeve të kota, por u shërbeu atyre njerëzve me shpirt të tharë, si një burim uji jetësor.

Duke menduar të tilla ngjarje me shpirt të gatshëm për të marrë diçka para Daru'l-Erkamit, i cili shërbeu si mësues, ne mund të përjetojmë reflektimet e edukimeve kuranore, mund të zgjatemi deri tek hixhreti, e madje edhe pas periudhës së tij, kur Zoti zbriti mirësinë e begatinë e Tij.

Edhe ne mund të përjetojmë marrëdhënien e Profetit me Ebu Bekrin në shpellën Thevr, zhytjen e tyre në misteret hyjnore e në edukimet shpirtërore për tre ditë me radhë. Në atë bashkëbisedim të fillesës së raportit dashuroristik, mund të shijojmë në mënyrë të plotë besimin.

Duke ndjerë kaq thellë besimin, mund t'u drejtohem i sahabave për t'i marrë si shembull, pasi secili prej tyre është si një yll i shndritshëm; mund të kujtojmë periudhën e Medines e më pas kthimin në Meke dhe çirimin e saj nga Profeti (a.s.).

Duke parë malet përreth, mund të kujtojmë si në ëndërr ushtrinë e sahabave të Profetit Muhamed (a.s.), të cilët për t'i frikësuar mushrikët, kishin mblehdhur materiale që ndizeshin e me to kishin bërë pishtare. Mund të dëgjojmë ezanin eëmbël që Bilali këndoi në Qabe. Rrezimin që Profeti (a.s.) u bëri idhujve duke thënë ajetin:

“...E vërteta erdhi, ndërsa e pa-vërteta u shkatërrua ...” (el-Isra, 81)

Duhet të dimë edhe se zemra jonë është si një Qabe. Edhe aty mund të ketë disa idhuj të egos sonë dhe haxhi shërben për t'i thyer ato e për ta shndërruar atë në një vend hyjnor.

Pra, haxhi është një ibadet i shumëplanshëm që shërben për pastrimin shpirtëror, kthjellimin dhe ngalljen e njeriut.

Haxhi është një përpjekje për të hedhur një hap drejt botës shpirtërore, duke u zhveshur nga bota materiale. Tek haxhi, shpirti gjen harmoninë, klimën, ngjyrën, vetveten. Gjatë këtij ibadeti ai lahet me shiu e kënaqësive të shfaqjeve shpirtërore.

ARAFATI

Arafati, një vend përfalje

“Thuaj: Në të vërtetë, namazi im, kurbani im,jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve.”

(el-En'am, 162-163)

dhe strehim.

Arafati, të kujton ngritjen nga varri në mëngjesin e kijamitetit dhe grumbullimin grupe-grupe në sheshin e gjykimit. Të gjithë robërit e pafuqishëm: nevojtarë dhe optimistë presin falje. Shpirrat dhe sytë lagen nga lotët e pendimit dhe një det fjalësh të sinqerta i kushtohen Drejtësisë. Hapen faqe të pastra për njerëzit, të cilët i japidn fjalën Zotit se do të jetojnë me bindje të plotë në pjesën tjetër të jetës së tyre.

Kështu, Arafati paraqet një tabllo gjykimi. Një pjesë e gjendjes së ditës së kijamitetit jetohet edhe aty. Me të vërtetë që ai vend gati-gati të kujton ngritjen e njerëzve nga varri, ardhjen e tyre në vendin e mahsherit, sheshit të grumbullimit, ku secili është në hallin dhe telashin e vet, me pendimet e gjynaheve dhe lutjen e përzemërt që i bën Zotit, i futur në një parrugëzgjidhje: secili me kokë të zbuluar... i mbështjellë me një peshqir poshtë dhe lart... këmbëzbathur... i zhveshur nga të gjitha gradat e kësaj bote...

Nga ana tjetër, Arafati na çon në kujtimet e shkuara. Është e njohur edhe historia e Hz. Ademit dhe e Hava-së, të cilët hëngrën nga pema e ndaluar dhe si rrjedhojë u dënuan nga përcaktimi hyjnor për të dalë nga xheneti dhe për t'u vendosur larg, në vende të ndryshme, me qëllim që të ndjenin mall për njëri – tjetrin.

Më në fund Ademi (a.s.) kërkoi falje nga Zoti i Madhëruar duke menduar personalitetin dhe nderin që kishte Muhamedi (a.s.) nga ana e Allahut. Më pas Allahu Te'ala e pranoi kërkësën e tij dhe caktoi një engjëll për t'i treguar rrugën drejt Mekës. Nga begatia e kësaj lutjeje edhe Havaja që jetonte në Xhidde u përcoll përf tek Ademi (a.s.) nën shoqërinë e një ëngjelli tjetër dhe këto në një ditë arefe, në kohën e iqindisë, u takuan në luginën



e Arafatit, ku qanë së bashku dhe bënë tevbe.

Allahu i Lartë, i cili jep dhundi dhe dhuron mirësi të pafundme, jo vetëm që i pranoi lutjet e tyre, por edhe u premtoi falje deri në ditën e kijametit të gjithë atyre që vinin nga ajo gjeneratë e që do të kërkonin të faleshin, duke ardhur çdo vit, në të njëjtën orë dhe në të njëjtën ditë. Ja pra, kjo është edhe arsyaja që haxhinjtë, në ditën e arefesë ngjiten në Arafat dhe kërkojnë falje.

Pas këtij takimi, Ademi (a.s.) së bashku me Havanë, me urdhër të Zotit, qëndruan në vendin ku sot ndodhet qyteti i Mekës. Kjo është edhe arsyaja që një tjetër emër i qytetit të Mekës është edhe "Ummu'l-Kura" që do të thotë nëna e zonave të qendrave të banimit.

Kjo ndodh pasi Meka është vendpasqyrimi i një të vërtete ku hiqen nocionet relative dhe të përkohshme të atdheut, ngjyrës, pasurisë, varfërisë, veshjes dhe ku të gjithë njerëzit ndihen si një popull i vetëm në vëllazërimin Islam. Aty, drejtuesi e punëtori, i pasuri e i varfri, injoranti e dijetari, që të gjithë janë së bashku, me të njëjtat veshje, në të njëtin shesh dhe në të njëtin rresht. Aty është vendi për t'iu mbështetur Zoti duke u zhveshur nga dallimet klasore të përkohshme dhe duke hyrë në hapësirën e qefinit. Aty është vendi i rrënqethjes së trupit nga pamjet e tmerrshme të kijametit.

Ky qytet i madhërueshëm është prehëri i sigurisë, i qetësisë dhe dashurisë; është këndi i pejgamberëve që mbushin zemrat me begati dhe mëshirë. Me gjithë vuajtjet e botës Islame në ditët e sotme, pasqyrimi i vëllazërimit, bashkimit dhe dashurisë, i formuar në këto vende të madhërueshme në kohën e haxhit dhe të umres vazhdon t'i zbukurojë. Këto vende jetojnë përherë me dëshirën e zjarrtë për të arritur një gjë të tillë me organizatat ndërkombëtare që kanë kriuar dhe në këtë

drejtim akoma nuk kanë arritur një mirëkuptim. Kjo, pasi përkundrejt qetësive materiale që i tejkalojnë edhe ngopjet e tyre, nuk mungojnë edhe erërat e ndarjeve të pafundme, të urrejtjeve, të dhunës, të padrejtësive dhe armiqësive që fryjnë brenda e jashtë tyre, për shkak të shkatërrimit shpirtëror që përjetojnë.

MUZDELIFE DHE KURBANI

Muzdelife, stacioni që vjen pas Arafatit, është vendi ku shihet qartë mëshira, është vendi i përgatitjes së zemrave me pranimin e fuqisë së Allahut dhe nënshtrimin ndaj madhështisë së Tij, është vendi i drejtit të vetëm nga Allahu, është vendi i dashurisë dhe përuljes së madhe, duke hedhur prapa botën dhe ahiretin.

Kurbani i prerë, në emër të flijimit shpirtëror të Ibrahimit (a.s.) pas plotësimit të ditëve të caktuara, është një fladë mirësie dhe mëshire që sjell në botën shpirtërore të haxhinjve ndjenjat dhe emocionet e Pejgamberit tonë të madh. Nga gjuhët e atyre që e përjetojnë një gjë të tillë derdhen këto fjalë hyjnore që pasqyrohen në Kur'an:

"Unë e kthej fytyrën time nga Ai që i ka kriuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë, nuk jam nga idhujtarët!"
(el-En'am, 79)

"Thuaj: Në të vërtetë, namazi im, kurbani im,jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve."
(el-En'am, 162-163)

Hazreti Ibrahimi, duke shkuar nga Babilonia për në Egjipt, pati thënë:

"Unë po shkoj te Zoti im. Ai do të më udhëzojë; O Zoti im, dhuromë një fëmijë të mirë!"
(es-Saffat, 99-100)

Këtu tregohet për realizimin e një udhëtimi shpirtëror me zemër, për realizimin e udhëtimit përmes botës së brendshme, drejt

Krijuesit të Madh.

Në vazhdim të ajeteve kuranore shpjegohet ngjarja e dhënies së lajmit të mirë të Hz. Ismailit dhe kurbani:

"Dhe Ne i dhamë lajmin e gjëzuar për një djalë të mbarë!" (es-Saffat, 101)

"Kur fëmija u rrit aq sa ta ndihmonte në punë, Ibrahimi i tha: O djali im, kam parë në ëndërr se duhet të të flijoj. Çfarë mendon ti? – I biri i tha: O ati im, vepro ashtu siç je urdhëruar! Dashtë Allahu, unë do të jem i durueshëm!" (es-Saffat, 102)

"Pasi iu nënshtuan që të dy urdhrit, (Ibrahimi) e vuri (Ismailin) me ballë përtokë. Ne e thirrëm: O Ibrahim, ti vërtet e përmbushe ëndrrën, ne kështu i shpërblejmë punëmirët! Kjo, me të vërtetë ka qenë një sprovë e qartë!" (es-Saffat, 103-106)

"Dhe Ne e zëvendësuam atë (Ismailin) me një kurban të madh, dhe i lamë atij (Ibrahimit) kujtim të mirë në brezat e mëvonshëm. Paqja qoftë mbi Ibrahimin." (es-Saffat, 107-111)

Pasi pati lënë në Meke Haxheren me Ismailin (a.s.), Hz. Ibrahimi qe kthyer pranë Sarës. Herë pas here shkonte edhe pranë tyre. Njëherë, kur ishte në Mekë, pa një ëndërr. Ash tu siç tregohet edhe në ajet, ai pa në ëndërr se po bënte kurban Ismailin (a.s.). Ibrahimi (a.s.) mendoi rrëth ëndrrës. A thua ishte mashtrim nga shejtani, apo urdhër nga Zoti? Mirëpo, e njëjta ëndërr vazhdoi për tre ditë. Këto ditë ishin tevrije, arefe dhe dita e parë e Bajramit në stinën e haxhit.

Në një transmetim rrëföhët se Ibrahimi (a.s.) ka thënë:

– Nëse Allahu më jep një djalë, do ta bëj kurban! Ja pra, për këtë fjalë, ai është



vënë në provë.

Pas urdhrit hyjnor që i erdhi nga Zoti, Ibrahimi (a.s.) i tha Haxheres që ta lante djalin, Ismailin dhe ta lyente me erëra të mira, se do ta conte tek një mik i tij i ngush-të. Ndërsa Hz. Ismailit, pasi e porositi të merrte me vete një pe dhe një thikë, i tha:

– Biri im, ty do të të bëj kurban për hir të Zotit!

Filluan të ecnin drejt vendit ku haxhinjtë qëndrojnë në vakfe në Arafat. Në këtë kohë shejtani u shfaq me para-qitjen e një njeriu, erdhi pranë Haxheres dhe e pyeti:

– A e di se ku po ta çon Ibrahimi djalin tënd?

Ajo iu përgjigji:

– Po e çon tek miku i tij i ngushtë.

Ndërsa shejtani i tha:

– Jo, po e çon ta presë.

Haxherja ia ktheu:

– Ai e do shumë djalin e vet!

Kur shejtani tha në vazhdim:

– Do ta presë, sepse e paska urdhëruar Allahu!

– Haxherja i tha:

– Nëse Allahu e ka urdhëruar, është një gjë e bukur. I lëmë në dorë Atij.

Duke mos arritur ta mashtronte Haxheren, shejtani iu qas Ismailit (a.s.) dhe e pyeti:

– A e di ti se ku po të çon babai yt?

Ismaili (a.s.) i tha:

– Të përmbushë urdhrin e Zotit.

Shejtani u përpoq ta bënte merak duke i thënë:

– Ti e di që ai po të çon të bëjë kurban.



**“Dhe Ne e zëvendësuam atë
(Ismailin) me një kurban të
madh, dhe i lamë atij (Ibrahimit)
kujtim të mirë në brezat e
mëvonshëm. Paqja qoftë mbi
Ibrahimin.”**

(es-Saffat, 107-111)

Më pas Ismaili (a.s.) e largoi shejtanin duke i thënë:

– Shporru që këtej, i paudhë! Ne e çojmë në vend me shumë dëshirë urdhritin e Zotit. Pastaj e gjuajti atë me gurë.

Kur Shejtani nuk arriti ta mashtronte as Ismailin (a.s.), iu drejtua Ibrahimit (a.s.) duke i thënë:

– O i moshuar! Ku po e çon birin tënd? Shejtani të paska mashtruar në ëndrrën tënde! Ato janë ëndrrat e shejtanit.

Ibrahim (a.s.) i tha:

– Ti je shejtani! Largoju menjéherë prej nesh.

Dhe mori në duar shtatë gurë dhe filloj ta gjuante shejtanin në tre vende të ndryshme.

Ja pra, këtu zë fill gjuajtja e shejtanit me gurë, një rit fetar simbolik që vazhdon të bëhet në haxh, rit që do të vazhdojë të bëhet deri në kijamet. Kjo situatë u bë shembull për umeti Muhamedin, i Cili i kujtoi gjithmonë me përvlje.

Kur Ibrahim (a.s.) kaloi bashkë me Ismailin (a.s.) nga Mina për në Arafat, engjëjt në qzell ishin mjafit të emocionuar. Ata i thanë njëri – tjetrit me habi:

– Subhanallah! Një pejgamber po çon të bëjë kurban një pejgamber.

Ibrahim (a.s.) i tregoi të birit Ismailit (a.s.) të vërtetë. Ai i tha kështu:

– O biri im, unë jam urdhëruar në ëndrrën time të të bëj kurban.

Ismaili (a.s.) pyeti:

– Baba, Allahu ta urdhëroi ty këtë?

Ibrahim (a.s.) tha:

– Po!

Pas kësaj Ismaili (a.s.) i tha:

– I dashuri atë! Meqenëse është kështu, ti bëj atë për të cilën je urdhëruar! Nëse dëshiron Zoti, mua do të më kesh të durueshëm.

Ai tregoi se ishte gati të jepte shpirtin. Në atë kohë Ismaili (a.s.) mund të ishte vetëm shtatë vjeç ose më së shumti trembëdhjetë.


Sipas transmetimit, një nga tre vendet ku Xhebraili (a.s.) u emocionua dhe pati vështirësi në realizim, ishte momenti kur Ibrahim (a.s.) i vuri thikën në fyt Ismailit (a.s.) për ta bërë kurban. Si rezultat i përuljeve të tyre ndaj Drejtësisë së Lartë, Ai i njoftoi se do të bënte kurban një dash të sjellë nga parajsa si dhundi hyjnore. Mes thirrjeve të tekbirëve shpirtërorë, ai dash u bë kurban.

Qëllimi kryesor i prerjes së kurbanit është të kujtuarit e këtyre ngjarjeve, marrja mësim nga mirësitë e tyre hyjnore dhe forcimi i shpirtrave me robërinë ndaj Allahut, me përuljen dhe devotshmërinë ndaj Tij. Ai thotë:

“Tek Allahu nuk arrin as mish, as gjaku i tyre, por arrin përkushtimijuaj...” (el-Haxhxh, 37)

Nga ana tjetër, pas prerjes së kurbanit në haxh, një efekt të veçantë ka edhe prerja e flokëve. Përpara Islamit, kur di-kush e linte robin e tij të lirë, ia rruante flokët me brisk dhe kjo ishte shenja dalluese e robërisë. Edhe haxhinjtë me rruajtjen në haxh, pranojnë dhe pohojnë robërinë e tyre ndaj Krijuesit të Lartë. Pra, kjo rruajtje, në një farë kuptimi, është shprehje e një lidhjeje që pasqyron përkushtimin tonë ndaj Allahut dhe të qenurin tonë një rob që i është dorëzuar Atij.





Mr. sci. Flamur Sofiu

Haxhi nën prizmin e jurisprudencës Islamë

F Në kuptimin leksikor, fjala haxh do të thotë synim, qëllim, mësymje, ndërsa në kuptimin terminologjik të shariatit nënkupton synimin për të vizituar Qaben në kohë të caktuar dhe në mënyra të caktuara.

Haxhi është *farzi ajn* dhe një prej pesë shtyllave të islamit (detyrim individual) i argumentuar në Kur'an dhe në sunetin e Pejgamberit (s.a.v.s.).

Haxhi është *farz ajn* një herë në jetë për çdo mysliman mashkull apo femër, që është i aftë për t'u ngarkuar me obligime fetare (*mukel-lef*), që është normal në rrafshin psiqik, që ka hyrë në moshën madhore dhe që ka mundësi materiale për ta kryer një vizitë të tillë.

Myslimani i hyrë në moshën madhore dhe që është i aftë psiqikisht, nëse zoteron pasuri të mjaftueshme gjatë muajve të haxhit për mirëmbajtjen e familjes dhe për të kryer vizitën e tij, e ka farz kryerjen e haxhit, pavarësisht faktit a

ka shkuar atë vit në haxh apo jo. Nëse ndodh që të fitojë aq pasuri pas kalimit të muajve të haxhit sa që mund ta mirëmbajë familjen e të shkojë në haxh, atëherë atij nuk i bëhet obligim haxhi, ngase ka kaluar koha e haxhit. Po qe se të varfërit i mundëson dikush që të shkojë në haxh, ai ka të drejtë të zgjedhë nëse do shkojë në haxh; nëse s'dëshiron nuk shkon, sepse edhe në këtë rast ai nuk është i obliguar për një detyrë të tillë. Nuk lejohet t'i jepet zekati të varfërit që të shkojë në haxh, sepse ai nuk e ka këtë obligim.

KUR OBLIGOGET KRYERJA E HAXHIT

Kur myslimani plotëson kushtet e duhura për haxh, ai duhet ta kryejë haxhin menjëherë, në po atë vit, por sigurisht nëse plotëson kushtet e mëposhtme:

1. Të mos jetë i sëmurë.
2. Të mos ketë probleme që pengojnë udhëtimin e tij.
3. Të mos jetë i kërcënuar me dënim, me burgosje e me

gjëra të ngjashme nga ndonjë prijës tiran apo nga armiku.

4. T'i ketë të siguruara rrugën dhe mjetet që i mundësojnë të udhëtojë.

5. Të mos jetë i zënë me shërbimin ndaj prindërve, të cilët mund të janë në pleqëri të thellë ose aq të sëmurë sa nuk janë në gjendje të kujdesen për veten e tyre.

6. Femra duhet të shoqërohet në haxh nga bashkëshorti apo nga ndonjë person me të cilin nuk i lejohet të martohet (mahrem) si: vëllai, xhaxhai, babai etj.

7. Femra gjatë kohës së haxhit duhet të mos jetë në *i'det* (kohë e pritjes) për shkak të vdekjes së burrit, për shkak të shkurorëzimit të përhershëm (*bain*) ose jo të përhershëm (*rekh'ij*).

Në qoftë se plotësohen të gjitha këto kushte, haxhi duhet të kryhet po atë vit e të mos lihet për më vonë. Nëse haxhi lihet për më vonë, atëherë personi ka bërë mëkat për shkak të vonesës. Të këtij mendimi janë hanefitët.

FARZET E HAXHIT

Ruknet e haxhit janë:

1. Qëndrimi në Arefat. Të qëndruarit në Arefat është një prej kushteve kryesore të haxhit. Nëse nuk bëhet qëndrimi në Arefat, atëherë haxhi nuk konsiderohet i kryer. Për këtë kemi si argument fjalën e Pejgamberit (s.a.v.s.): "Haxhi është qëndrimi në Arefat".¹

Koha e qëndrimit në Arefat fillon prej namazit të drekës së natës së kurban bajramit dhe vazhdon deri në sabbun e ditës së kurban bajramit. Nëse qëndrohet në Arefat gjatë një kohe më të shkurtër se koha që përcaktuam më sipër, *farzi* quhet i kryer. Nuk është kusht që në Arefat të qëndrohet domosdoshmërisht i pastër me abdes nga xhenabeti, por pastrimi dhe marrja abdes është sunet i fortë (*sunnet muekkede*). Një *farz* i tillë lejohet dhe konsiderohet i kryer po që se femra është me *hajz* (menstruacione) dhe *nifas* (periudha pas lindjes) gjatë kohës që është duke qëndruar në Arefat.

Sunet gjatë qëndrimit në Arefat është:

- a. Qëndrimi gjatë gjithë kohës me abdest,
- b. Kthimi nga *kibla* brenda mundësive,
- c. Qëndrimi afér kodrës "*xhebelu rrahme*",
- ç. Bërrja e istigfarit dhe e duasë sa më shumë. Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë: "Lutja (duaja) më e mirë është ajo që bëhet në ditën e Arefatit".

2. Tavafuz-zijareh apo tavaful-ifadah. Ky tavaf duhet të bëhet pas hedhjes së gurëve, në ditën e parë ose të dytë

a të tretën e kurban bajramit.

VAXHIBET E HAXHIT

1. Ihrami. Ihrami përbëhet prej dy pjesësh: pjesa e sipërme (err-rrida) dhe pjesa e poshtme (el-izari). Me veshjen e ihmrit nënkuptohet se haxhiu ka bërë njët dëshirë se do ta kryejë haxhin apo umren. Sa i përket njëtit për veshjen e ihmrit, ai vlen të bëhet vetëm me zemër.

Sunet gjatë kohës kur jemi në *ihram* është:

- a. Të pastrohemë,
- b. *Ihramat* të janë të rinj, e nëse nuk janë të rinj, lë të janë së paku të larë,
- c. Të perfumosim trupin para se të veshim ihmamat, por ihmamat nuk lejohet t'i perfumosim,
- ç. Të falim dy rekat namaz,
- d. Të këndojmë *telbijen*.

Ndalesat pas veshjes së *ihramit* janë:

- a. Prerja e thonjve,
- b. Prerja dhe rruarja e flokëve dhe mustaqeve,
- c. Përdorimi i perfumeve,
- ç. Heqja e qimeve nga vendet e turpshme, nën sqetulla, si dhe shkulja e qimeve nga trupi,
- d. Përdorimi i materieve që mbajmë për zbukurimin e flokëve etj.
- e. Gjuetia e kafshëve të tokës, ndërsa gjuetia e kafshëve të detit lejohet,
- ë. Mbulimi i kokës. Përdorimi i ombrellës e të ngjashme që nuk puqen me kokën lejohen të përdoren.
- f. Marrëdhëniet seksuale,
- g. Zënkat dhe debatet,
- h. Të mbuluarit e kokës,
- k. Veshja e rrobave të qepura; grave u ndalohet veshja e dorezave dhe veshja e nikabit (pelerinës që e mbulon fytyrën).
- n. Të thyerit e pemëve në harem të Mekes.

Çka lejohet për haxhiun kur është në *ihram*:

- a. të mbajë unazë,
- b. të mbajë orë,
- c. të mbajë armë,
- ç. të mbajë kuletën e parave,
- d. të lidhë me fashë plagë.

2. Sa'ji-vrapimi në mes kodrave Saffa dhe Merva. Vrapimi duhet të fillojë prej kodrës Saffa dhe kështu duhet të bëhen shtatë sjellje; domethënë një shkuarje prej Saffas deri në Merva konsiderohet një sjellje. Për njeriun që është

1. Buhariu.



të i aftë pér tē ecur, sa'ji duhet tē bëhet nē këmbë, ndërsa i sëmuri apo njeriu që nuk mund tē ecë lejohet tē bartet me mjete. Sa'ji duhet tē kryhet patjetër pas tavafit, pérndryshe nëse ndodh ai që tē kryhet para tavafit, nuk konsiderohet i vlefshëm.

3. Qëndrimi në Muzdelife. Muzdelifa është vend nē mes Arefatit dhe Mines. Të gjithë dijetarët bien dakord nē mënyrë tē njëzëshme se tē qëndruarit në Muzdelife qoftë edhe pér një kohë shumë tē shkurtër është vaxhib. I sëmuri, i dobëti fizikisht, gruaja, nëse kanë frikë se nuk do tē mund t'i bëjnë ballë qëndrimit në Muzdelife pér shkak të grumbullit tē madh tē njerëzve, lejohet tē mos qëndrojnë nē tē. Sipas hanefitëve koha e qëndrimit në Muzdelife është para agimit e deri nē lindje tē diellit. Kush arrin nē Muzdelife para se tē lindë dielli së paku kalimthi, e ka tē kryer këtë *vaxhib*. Është obligim që nē Muzdelife t'i falim bashkë namazin e akshamit dhe atë tē jacisë. Preferohet që, nëse është e mundur, tē shkojmë nē Mine para se tē lindë dielli, me qëllim që tē falim namazin e sabahut menjëherë apo tē hyjë koha; ndërkohë, gjatë qëndrimit le tē bëjmë sa më shumë lutje e dua.

4. Hedhja e gurëve. Hedhja e gurëve nē xhemerat bëhet sipas kësaj renditje: së pari nē ditën e parë tē kurban bajramit gjuhen nē *xhemretul akabe* (guri i madh), kurse nē dy ditët tjera hidhen nē tē, tre gurët. Nuk lejohet tē gjuhet ndonjë send tjetër përvëç gurëve si fjala vjen me dru, me këpucë apo me sende tē tjera. Në xhemrën e parë duhet tē gjuhen shtatë gurë një nga një; nëse gjuhen tē gjithë menjëherë, atëherë mbetet që tē gjuhën edhe gjashtë tē tjerë. Koha e gjuajtjes nē xhemretul akabe është prej sabahut tē

ditës së bajramit deri nē sabahun e ditës së dytë. Ndërsa nē ditën e dytë dhe tē tretë gjuhen nē tē tri *xhemerat* nga shtatë gurë, duke filluar nga *xhemretu-s-ugra* nē *xhemretul-vusta* dhe nē fund nē *xhemretul-akabe*. Në çdo gjuajtje tē gurit duhet tē thuhet: "**Allahu ekber**". Kur është fjala pér tē sëmurët apo fëmijët që nuk kanë mundësi tē gjuajnë vetë, nē vend tē tyre mund t'i gjuajë gurët ndokush që është i aftë pér ta bërë një gjë tē tillë.

5. Rruarja apo prerja e flokëve. Rruarja apo shkurtimi i flokëve është një prej vaxhibeve tē haxhit. Rruarja e flokëve është më ë lavdërueshme se shkurtimi i tyre. Kjo vlen vetëm pér meshkujt. Sa u përket grave, është e preferueshme që ato t'i presin flokët, ndërsa rruarja e flokëve nuk u lejohet sepse është mekruh. Sipas hanefitëve, njeriu që është pa flokë duhet ta rruajë kokën me brisk rroje, pavarësisht se nuk ka flokë fare. Koha e rruarjes apo e shkurtimit tē flokëve fillon pas hedhjes së gurëve nē xhemretul akabe dhe zgjat deri nē ditën e tretë tē kurban bajramit.

6. Tavaful vedë (tavafi i lamtumirës). Ky lloj i tavafit është vaxhib pér çdo haxhi që nuk është mekas, përsa u takon mekasve ky lloj tavafi nuk duhet tē kryhet, sepse ata janë vendas dhe pér ta nuk mund tē ketë tavaf tē lamtumirës. Sipas hanefitëve, koha e kryerjes së këtij tavafi fillon menjëherë pas kryerjes së tavful-ifades dhe zgjat deri para se haxhiu tē nisë udhëtimin e tij tē largimit nga Meke. Nëse ndodh që femrës i paraqiten menstruacionet para kryerjes së këtij lloj tavafi, dhe nëse është e detyruar tē udhëtojë brenda asaj kohe, atëherë femra lirohet nga ky lloj obligimi pér arsyë tē justifikueshme. Kur ndodh që dikush tē largohet Meke pa e bërë këtë lloj tavafi, ai duhet tē kthehet që ta kryejë këtë tavaf nëse ka mundësi. Pérndryshe, nëse nuk mund tē kthehet duhet tē bëjë kurban një dele pér kompensim.

SUNETET E HAXHIT

Nëse kryhen, sunetet e haxhit kanë shpërbirim, por nëse lihen pa u kryer nuk ka kompensim. Të tilla sunete janë:

1. Tavaful Kudumi- Këtë tavaf haxhiu e kryen me tē arritur nē Meke. Koha e kryerjes së këtij tavafi fillon që prej çastit kur hyhet nē Meke dhe zgjat deri para se tē qëndrohet nē Arefat, por është e rekomanduar që tē kryhet menjëherë pasi tē hyhet nē Meke. Pér mekasit ky tavaf nuk duhet tē kryhet. Po ashtu, ky tavaf nuk kërkohet tē zbatohet as nga haxhiu që kryen llojin e haxhit "temet'u".

2. Pastrimi apo marrja e abdesit para veshjes së ihamrit.

3. Qëndrimi dhe fjetja nē Mine nē natën e Arefatit.

4. Qëndrimi dhe fjetja nē Mine gjatë ditëve tē gjuaj-

tjes së gurëve.

5. **Të bujturit në Muzdelife.**
6. **Falja e dy rekateve pas veshjes së ihramave.**
7. **Ecja e shpejt në tri sjelljet e para të tavaful kudumi.**
8. **Zbulimi i krahut të djathtë në tri sjelljet e para të tavaful kudumit.**
9. **Nisja nga Mina për në Arefat në ditën e nëntë të dhyl-hixxes, pas lindjes së diellit.**
10. **Vrapimi në sa'j në mes shenjave.**
11. **Thënia shpesh e telbijes.**
12. **Ihrami të jetë prej dy pjesëve të bardha.**
13. **Pastrimi para hyrjes në Mekke.**

LLOJET E HAXHIT

Haxhi ndahet në këto lloje:

1. Haxhi Kiran - Me këtë lloj haxhi nënkuftohet se haxhiu në mikat do ta bëjë njet për t'i kryer së bashku Umren dhe Haxhin. Kur të arrijë në Meke, haxhiu duhet ta përfundojë Umren dhe të qëndrojë në ihrama deri sa të përfundojë haxhi. Për këtë lloj vizite haxhiu detyrohet të presë kurban. Nijeti për këtë lloj haxhi bëhet në këtë mënyrë:

"O Zoti im, unë vendosa të bëj haxhin dhe umren, prandaj më lehtëso kryerjen e tyre dhe pranoje këtë nga unë."

2. Haxhi Temet'tu - Ky lloj haxhi bëhet kur haxhiu, pasi i fal dy rekat në mikat bën njet për të kryer umren. Pasi të arrijë në Meke kryen obligimet e Umres, pastaj heq ihamin dhe qëndron ashtu i lirë deri në ditën e tetë të muajit dhul-hixhe, kur do t'i veshë ihramat dhe do të vendosë për kryerjen e haxhit. Haxhiu që kryen këtë lloj të haxhit e ka obligim të presë kurban nëse i ka mundësitë, e nëse nuk ka mundësi duhet t'i agjerojë tri ditë në Meke dhe shtatë ditë kur të kthehet në shtëpi. Nijeti për këtë lloj haxhi bëhet kështu:

"O Zoti im, unë vendosa të bëj umren, prandaj më lehtëso kryerjen e saj dhe pranoje këtë nga unë."

3. Haxhi Ifrad - Me këtë lloj haxhi nënkuftohet se haxhiu do të bëjë njet vetëm për kryerjen e haxhit. Nijeti për këtë lloj haxhi bëhet në këtë mënyrë:

"O Zoti im, unë vendosa ta kryej haxhin, prandaj ma lehtëso këtë dhe pranoje prej meje."

HAXHILLËKU PËR DIKË TJETËR

Haxhi është iradet, i cili kryhet nëse njeriu i ka mundësitë materiale dhe është i aftë fizikisht. Kur ndodh që di-

kush nuk është i aftë fizikisht dhe se nuk është në gjendje ta kryejë haxhin personalisht, ai obligohet të autorizojë dikë tjeter që t'i kryejë këtë ibadet, duke marrë përsipër të gjitha shpenzimet. Transmetohet se një grua kishte ardhur te Pejgamberi (s.a.v.s.) dhe i kishte thënë: "Vërtet Allahu e ka obliguar haxhin për robin e tij, por babai im është shumë i moshuar dhe nuk është në gjendje as të qëndrojë mbi deve, kështu a lejohet që unë t'i kryej haxhin?" Pejgamberi (s.a.v.s.) i tha: "PO".²

Haxhiliku për dikë tjeter lejohet, por duhen të plotësohen këto kushte:

1. Që personi, i cili e ka obligim ta kryejë haxhin të mos jetë i aftë fizikisht dhe kjo paaftësi të jetë e përhershme deri në vdekje si fjalë vjen i verbër, shumë i moshuar, i prekur nga ndonjë sëmundje që nuk ka shpresë shërimi.
2. Që bedeli ta kryejë haxhin me lejen apo urdhrin e atij për të cilin po kryhet haxhi.
3. Që të gjitha shpenzimet ose së paku pjesa më e madhe e shpenzimeve të janë obligim i atij për të cilin po kryhet haxhi.
4. Që bedeli ta ketë kryer haxhin për vete.
5. Që sasia e pagesës të mos kushtëzohet nga asnjëra palë.
6. Që bedeli ta kryejë haxhin ashtu si kërkohet, përndryshe nëse nuk plotësohen të gjitha kushtet si duhet, haxhi nuk quhet i kryer.
7. Që bedeli ta bëjë njet llojin e haxhit sipas autorizimit të personit për të cilin po kryhet haxhi.

HAXHI BEDEL PËR TË VDEKURIN

Nëse dikush shikon se i është afruar vdekja pa arritur ta përbushë detyrimin e kryerjes së haxhit, ai e ka për obligim të lërë vasijet që t'i kryhet haxhi. Haxhi i të vdekurit kryhet duke përdorur një të tretë e pasurisë, nëse 1/3 e pasurisë është e mjaftueshme për ta dërguar bedelin prej vendlindjes së të vdekurit. Por, nëse 1/3 e pasurisë është e pamjaftueshme për ta dërguar bedelin prej vendlindjes, atëherë duhet caktuar si *bedel* ndokush tjeter që banon më afér Mekkes, ose ndonjë banor prej Mekkes. Kur ndodh që dikush vdes, por nuk e le *vasijjeti* që t'i kryhet haxhi, atëherë trashëgimtarët nuk e kanë për obligim t'i kryejnë haxhin, por nëse ndonjëri prej tyre ia kryen, shpërblimin e ka tek Allahu (xh.sh.) dhe *inshallah*, Ai ia pranon këtë lloj haxhi.

2. Buhariu dhe Muslimi.

Kurban Bajrami

Falënderojmë Allahu e Madhëruar, i cili na e bëri të mundur ta arrijmë këtë ditë të begatë të Kurban Bajramit, ditën e sakrifisës njerëzore dhe të përkushtimit ndaj Krijuesit Fuqipotë.

I përgjigjemi thirrjes tënde, o Zot!

I përgjigjemi thirrjes tënde, të pashoqëruar askënd tjetër në adhurimin që kryejmë për Ty!

Falënderimet dhe lëvdatat janë vetëm për ty!

Pushteti i qiejve dhe i tokës është Yti. Askush tjetër nuk mund të adhurohet përvèç Teje!

Sakrificat tona janë vetëm për Ty!

“Ti je synimi ynë dhe kënaqësia jote është përbushja e kërkesës Tënde.”

Këto janë fjalët që i thonë me vete apo me zë gjuhët e mijëra dhe miliona haxhilerëve anekënd botës, të cilët janë grumbulluar sot rrëth shtëpisë së shenjtë, (Qabes).

Këto janë mesazhet Islame që përcillen tek shoqëritë e mbarë botës në këtë ditë madhështore të Kurban Bajramit.

Të veshur me rrobat e tyre të bardha, haxhilerët kërkojnë që nëpërmjet lutjeve të tyre të dalin të dëlirë nga ai shesh tubimi, të falur nga të gjithë gjynahet. Ata kërkojnë me përgjërim nga Zoti i tyre që t'u falen gjynahet e tyre, gjynahet e të afërmve të tyre dhe të mbarë ymetit Islam.

Në haxh mblidhen me miliona njerëz nga të gjitha vendet e botës. Haxhi të bën të kuptosh se të gjithë njerëzit e botës janë me të vërtetë të barabartë para Allahut (xh.sh.), pa dallim race, ngjyre, vendi, kombësie, pozite...etj. Cili sistem mund t'i bashkojë në këtë shkallë njerëzit e mbarë botës, përvèce besimi islam?

Sot, bota islame është përgatitur për këtë ditë sakifice, ditën e festës së Kurban bajramit, për të sakrifikuar pasurinë e tyre në emër të Zotit, për t'u gjendur me mishin e prerë të kurbanëve që dhurojnë pranë të varfërve dhe të vobektëve duke ua ngrohur zemrat dhe lehtësuar sadopak nevojën e tyre për mbijetesë.

Kurban Bajrami është një ditë e madhërueshme për myslimanët, sepse kjo ditë e bardhë pason përmbylljen me sukses së njërsës nga shtyllat e rëndë-



*“Tek Allahu nuk arrin as mishi,
as gjaku, por përkushtimi dhe devotshmëria juaj.”*

(Haxh, 37)

sishme të fesë islame, obligimit të “Haxhit”, aty ku të gjithë, të veshur me rroba të bardha, të drejtuar drejt një pike të vetme, të bardhë e të zinj, të pasur e të varfër, dalin të barabartë para adhurimit të Zotit Fuqiplotë.

Në këtë ditë, nëpërmjet mishit të kurbaneve që dhurohet tek besimtarët nxitet e shtohet edhe ndjenja e sensibilizimit në lidhje me njerëzit në nevojë. Kurban Bajrami është nxitje për dhurim dhe për ndihmë ndaj njerëzve në varfëri dhe në gjendje të rendë ekonomike, si dhe forcim i raporteve miqësore e familjare mes besimtarëve.

Kurbanë është simbol i devotshmërisë, i nënshtrimit e i dorëzimit para Allahut të Madhëruar. Allahu (xh.sh.) në Kuranin famëlartë thotë: *“Tek Allahu nuk arrin as mishi, as gjaku, por përkushtimi dhe devotshmëria juaj.”* (Haxh, 37).

Kurbanë përfshin në vete edhe dimensionin e shprehjes së mirënjojjes e të falënderimit ndaj Allahut të Madhëruar. Përmes therjes së kurbanit, njeriu tregohet mirënjojës ndaj Allahut (xh.sh.) dhe e falënderon Atë për të mirat e begatitë që i ka falur.

I lutemi Allahut që këto ditë të shërbejnë për t'u

mësuar njerëzve mënyrën e të jetuarit në një bashkësi, të rrethuar nga fryma vëllazërore, duke ndihmuar dhe përkrahur njëri-tjetrin, jo vetëm materialisht por edhe moralisht, duke u përpjekur që bashkëpunimi, fjala e mirë, përshtendetjet e ngrohta e respektimi i ndërsjellë të janë bajramet tona të përditshme.

I lutemi Allahut (xh.sh.) që këto ditë të festës së Kurban Bajramit të janë ditë gëzimi dhe hareje, ditë urimi dhe përgëzimi, ditë kënaqësie dhe lumturie, ditë pajtimi dhe bashkimi, ditë ndihme dhe solidariteti, ditë paqeje dhe qetësie.

I lutemi Allahut të Madhëruar që këto ditë festë t'i afrojnë zemrat e njerëzve me njëri-tjetrin. Në mënyrë të vecantë, Kurban Bajramin ia urojmë të gjithë mërgimtarëve të shpërndarë anekënd botës, të sëmurëve, jetimëve dhe të gjithë njerëzve, që pëarsye gjakmarrjeje janë të ngujuar.

**Gëzuar dhe për shumë vjet
Festën e Kurban Bajramit**

Shkencat e fizikës

Mr. Artur Tagani

Shkencat e fizikës në historinë e qytetërimit Islam, përgjithësisht, ashtu sikurse edhe në historinë e popujve të mëparshëm, u zhvilluan nën titullin "Shkenca e Natyrës".

Në Islam, shkollat e shkencës së fizikës ndahen në dy pjesë: shkolla e fizikës e përfaqësuar kryesisht prej filozofeve: Kindi, Farabi dhe Ibn Sina. Dhe shkolla e fizikës e përfaqësuar kryesisht prej kelamistëve, shkençtarëve dhe sufive, si: Nadhdhami, Imam Esh'ari, Fahreddin er-Razi, Biruni, Ibn Hajthem, el-Hazini, Ebu'l-Fet'h, el-Xhezeri, Benu Musa, Ebu'l-Berekat el-Bagdadi, Thabit Ibn Kurra, Suhreverdi, Kutbeddin Shirazi, Sadreddin Shirazi, Ibn Arabi dhe Mevlana Xhelaluddin er-Rumi. Grupi i dytë, krahasuar me grupin e parë janë më shkencorë në çështjen e fizikës dhe më origjinalë në teori dhe zbulimet që kanë bërë në këtë fushë.


El-Kindi, në shumë prej veprave të tij, prek tema të fizikës teorike dhe praktike. Ndërsa, mendimet e Ibn Sinasë lidhur me këtë temë bëjnë pjesë më së shumti në librat "esh-Shifa" dhe "Isharat ve Tenbihat". Veprat më të vyera në fushën e optikës janë: "Kitabu'l-Menadhir" i Ibn Hajthemit, "Tenkuhu'l-Menadhir" i Kemaluddin el-Farisi dhe "Nihajetu'l-Idrak" i Nasiruddin et-Tusi-t.

Ndërsa në fushën e Mekanikës dhe Dinamikës,



bien në sy: "Kitab fi marifeti'l-Hijali'l-Hendesije" i el-Xhezirit; "Kitabu'l-Karastinus" i Thabit bin Kurra-s, "Kitabu'l-Hijal" i vellezërve Benu Musa. Ndërsa, lidhur me mjetet matëse, veprat më të rëndësishme janë këto: "Kitabu'l-Xhevahir" i Birunit si dhe "Kitabu'l-Mizani'l-Hikme" i el-Hazinit është shumë i shquar në këtë fushë. Përsa i përket teknologjisë së orëve më e shquara është vepra e Fahreddin Ridvan Muhammed es-Se'ati-t.

Shkençtarët myslimanë kanë studiuar mjaft çështje interesante të fizikës si: Pasqyrat konkave, teoria e rrezes, teoria e ekuilibrit, etj. Ne, po trajtojmë vetëm dy prej tyre:



TEORIA E RELATIVITETIT E EL-KINDIT

Një nga mendimet më të reja është teoria e relativitetit të el-Kindit (shek. IX), shumë shekuj para se ta thonte edhe Einstein/Ajnshtajni (shek. XX).

Sipas el-Kindit, të gjithë qeniet dhe ngjarjet fizike të qenies janë relative. Koha, hapësira, lëvizja, nuk janë gjëra të pavaruara nga njëra-tjetra, të gjitha janë ngjarje relative të lidhura me njëra-tjetrën. Të gjitha ekzistojnë në varësi të tjetrës, materia me kohën, koha me materien, hapësira me lëvizjen, lëvizja me hapësirën dhe asnjëra prej tyre nuk është absolute.

El-Kindi në librin “el-Felsefetu'l-Ula” shprehet në këtë mënyrë: "...Koha ekziston vetëm në varësi të lëvizjes, materia në varësi të lëvizjes e lëvizja në varësi të materies...”, njëkohësisht shton edhe këto: "... atëherë, kurrë s'është asnjëra përpala tjetrës..."

Kështu që, ashtu sikur edhe sipas Einstein-it, edhe sipas el-Kindit nuk ka ndarje mes kohës dhe hapësirës, përkundrazi, ekziston uniteti kohë-hapësirë, të dyja duhen patur parasysh njëkohësisht kur analizohen.

Pra, sipas el-Kindit, gjithçka është relative me tjetrën. Gjithashtu, gjithçka është relative sipas njeriut. Për ta shpjeguar më qartë këtë, Einsteini bën krahasim me vagonët në lëvizje, kurse el-Kindi bën krahasim me njeriun që ngjitet e zbret nga qelli, sa më shumë të ngjitet aq më të vogël e sheh pemën dhe sa ma shumë t'i afrohet tokës pemët i sheh aq më të mëdha.

Teoritë e relativitetit si ajo e Einstein-it ashtu edhe ajo e el-Kindit bazohen në të njëjtin mendim filozofik

dhe shprehin të njëjtën gjë. Mirëpo, teoria e Einsteinit, ngaqë është shprehur në zhvillimet shkencore të shekullit të XX, ka një natyrë më matematikore dhe shkencore.

MEVLANA DHE NEVI: ATOMI MUND TË NDAHET DHE SUB-ATOMI EKZISTON

Mendimtari i shquar Mevlana Xhelaluddin er-Rumi (vd. 1273), duke mos qenë fizikant, si rezultat i pasurisë së tij shpirtërore, shekuj më parë, lajmëronte se atomi mund të ndahet dhe se ekzistojnë thërmijat e atomit. Ai shprehej kështu në mënyrë simbolike:

“Nëse pret një atom, brenda do gjesh një Diell dhe planete që sillen rreth atij Dielli.”

Njëkohësisht, Mevlana na tregon se atomi dhe thërmijat e tij nuk janë pasive, ato janë gjithnjë në lëvizje. Të gjitha këto mendimet ai i ka simbolizuar me “qieillin”. Qielli, ashtu sikurse simbolizon përbërjen dhe sistemin e gjithësisë, po ashtu simbolizon përbërjen dhe sistemin e atomit. Në qill, edhe njeriu rrotullohet si gjithësia dhe atomi, pra, është në lëvizje dhe është i nënshtuar ndaj harmonisë natyrore.

Shumë vite pas Mevlanës, edhe poeti dhe filozofi mysliman Jahja bin Pir Ali Nevi (vd. 1598), në veprën e tij “Netaixhu'l-Funun ve Mehasinu'l-Mutun” ka mbrojtur tezën se atomi mund të ndahet. Pasi e trajton gjatë nga aspekti logjik, e përfundon në këtë mënyrë: "...Përderisa atomi zë vend në hapësirë, lëviz, në të djathtë e të majtë, atëherë ka dy anë, diçka që ka dy anë mund të ndahet."



Koncepti i zemrës në mendimin dhe traditën islame

Zemra zë një vend të rëndësishëm në mendimin teologjik, filozofik dhe poetik të qytetërimit islam. Si një sistem që kërkon të edukojë njeriun sipas të vërtetës transhendentale të tij, fetë në përgjithësi dhe ajo islamë në veçanti i kanë kushtuar një vend të rëndësishëm zemrës si vendburimi nga ku shpërthejnë ndjenjat e ndryshme që kaplojnë si inteligjencën ashtu edhe fizikun e njeriut, qofshin këto ndjenja pozitive apo negative. Feja islamë synon të zhvillojë ndjenjat pozitive në sajë të edukimit me bazë fetare që ajo i jep njeriut nga njëra anë dhe të paralizojë ndjenjat e mbrapshta që mund të cytë shejtani dhe nefsi në zemrën e njeriut.

Duke qenë se gjuha liturgjike dhe konceptet themelore të besimit islam mbështeten në gjuhën arabe, gjuhët e cilët u shpall edhe libri i shenjtë, Kurani, do të kishte qenë shumë e vlefshme që të flasim pak mbi fjalën (ose fjalët) që përdoren në gjuhën arabe dhe tekstet e shenjta të Islamit në lidhje me fjalën zemër.

Për fjalën zemër në gjuhën arabe përdoren disa fjalë nga të cilat më e përdorura dhe e njohura është kalb. Përveç se organit në trupin e njeriut që mundëson qarkullimin e zemrës, fala kalb ka kuptimet etimologjike “të nxjerrësh në pah ç’ka brenda diçka, të përbysësh nga poshtë-lart, të kthesht nga njëra anë në anën tjeter, të ndryshosh dhe të transformosh diçka.” (Xhevheri, I, 240; Lisanu'l-arab, artikulli klb[kalb])

Në kontekstin fetar dhe atë mistik islam, zemra është burimi dhe mjeti i dijes dhe mendimit. Në këtë kuptim për zemrën janë përdorur edhe fjalët “rabbani latife” dhe “ilahi cevher”.

Në ajetet kuranore dhe hadithet Profetike në përgjithësi janë përdorur fjalët fuad, sadr, lub, nuha dhe kalb si sinonime me njëra-tjetrën dhe në kuptimin zemër. Gjuhëtarët arabë janë të mendimit se megjithëse këto fjalë i bashkon kuptimi i përgjithshëm i fjalës zemër, në kontekste më të veçanta secila prej këtyre fjalëve ka një

kuptim të caktuar të ndryshëm nga të tjerat duke shprehur gjendje dhe situata të ndryshme të zemrës. Në ajetet kuranore fjala fuad, në kuptimin zemër, është përdorur në ajetet që thuhet se rrëfehen ndodhitë e profetëve të mëparshëm pér ti dhënë forcë zemrës (Hud, 120); ku thuhet se zemra është përgjegjëse siç janë përgjegjëse sytë dhe veshët (Isra, 36). Fjala sadr do të thotë kraharor, por në ajetet kuranore është përdorur në kuptimin alegorik të zemrës. (Ali Imran, 119, 154, Enam, 125, Zumer, 22) Fjala kalb në kuptimin zemër është përdorur në raste kur kërkohet që zemrat të mendojnë, të perceptojnë dhe të logjikojnë. (Haxh, 46; Araf, 179)

Në ajetet kuranore dhe hadithet Profetike nuk flitet mbi natyrën dhe nuk jepet përkufizimi i zemrës, por vihet theksi mbi cilësitë dhe funksionin e saj. Fjala zemër (kalb) që përmendet në ajete kuranore dhe hadithe flitet rrëth aspektit të fuqisë njohëse që arrin njeriu nëpërmjet zemrës si cilësia bazë që e dallon njeriun nga kriesat e tjera. Duke qenë ana e njeriut që percepton, mendon dhe logjikon zemra është bashkëbiseduesja e shpalljes hyjnore, është e ngarkuar me detyrime dhe është përgjegjëse pér veprimet që kryen njeriu. Në ajete kuranore dhe hadithe shprehet qartë fakti që zemra është qendra e jetës njerëzore dhe fetare. Ajetet kuranore si: "Kanë zemra, por nuk kuptojnë me to" (Araf, 179), "A nuk kanë zemra që mendojnë ata?" (Haxh, 46) dhe "Për njerëzit me zemër ka këshillë pér të marr nga këto ajete" (Kaf, 37) tregojnë qartë se zemra është mjet i perceptimit, dijes, njohjes dhe të menduarit.

Një cilësi dalluese e zemrës është fakti se ai është organi që ndryshon dhe transformohet (Musned, IV, 408) dhe ndryshon ngjyrë në situata të ndryshme. Kjo shogërohet me ndryshime dhe transformime të mendimeve, ndjenjave dhe besimeve. Për këtë arsyenë një hadith jepet këshilla që besimtari të lutet me fjalët "O Allah që bën që zemra të ndryshojë dhe i sjell ato nga të dëshirosh Ti, bëj që zemra ime të jetë e palëkundur në fenë Tënde dhe e bindur ndaj Teje." (Muslim, Iman, 1; Tirmidhi, Daavat, 89)

Zemra është vendi i besimit (Huxhurat, 14, Muxhade, 22) dhe vetëm njeriu që e thotë dëshminë islame se nuk ka Zot tjetër përvëç Allahut dhe se Muhammedi është robi dhe i dërguari i Tij me gjuhën e tij duke e vërtetuar këtë me zemrën e tij është me të vërtetë besimtar mysliman (Buhari, Ilim, 39) Zemra e pastër është shkalla që feja islame kërkon që njeriu të mbërrijë. (Maide,



4; Ahzab, 53) Vetëm Allahu i ndriçon zemrat, (Buhari, Daavat, 9; Muslim, Musafirin, 181) zemra është vendi i devotshmërisë që është shumë i rëndësishëm në fe, sepse vetëm devotshmëria është kriteri me të cilin Zoti i dallon njerëzit nga njëri-tjetri (Haxh, 32; Musned, V, 71, 379) vetëm Allahu është Ai që u fal zemrave qetësi, ngopje, forcë dhe prehje (Bekare, 260; Ali Imran, 126; Maide, 113; Enfal, 10; Rad, 28; Feth, 4, 18) që i udhëzon ato, që i bën të janë të mëshirshme dhe të drejta dhe që zemrat të përputhen me njëra-tjetrën. (Ali Imran, 103; Hadid, 27; Tegabun, 11)

Por zemra mund të ndryshojë edhe për keq dhe mbrapsht. Kështu në Kuran flitet pér zemrën e verbuar (Haxh, 46) pér shqetësimet e zemrës dhe zemrat e bëra gurë (Bekare, 74; Maide, 13; Enam, 43; Zumer, 22) Zemrat mund të vulosen dhe kyçen para të vërtetës (Bekare, 7; Nahl, 108; Xhathije, 23) mund të privohen nga njohja e të vërtetës (Araf, 101) dhe mbi to mund të bie perdja e padiges. (Bekare, 88; Enam, 25; Isra, 46; Muhammed, 24; Mutafifin, 14)

Zemra kalon nëpër shumë statuse dhe gjendje të ndryshme, më e mira e të cilave është ajo e besimit, ndërsa më e keqja ajo e mosbesimit dhe kufrit. Zemra është fusha e betejës mes forcave hyjnore dhe ato djallëzore, e cila është shprehur me një hadith Profetik ku thuhet: "Në zemër



ka dy shtysa njëra prej të cilave vjen nga jeku, ndërsa tjetra nga shejtani." (Tirmidhi, Tefsiru'l-Kuran, 35)

Zemra është vendi ku zbret edhe shpallja hyjnore për profetët. Xhebraili ia pati shpallur Kuranin Profetit në zemrën e tij (Bekare, 97; Shuara, 193-194) Edhe ëndrrat dhe frysëzimet që merrte Profeti dhe frysëzimet e llojit kesh dhe marifet që përfjetojnë besimtarët e devotshëm ndodhin në zemrat e tyre.

Nga këndvështrimi islam, besimi arrihet në formën besim me zemër dhe pohim me gjuhë, pra vendi i vërtetë ku shfaqet besimi nuk është mendja, por zemra, qendra e ndjenjave. Kjo pikë është shumë e rëndësi-shme, sepse besimi është një ndjenjë sublime. Mendja nuk është gjë tjetër përvèç se një mjet që na duhet që të mbërrimë tek ndjenja e besimit dhe për të kaluar nga nivelet e caktuara në fillim të kësaj udhe.

Po qe se të vërtetat hyjnore që pranohen me mendje dhe vërtetohen me llogjikë nuk besohen edhe me zemër, atëherë ky nuk është një besim i vërtetë. Për sa kohë që besimi nuk zë vend në zemër, ai nuk shndërrrohet në veprim dhe nuk u jep drejtim sjelljeve. E gjitha kjo nuk ka asnjë vlerë në audiencën e Zotit. Prandaj edhe Zoti të urtët e hebrejnje (beni israil) që nuk i kishin përvetësuar me zemër të vërtetat hyjnore që i njihnin shumë

mirë, i ngjason me gomerët që transportojnë me qindra vëllime libra mbi vete.

Për këtë shkak të njohësh të vërtetat hyjnore nuk do të thotë vetëm t'i depozitosh ato në mendje, por të veprosh në përputhje me to duke zbërthyer enigmën e jetës dhe të rregullit të madh në univers si rezultat i meditimit dhe ndjeshmërisë. Ai që e arrin ta bëjë këtë gjë, ka një zemër të ndriçuar me drithën e besimit.

Rezultati që nxjerr mendja gjatë meditimit rrëth njeriut, universit dhe Kur'anit Fisnik, që luan rolin e një pasqyre ku reflektohen të vërtetat që gjenden tek njeriu dhe universi, është si xehorori bruto që nxirret nga toka. Zemra është ajo që i shndërron këta xehororë në gjende të përpunuar.

Zemra është qendra e ndjenjave. Funksioni i zemrës siguron perceptimin e plotë të së vërtetës absolute nëpërmjet unifikimit të argumenteve që parashtron mendja, ashtu siç do të ngjante kur krijojmë formën e parë që ka pasur një vazo e thyer në copa të ndryshme duke i mbledhur copat e saja.

Të gjitha këto na thonë se mbërritja e plotë dhe e mrekulluar tek e vërteta dhe e mira kushtëzohet nga edukimi i mendjes nëpërmjet vahjit dhe ndërhyrja e një zemre të plotë me besim në ato pika që mendja nuk mbërrin dot duke bërë që mendja ta kompensojë mangësinë e tij duke iu dorëzuar zemrës në ato pika.

Vlera e meditimit përforcohet në sajë të ndjeshmërisë, pra varet nga puna brenda një baraspeshe të harmonizuar në mes funksioneve të trurit dhe të zemrës. Në qoftë se i jepet përparësi vetëm trurit apo inteligencës atëherë njeriu ndoshta mund të bëhet një njeri i vlefshëm përkëtë botë, pra mund të shndërrrohet në një njeri interes i pozitiv, por për t'u bërë një besimtar i pjekur në besim, atëherë duhet që edhe zemra, qendra e ndjenjave, të edukohet me edukatë shpirtërore dhe ta udhëzojë mendjen aty ku ajo është e paaftë, sepse zemra, qendra e ndjesive, i jep drejtim meditimit të mendjes, ndërsa meditimi i jep drejtim vullnetit të lirë. Kjo do të thotë se faktori themelor i akteve të vullnetshme është zemra, pra ndjesitë që vendosen tek ajo dhe lëshojnë rrënje aty. Nga ky aspekt, pozicionimi i zemrës brenda kornizave të urdhërave hyjnorë, është më e rëndësishme sesa për organet e tjera.

Mehmet Ali Pasha: familja shqiptare që sundoi Egjiptin për 150 vjet

Mehmet Aliu, shqiptar, lindi në vitin 1769 në pjesën evropiane të Perandorisë Osmane. Mehmet Ali Pasha apo Haxhi Muhamedi, siç njihej ai pas vizitës që kreu në qytetet e Shenjta të Mekës dhe Medinës, është një nga njerëzit më të spikatur që ka prodhuar historiën shqiptare e shekullit të XIX-të. Ai u lind në qytetin e Kavallës, që asokohe ishte një port i vogël i Rumelisë. Babai i Mehmet Aliut ishte bimbashi i Kavallës dhe kishte emigruar në këtë qytet, nga fshati i Korçës, Zëmblaku, disa vite përpara lindjes së tij. Ai do të viste në kohën kur i biri ishte ende i ri. Kështu bashkiaku i Kavallës do ta mbante pranë dhe kujdesej për të birin e korçarit të vdekur si për djalin e tij. Mehmet Aliu do të martohej me një vejushë të bukur nga Kavalla, me të cilën do të lindte tre djem, Ibrahimin, Tosunin dhe Ismailin. Pas martesës, ai do të merrej me tregtinë e duhanit, e cila ishte tregtia më fitimprurëse asokohe në Rumeli. Në vitin 1800, Porta e Lartë në bashkëpunim me Britaninë e Madhe do të deklaronte xhilad kundër francezëve dhe do të niste luftën për të çliruar Egjiptin. Thirrjet e sulltanit për luftë në frontin egjiptian do t'i përgjigjeshin të gjithë myslimanët besnikë të perandorisë. Në kontingjentin prej 300 trupash vullnetare që do të niseshin nga Kavalla në këtë fushatë, do të ishte edhe Mehmet Aliu. Në luftimet që trupat osmano - shqiptare do të kryenin kundër francezëve, Mehmeti i ri do të shquhej si një nga strategët më të mirë e më të aftë të palës osmane.

Beteja e trupave të bashkuara osmane dhe britanike do t'i jepte fund shumë shpejt pushtimit francez të Egjiptit. Megjithatë, mposhtja dhe tërheqja e francezëve nga Egjipti ishte vetëm një pjesë e luftës për vënien nën kontroll të vendit. Problemi kryesor që Egjipi do të haste pas largimit të francezëve, ishte se kush do ta kontrollonte atë. Ndërsa Stambolli kërkonte të emëronte njerëzit e tij, forcat brenda

vendit dhe intrigat britanike kërkonin të vendosnin njerëzit e tyre për të qeverisur vendin e madh arab. Në përplasjet e shumta që ndodhën në Egjiptin e pasluftës, Mehmet Aliu do të shfaqej si një nga lojtarët më të aftë të betejës për pushtet dhe pozitë. Etja për pushtet do ta kthente Egjiptin e viteve 1803 – 1805 në një vend të vështirë për të jetuar. Komandën e trupës shqiptaro – turke do ta merrte Mehmet Aliu. Detyra e parë që i dilte përpara Mehmetit pas marrjes së komandës së trupave shqiptare në Egjipt, ishte vendosja e rendit dhe mundja e atyre që pretendonin për postin e valiut të Egjiptit. Duke përdorur aftësitë e trupave shqiptare dhe influencën e popullatës së Kajros, ai do t'i mposhtë njëri pas tjetrit kundërshtarët e tij. Më 14 mars 1805, hoxxhallarët e lartë të Universitetit të Azharit i kërkuan sulltanit që të zgjidhte Mehmet Aliun vali të Egjiptit. Fermani nga Stambolli që do të pranonte kërkesën egjiptiane, do të vinte më 12 Maj 2005, mëngjesin e një të diele.

Në vitin 1807 vendi do të sulmohet nga britanikët, të cilët ishin të pezmatuar nga vendosja e rendit në Egjipt. Megjithatë, ata do të thyhen nga armata egjiptiane në Rozeta dhe më pas do të detyrohen të braktisin Aleksandrinë. Por britanikët nuk ishin të vetmit që do të mërziteshin nga fitoret e Mehmetit. Në lidhje me pushtetin e valiut shqiptar do të kishte smirë edhe në Stamboll.

Pas shkatërrimit të mamlukëve ai nisi themelin e ushtrisë së rregullt egjiptiane. Për këtë arsy, në vitin 1814 ai nisi të formonte ushtrinë e parë moderne të botës islamë, e cila nuk do të ngrivej më sipas stilit të vjetër të ushtrisë osmane, por sipas skemave moderne të ushtrive evropiane. Kjo forcë e re do të quhej Nizam-i xholid, ose sistemi i ri ushtarak. Kjo ushtri do të drejtohej, do të strukturohej dhe do të stërvitej nga një kolonel francez i pashait, i quajtur Se-vës, të cilin Mehmeti do ta bindë të kthehet në mysliman.

Në kohën kur Mehmet Aliu ishte bërë sundues i Egjiptit, familja e Saudëve në Arabinë e sotme Saudite kishte nisur të krijonte shtetin saudit, e frymëzuar nga mësimet e Muhammed Ibn Abdul Vahab. Duke e konsideruar rebelemin saudit kundër normave të shariatit, shejhulislami dhe shejhët e Azharit nxorën fetva që Sauditët të viheshin nën kontroll, si dhe të ndalohej forma e dhunshme e luftës së tyre. Mehmet Aliu do të dërgonte djalin e tij, Tosun Pashën në Qytetet e Shenjta, për t'ia kthyer ato fisit të kurejshëve dhe kujdestarit të tyre, sulltanit, si dhe për t'i larguar së andejmi pushtuesit e Nexhdit. Fushatat e bijve të Mehmet Aliut do të përfundonin me sukses më 1818, në kohën kur forcat shqiptaro – egjiptiane pushtuan kryeqytetin saudit, Darijan dhe burgosën Abdullah ibn Saudin. Pas kësaj, Ibrahim Pasha pushtoi edhe pjesët e tjera të Nexhdit dhe Hixhazit (1818 – 1820). Përveç fitoreve në beteja, Ibrahim mori nga sauditët edhe një nga kopjet më të vjetra të Kuranit të Shenjtë, kopje e cila datonte që nga koha e kalifit të tretë të Islamit, Osmanit. Kjo kopje do të ruhet deri në ditët e sotme në Top Kapë Sarajet në Stamboll.

Pas nënshtrimit të sauditëve, mes viteve 1820-1822 Mehmet Aliu vazhdoi të përfshinte nën sundimin e tij edhe provincat afrikane të Nubisë, Sanarit dhe Kordofanit, të cilat aty e tutje do të njiheshin me emrin Sudan. Për të nënshtruar ato vende, ai dërgoi në vitin 1820 një ekspeditë ushtarake prej 4000 vetësh, që komandohej nga djali i dytë i pashait, Ismail Pasha dhe e cila në 1823 realizoi themelimin e provincës së Sudanit, duke shpallur Hartumin kryeqendër të vendit.

Në kohën kur Mehmet Aliu kishte nënshtruar Sudanin dhe Arabinë Saudite, me cytjen e fuqive perëndimore grekët në Ballkan po nisin rebelimin e tyre. Ky rebelim do të gjente kohën më të mirë të shpërthimit të tij me rastin e vrasjes së Ali Pashë Tepelenës në Jug të Shqipërisë nga osmanët. Duke qenë se gjatë asaj kohe Perandoria Osmane nuk kishte burimet e duhura njerëzore për të shtypur rebelimin grek, ky i fundit nisi spastrime të egra etnike kundër myslimanëve. Sulltan Mahmut II do të kërkonte ndihmën e Mehmet Aliut për të shtypur rebelimin. Kundërshtari grek nuk ishte i vetëm në luftën e tij. Brenda një kohe të shkurtër, revoltës greke do t'i bashkohej shumica e ishujve të Egjeut, duke bërë që lëvizja të shtrihej deri në Gjirin e Korintit. Duke përdorur terrorin dhe grabitjen, në verën e vitit 1822 Morea, Athina, Teba dhe Misolongjia do të merreshin në kontroll nga rebelët grekë, të cilët filluan t'i masakronin gjithandje shqiptarët dhe turqit myslimanë që gjenin. Rebelimi arriti kulmin e tij në dhjetorin e vitit 1822, koha kur grekët deklaruan në More pavarësinë e Greqisë dhe zgjodhën njëfarë Aleksandër Mavrokordatos

si presidentin e tyre. Në këto kushte, duke qenë se forcat jeniçere të sulltan Mahmutit II ishin treguar të paafta për të shtypur ekstremistët, sulltani do të kërkonte ndihmën e guvernatorit të tij në Egjipt.

Në shkurt e vitit 1825, ai dërgoi në Kretë e më pas në More djalin e tij, Ibrahim Pashën, me një fuqi ushtarake prej 17.000 vetësh. Sulmet e ushtrisë shqiptaro – egjiptiane do t'i mundnin dhe mposhtnin lehtë ekstremistët e hajdutët grekë, duke zgjuar kështu te shqiptarët e Greqisë shpresë për vendosjen e rendit. Rendi në Greqi do të vendosej me çlirimin e Misollongjisë, më 23 Prill 1826, kur shumica e rebelëve grekë u shpërndau dhe vendit iu kthye paqja sërisht.

Në Qershorr 1827, nën udhëheqjen e Ibrahim Pashës trupat egjiptiane do të hynin në Athinë dhe përpjekjet e grekëve për rebelime do të bëhen të pamundura. Por fuqitë evropiane që ishin të vendosura për krijimin e shtetit grek, nënshkruan në Londër më 6 Korrik 1827 një traktat tripalësh ndërmjet Britanisë, Francës dhe Rusisë, traktat i cili parashikonte ndërhyrjen e përbashkët për të push-tuar tokat greqishtfolëse të Rumelisë. Për këtë, në shtatorin e vitit 1827 flota e aleatëve u dërgua në Mesdhe për të bllokuar Dardanelet së bashku me Morenë, duke kërcënuar me luftë trupat e Mehmet Aliut. Ata ndeshën në vendosmérinë e Ibrahim Pashës, i cili refuzonte çdo diktat perëndimor për të lëshuar Rumelinë e kësisoj, më 20 te-tor aleatët e krishterë vendosën të përballen ushtarakisht me forcën osmane. Duke pasur epërsi në numër dhe armatime, ata mundën të hynin në portin e Navarinos dhe sulmonin flotën osmane të cilën e shkatërruan plotësisht, duke vrarë mbi 8000 marinare.

Pas luftës në Greqi, Mehmeti kishte kërkuar nga sulltani që të administronte Sirinë, vend ku fshiheshin ende shumë armiq të tij. Megjithatë, sulltani e kishte refuzuar në lidhje me këtë. Duke parë se sulltani, në vend që të merrej me ruajtjen e perandorisë, kish filluar të vriste pashallarët e tij lart e poshtë, Mehmet Aliu i dha mbështetje mikut të tij në Shkodër, Mustafa Bushatit dhe Kapudan Husein Gradash-qeviqit në Bosnjë, kur këta të dy u rebeluan kundër reformave të Mahmudit II. Mahmuti, i cili ia kishte frikën valiut të tij të fuqishëm, urdhëroi guvernatorin e Sirisë që të bënte përgatitjet për ta sulmuar. Por Mehmet Aliu e mori vesh këtë në kohën e duhur dhe vendosi ta aneksojë Sirinë. Për të pushtuar Sirinë, ai dërgoi të birin, Ibrahim Pashën, i cili i prirë një armate detaro – tokësore, brenda një kohe rekord do të pushtonte Gazën, Jeruzalemin dhe Haifën, ndërsa pas një rrethimi tetë mujor (16 Nëntor 1831 – 27 Maj 1832) arriti të pushtonte edhe Akran. Pjesa e mbetur e Sirisë, Sidoni, Bejruti, Tripoli e më në fund Damasku, do të kalonin

në duart e Ibrahimit më 18 Korrik 1832.

Në marsin e vitit 1832, i trembur nga sukseset e Mehmetit, sulltani shpalli luftë të hapur kundër tij dhe të bijve në Mars 1832, duke vënë në krye të fushatës ushtarake Aga Huseinin, guvernatorin e Edirnesë. Kur trupat osmane hynë në Siri, në krah të shqiptarëve u rreshtuan të gjithë arabët. Për pasojë, ushtria osmane u thyte në Hums dhe Belen. Mahmuti dërgoi një ushtri të dytë kundër Ibrahim Pashës, nën komandën e kryevezirit Reshit Mehmet Pasha. Më 21 Dhjetor 1832, Ibrahimi mundi t'i thyente osmanët në dyert e Konjës dhe të përparonte drejt Stambollit. Të tronditut se mos Perandoria Osmane binte në duart e valiut të Egjiptit, më 27 dhjetor car Nikolla dërgoi një mision ushtarak në Stamboll, i cili e bindi sulltanin të pranonte ardhjen e trupave ruse në ndihmë të tij. Në të njëjtën kohë, Ibrahim Pasha vazhdonte marshimin e tij nëpër Anadoll, duke pushtuar Kytahjanë (2 Shkurt 1833) dhe duke dimëruar më pas në Bursa, vetëm 50 milje larg kryeqytetit. Në këto kushte, duke u ndjerë i terrorizuar nga trupat e valiut të tij, sulltani i dha leje flotës ruse të hynte nëpërmjet Detit të Zi për të ndihmuar në mbrojtjen e Stambollit. Rusët arritën më 20 Shkurt dhe i vendosën tendat e tyre përgjatë Bosforit.

Muhamed Aliu e kuptoi panikun e sulltanit dhe për të shhangur marrëzitë që ai mund të bënte me rusët, i ofroi paqe duke i kërkuar si shkëmbim marrjen nën kontroll të Sirisë. I tmerruar nga forca e ushtrisë egjiptiane, Mahmuti u detyrua t'i pranonte të gjitha kërkeshat. Në negociatat që u zhvilluan në Kytahja më 29 mars 1833, Mustafa Reshit Efendiu, i cili përfaqëson sulltanin i dha Ibrahim Pashës të drejtën për të qenë guvernator i Damaskut dhe i Alepos. Mehmet Aliu u pranua si guvernator i Egjiptit dhe i Kretës, ndërsa Ibrahimi u emërua guvernator i Xhides. Kësisoj, kësaj familjeje shqiptare iu bë e mundur të merrte nën kontroll pjesën më të madhe të botës arabe. Në këtë mënyrë, Mehmet Ali Pasha, shqiptari nga Zëmlaku i Korçës do të bëhej sunduesi i Sirisë, i Egjiptit, i Hixhazit në Arabi, i Sudanit dhe i Kretës.

Në vitin 1838, me qëllim që të krijonte një mbretëri të tijë, Mehmeti vuri në dijeni fuqitë evropiane që kishin ndihmuar sulltanin më parë, se asynonte të shkëputet nga varësia e Stambollit. Reagimi negativ i Evropës ndaj deklaratës së Mehmetit do të shtynte sulltan Mahmutin II të provonte sërisht forcën me pashain. Ai e deklaroi atë tradhtar dhe dërgoi kundër Ibrahim Pashës një ushtri, e cila do të thyhej në brigjet e Eufratit nga Ibrahimi në Qershorr 1838.

Sulltani i ri që erdhi në Stamboll, Abdul Mexhidi i ofroi të drejtën e trashëgimisë së sundimit në Egjipt,

duke e shpallur hidiv. Nga ana e tij, pashai kërkoi të trashëgonte sundimin edhe mbi Sirinë dhe Adananë.

Por fuqitë evropiane me në krye Britaninë, Prusinë, Austri-në dhe Rusinë, të cilat frikësosheshin nga forca e pashait dhe planifikonin që herët a vonë ta kolonizonin Lindjen e Mesme, nënshkruan në korrikun e vitit 1840 një traktat në Londër, nëpërmjet të cilit lejojnë që Mehmet Aliu të sundonte vetëm në Egjipt dhe Akra. Meqë Mehmet Aliu nuk e pranoi ultimatumin e perëndimorëve, këta të fundit sulmuant më 1840 zotërimet e tij në Bejrut. I gjendur përballë këtij agresioni perëndimor, pashai do të pranonte fermanin e sulltanit në qershorr 1841, duke mbetur vetëm sundimtar i Egjiptit.

Pas nënshkrimit të paqes me sulltanin, duke qenë tashmë i thyer në moshë, Mehmet Aliu do të kalonte vitet e mabetura të jetës së tij në paqe. Ai u përpoq fuqimisht që të ndërtonte ekonominë egjiptiane dhe të vendoste marrëdhënie të mira me Stambollin e sulltanin, të cilin edhe e vizitoi në vitin 1846. Në këtë kohë, Pashai nisi të afrojë rrëth vetes shqiptarët e tij nga Kavalla dhe nga pjesët e tjera të Greqisë, të cilët tashmë ishin dëbuar prej vatrave të tyre nga terrori grek, duke iu dhënë atyre toka e pasuri të shumta. Në vitin 1847 ai u largua nga pushteti si pasojë e moshës së thyer, duke ia lëshuar vendin të birit, Ibrahimi, i cili sundoi deri në vitin 1848. Ibrahimi do të pasohej nga Abazi (1848-54), i cili ishte i biri i Tosunit, për t'u ndjekur pastaj nga Saidi (1854-63), Ismaili (djali i Ibrahimit), nga Tefiku (1879 – 1892), Abazi II (1892 – 1914), Fuati, dhe më në fund Faruku, i cili u rrëzua nga pushteti në vitin 1952.

Me vdekjen e Ibrahimit dhe të Mehmetit, dinastia e shqiptarëve në Egjipt nisi të dobësohej ndjeshëm. I vetmi që u mundua të modernizonte vendin ishte hidive Ismaili, i cili sundoi nga 1863 deri më 1879. Megjithatë, ngaqë mori borxhe të shumta, e zhyti vendin në mjerim duke e kthyer në pre të bankierëve perëndimorë. Megjithatë, në kohën e Ismailit Egjipti përfitoi themelimin e postës, modernizimin e ushtrisë, ndërtimin e hekurudhave, të telegrafit, por mbi të gjitha ndërtimin e kanalit të Suezit, i cili u inauguroua në 1869. Kostoja e lartë e kanalit të Suezit do të sillte shkatërrimin më të madh për regjimin e Ismailit, i cili u detyrua t'ia shiste kanalin bankerëve të tij britanikë. I zhytur në borxhe, Egjipti do të shndërrohej pak e nga pak në një koloni britanike, deri sa më 1882 britanikët e morën të gjithë vendin nën kontroll. Megjithatë, për të legjitimuar pushtimin e tyre, ata vazhduan të mbanin në pushtet dinastinë shqiptare deri në vitin 1952, koha kur mbreti Faruk do të rrëzohej nga pushteti prej gjeneralit nationalist egjiptian Xhemal Abdul Naser.

Një shtet i vogël: Familja

Familja është qeliza më e rëndësishme e edukimit në shoqëri. Individët e sigurojnë edukimin e tyre më të rëndësishëm pikërisht nga nëna dhe babai.

Familja ushtron ndikimin e saj kudo përmes edukimit, ndaj për një edukim të suksesshëm nevojitet sigurisht një komunikim i mirë. Ky i fundit i siguron fëmijës besim në vetvete dhe i mëson si të integrohet në shoqëri pa pasur mundime artificiale.

Shejh Sadi në veprën e tij "Gylstan" tregon:

E pyetën një gjemb të tharë: Si ka mundësi që të vjen një erë kaq e mirë?

Gjembi iu përgjigj:

- Një herë e një kohë isha zot shtëpie i trëndafilave,

jetoja me to, prandaj e kam sot këtë erë.

Nëse edhe kopshtarit i duhet të tregojë përkujdesje për të rritur një bimë, aq më tepër përkujdesja dhe koha mbeten elementë të pashmangshëm në edukimin e njeriut "krijesës më të nderuar".

Në këtë kuadër, detyra e nënës dhe e babait si lokomotiva të familjes, është shumë e rëndësishme. Në fund të fundit individët marrin nga nëna dhe babai ngjyrën dhe formën, duke u bërë shëmbelltyra të tyre. Atëherë, cilat duhen të jenë veçoritë e nënës dhe të babait?

DASHURIA DHE RESPEKTI

Në komunikimin dhe marrëdhëniet që krijojmë me njerëzit që na rrrehojnë, rruga më e lehtë për të



depërtuar në zemrat e tyre është ndjesia e dashurisë dhe e respektit pa kushte që duhet t'u dhurojmë. Përpara se të marrim, duhet të japim. Nësë presim dashuri dhe respekt nga anëtarët e familjes, fillimisht duhet të jemi ne ata që duhet t'i përcjellim këto ndjesi me bujari dhe pa kushte. Nuk duhet të harrojmë që respekti nuk merret me zor, por fitohet.

Profeti ynë i nderuar (s.a.v.s), sa herë hynte në shtëpi jepte selam, kalonte një pjesë të kohës me fëmijët, i merrte në prehër, i puthte dhe luante me to. Studiu- esit e kohëve të fundit kanë vërtetuar se vetëbesimi dhe suksesi që tregojnë fëmijët që janë rritur me dashuri e ndjenjë, është shumë më i madh se i atyre që janë rritur në mungesë të përkujdesjes.

DËGJIMI

Ata që nuk dinë të dëgjojnë, nuk ia dalin mbanë as të jenë të dëgjuar. Të dëgjosh bashkëshortin/bashkëshorten apo fëmijët, do të thotë të japësh këtë mesazh: "Ti me ndjenjat dhe mendimet e tua je një individ i veçantë. Unë vlerësoj mendimet tuaja dhe do të të dëgjoj përherë..."

Kur Profeti ynë i nderuar (s.a.v.s) takohej me një njeri, kurrë nuk e tërheqte dorën i pari; kur fliste me të nuk e kthente kokën i pari, dhe kur ulej me dikë nuk ngríhej i pari. (ibn Maxhe, Edeb, 15)

Nëse fëmijët dhe bashkëshortët nuk gjejnë në shtëpi njerëz që dinë të dëgjojnë, sigurisht që do orvaten të gjejnë njerëz të tillë jashtë familjes, duke rrezikuar kështu të bien pre e orientimeve të pasakta.

MIRËKUPTIMI

Modelin më ideal të mirëkuptimit e gjejmë te Profeti ynë i dashur, te mësuesi më ideal i njerëzimit.

Hz. Enesi tregon: "I kam shërbyer Profetit për dhjetë vite, por asnjëherë ai nuk më ka thënë "uf, pse e bëre këtë kështu, e pse nuk e bëre ashtu?" (Buhari, Edeb, 39)

BUTËSIA (HILMI)

Pejgamberi ynë (s.a.v.s) ka thënë: "Allahu është i butë, e do butësinë. Atë, të cilën nuk ia jep vrazhdësi-së dhe ashpërsisë, ia jep veprave dhe fjalëve të buta." (Muslim, Birr)

Në marrëdhëniet me njerëzit e tjerë, njeriu lëshon zë njësoj sikur të ishte midis dy malesh... Nëse nxjerr fjalë të mirë, kjo fjalë do kthehet me jehonë të mirë, nëse flet ndonjë fjalë të keqe, do vërejë se e njëjta fjalë të rikthehet me jehonë të keqe.

TË RUAJMË QETËSINË

Edukimi është një çështje durimi. Gjergjefi kërkon të njëtin durim si në fillim, në vazhdim, ashtu edhe në fund të punës. Edhe Profeti ynë i nderuar porosit: "Lehtësoni, mos vështirësoni...." (Ahmed ibn Hanbel, Musned, v.1)

Me pak fjalë, familja është guri i themelit në formimin e shteteve të mëdha, por në një kuptim është shteti ynë i vogël. Duke qenë në rolin e nënës dhe babait, ne jemi inxhinierët e këtij shteti, të cilin do të mund ta ndërtojmë të fortë e të sigurt vetëm nëse tregojmë kujdes për edukimin e shëndoshë të fëmi-jëve tanë.



Cilat ushqime me cilat ilaqe janë të dëmshme


Disa ilaqe, nëse përdoren me vend dhe në doza të përshtatshme na shpëtojnë jetën, por në disa raste mund edhe të na e nxijnë atë. Ilaçet që merren me ushqime të gabuara mund të shkaktojnë reaksione e për pasojë mund ta ngadalësojnë ose ta përvpejtojnë veprimin e ilaçit. Madje, në disa raste mund të çojnë edhe në vdekje.

Gabimi më i madh që bëhet në përdorimin e ilaqeve, është marrja e tyre bashkë me ushqime të gabuara. Si pasojë e këtyre gabimeve, ilaçet bëjnë më shumë dëm se sa dobi. Reaksiuni që shkaktohet nga përzierja me ushqimet e gabuara, vazhdon edhe 2-3 javë pasi janë ndërprerë ilaçet.

- Disa ilaqe depresioni, nëse merren bashkë me disa ushqime si: turshi lakre, fiq, mëlçi pule ose viçi, suxhuk etj., të cilat janë të pasura me proteinën tiranin, duke ngritur presionin e gjakut shkaktojnë dhimbje koke, të vjella, madje edhe vdekjen e të sëmurit.

- Personi që përdor vitaminën C, nuk duhet që në të njëjtën kohë të pijë qumësht ose të përdorë produkte të qumështit, sepse ato pengojnë përthithjen e vitamינs C. Ilaçet që përdoren për uljen e kolesterolit nuk duhet të përdoren me lëng grejpfruti, sepse lëndët kimike që ndodhen tek grejpfruti shkaktojnë vonimin e thërrimit të ilaqeve në zorrë, duke penguar kështu enzimat që kryejnë punën e thërrimit. Kjo anomali, e cila shkakton mbledhjen e shumë ilaqeve në gjak, e ngre nivelin e gjakut 2-16 herë.

- Antibiotikët me bazë peniciline nuk duhet të përdoren me ushqime që përbajnjë acide, siç janë lëngjet e frutave, kafeinat, domatet etj. Këto produkte ushqimore shtojnë aciditetin e stomakut duke e dëmtuar atë, dhe si pasojë e këtij dëmtimi ulet ndikimi i ilaqeve. Gjatë përdorimit të tetraklinës nuk duhet të konsumojmë ushqime që përbajnjë kalcium (quëmësht, kos etj) dhe hekur. Gjithashtu, edhe ilaçet e



hekurit që përdoren për kurimin e anemisë nuk duhet të konsumohen në të njëjtën kohë me ushqime të pasura me kalcium si produktet e qumështit, pekmez, susami, lajthia, frutat e thata, fasulet, etj. Këto ushqime duhet të konsumohen të paktën dy orë më vonë, sepse pengojnë përthithjen e hekurit, gjë e cila bëhet shkak për shmangien e efektit të ilaqeve.

- Ilaçet diuretike, të cilat përbajnjë triamterene bllokojnë hedhjen e potassiumit nga veshkat, ndërsa shtimi i potassiumit bëhet shkak i rrahjeve të çrregullta të zemrës. Prandaj, diuretikët që përbajnjë triamterene nuk duhet të përdoren së bashku me ushqime të pasura që potassium, si për shembull bananja, kajsia, patatja etj.

Dëmet e Koka-Kola's në trupin tonë minutë për minutë...

Shumica e njerëzve e konsumon koka-kola'n pa u menduar fare. Askush nuk pyet se "çfarë dëmesh ndodhin në trupin tonë pas pirjes së koka-kola's?"

Le të shohim së bashku dëmet që ndodhin në trupin tonë minutë për minutë pas pirjes së një gote koka-kola...

Në 10 minutat e para: Në trupin tonë hyjnë 10 lugë çaji sheqer, sasi kjo që është e barabartë me atë që duhet të marrim gjatë gjithë ditës. Brenda këtyre minutave në trup hyn edhe acidi fosforik, i cili na pret ndjenjat e shijes.

Në minutën 20: Shekeri në gjak pëson një ngritje të menjëhershme dhe si pasojë shpërthen një sasi e madhe insuline. Ndërsa mëlçia përgjigjet duke e kthyer shequerin në yndyrna. Të gjitha këto ndodhin brenda disa minutave.

Në minutën 40: Plotësohet thithja e kafeinës. Bebjë e syve zmadhohet dhe presioni i gjakut rritet. Mëlçia fillon të pompojë më shumë sheqer në gjak, ndërsa receptorët e adenozinës në tru bllokohen që të parandalojnë plogështinë.

Në minutën 45: Në tru shtohet sekrecioni i dopaminës. Kjo është e ngjashme me reaksionet që shkakton heroina në trup.

Në minutën 60: Fillojnë të ndihen pasojat diuretike të kafeinës, pra keni nevojë të dilni në banjë. Kjo do të thotë se bashkë me urinën do të hidhen jashtë edhe kalciumi, magnezi dhe zinku që janë depozituar në trup.



Pak më vonë... do të filloni të ndjeni përsëri nevojën për sheker. Do të ndiheni të këputur dhe të dobët. Për shkak se të gjitha lëngjet që keni marrë me koka-kola'n janë hedhur jashtë trupit, do të ndjeni përsëri etje. Pas nevojës për sheker, do të ndihet edhe nevoja për kafeinë (si në rastin e cigares...).

Sa për kureshtje, po ju japid edhe një informacion rreth ngjyrës së koka-kola's. Shumë pak njerëz e dinë se ngjyra e koka-kola's përfitohet nga një insekt i quajtur *Cochineal*, i cili jeton në ishujt e Kanaireve dhe në Meksikë. Për më tepër mjafton të shkruani emrin e insektit në Google.

Lulet në kalsë i bëjnë nxënësit më të suksesshëm

Në Angli, një studim, i cili zgjati rreth 20 vjet, nxori në pah një përfundim të çuditshëm. Vazot me lule të vëna nëpër klasa e rritën deri në 70 % suksesin e nxënësve. Drejtuesit e një shkolle filllore të Londrës, duke u bazuar në përfundimin e këtij studimi, filluan të vendosin nëpër klasa vazo me lule, me qëllim që

të rrisin performancën e nxënësve. Pas vendosjes së luleve në të gjitha klasat, nxënësit shprehën kënaqësinë e këtij veprimi, por se sa do të pasqyrohet ky veprim në dëftesat e nxënësve, këtë do ta shohim në fund të vitit...

Udhëtimi në Mars për 39 ditë



Më në fund, ëndërra e njeriut për të shkuar në "Planetin e kuq" po bëhet realitet.

Me ndihmën e teknologjisë më të avancuar, shkencëtari arritën të ndërtojnë një raketë plazme me reaktor nuklear, e cila mund të lëvizë me shpejtësinë 198 mijë kilometra në orë. Raketa e quajtur Vasmir mund ta përshkojë për

39 ditë distancën prej 78 milionë kilometrash mes Tokës dhe Marsit.

Ka shumë vite që njeriu bën plane për të shkuar në Mars. Mirëpo, me mjetet kozmike që disponojmë në kohën tonë, distanca prej 78 milionë kilometrash zgjat rrëth 500 ditë dhe mundësia e kthimit është zero. Duket se raketa plazëm mbi të cilën është punuar për 40 vjet me radhë nga shkencëtarë Franklin Chang Diaz, i cili punon në NASA, do të jetë zgjidhja më e shpejtë e këtij problemi.

Në revistën "Popular Science" shkruhet se, sipas llogaritjeve të Diazit, i cili ka shkuar shtatë herë në hapësirë, udhëtimi për në Mars do të zgjasë vetëm 39 ditë. Në sajë të motorëve të plazmës, mjeti hapësinor do të arrijë në atmosferën e Marsit. Më pas, me anë të një kapsule do të zbresë në planet. Pas studimeve që do të zhvillohen, kapsula do të fluturojë deri tek mjeti hapësinor nga ku do të kthehen në tokë.

Të dhënat personale në fB në shitje

Sipas një studimi të kryer nga Wall Street Journal, disa nga aplikacionet më të njoitura që shëtisin në rrjetin social më të përhapur në botë FaceBook, u kanë shitur informacion kompanive të reklamave dhe të internetit mbi identitetin e miliona përdoruesve dhe listat e miqve të këtyre përdoruesve. Madje edhe personat të cilët kanë vendosur nivelin më strikt të mundur të privatësisë që mund të lejojë FB në profilin e tyre janë bërë pre e këtij pazari.

"Kjo gjë shkel hapur rregullat e këtij rrjeti social dhe rihapsështjen e aftësisë së FB për të ruajtur informacionin e përdoruesve të tij", shton gazeta. Në listën e programeve që kanë shitur të dhënat personale bëjnë pjesë rrëth 10 programet më popullore të FB. Ndër këto është edhe Farmville që ka rrëth 59 milion përdorues dhe Texas Holdem Poker. Shumica e aplikacioneve të tillë nuk janë krijuar nga programuesit e FB, por nga programues të tjera që nuk kanë lidhje me rrjetin e njoitur social.



Parlamenti Europian votoi rezolutën për heqjen e vizave



Më datë 28 shtator të këtij, viti Parlamenti Europian ndezi dritën jeshile në lidhje me liberalizimin e vizave për Shqipërinë dhe Bosnjën. Komisioni për Liritë Civile, Drejtësi dhe Punët e Brendshme miratoi me 49 vota pro dhe 2 abstenime projekt-rezolutën e eurodeputetes Tanja Fajon, që parashikon liberalizimin e vizave për shtetasit e Shqipërisë dhe Bosnjës.

Gjithashtu, komisioni refuzoi amendamentin e propozuar nga eurodeputeti hollandez Daniel Van der Stoep, sipas të cilit synohej që Shqipërisë dhe Bosnjës t'u kërkohej tërheqja nga Konferenca Islamike si kusht për liberalizimin e vizave.


Ndërsa në datën 7 tetor Parlamenti Evropian hodhi në votim dokumentin e eurodeputetes Tanja Fajon, për heqjen e vizave për Shqipërinë dhe Bosnjën. Rezoluta e Fajon u miratua me shumicë votash nga eurodeputetët e PE-së, pra me 538 vota pro, 47 kundër dhe 41 abstenim, çka përbyll kështu edhe një votim tjetër të rëndësishëm për dy vendet ballkanike në lidhje me heqjen përfundimtare të vizave afatshkurtra.

Ky është një moment i shumëpritur për të gjithë qytetarët shqiptarë që duan të shijojnë lirinë e levizjes me vendet e BE, pa iu nënshtuar më regjimit Schengen, ashtu siç kanë përfituar prej mëse një viti qytetarët e tre vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor, Serbi, Mali i Zi dhe Maqedonia.

Pas miratimit të rezolutës, Fajon ka duartrokitur së bashku me shumë eurodeputetë të tjerë që kanë qenë mbështetës të kësaj nisme. Votimi i radhës dhe i fundit do të jetë ai i 8 nëntorit, që do të bëhet nga ministrat e Brendshëm të Bashkimit Evropian. Raporti i eurodeputetes slovene Fajon thekson se që të dy vendet i kanë përbushur kriteret për liberalizimin e vizave, ndërkohë që po bëhet progres për pjesët e mbetura të kritereve. Dokumenti i hartuar nga Fajon shkruan se Shqipëria ka bërë progres për arritjen e këtij qëllimi. Megjithë kundërshtitë e disa eurodeputetëve, raporti kaloi pa ndonjë problem, ashtu siç ishte paralajmëruar nga krerët kryesorë të grupimeve politike në këtë Parlament.

Fryma e fundit

Nga lulishta e zemrës



“Njeriu vdes ashtu siç jeton
dhe do të ringjallët ashtu siç vdes.”

**LIBRI MË I RI I AUTORIT
OSMAN NURI TOPBASH
I PËRKTHYER NË GJUHËN SHQIPE**



Qytetërimi i virtyteve

Nga epoka e lumturisë deri në ditët tona

“Historitë e bukura
të robërve të devotshëm
janë pothuaj si dhuratat
e xhenetit.”



N.T.P. MAHMUT-HOLDING

Samettin Taç - Nazim Taç

Dewilux®
SPECIALIST IN PAINT
NGJYRA DHE LLAQE E SPECIALIZUAR

NGJYRNA - LLAQE - PJESË TË MOBILAVE DHE MEDIJAPAN BOYA - VERNIK - MOBILYA AKSESUARI VE MEDIYAPAN

- SAMET LLAGERA PËR FIOKA
- MEDIJAPAN
- KËND MALLTERIT
- KËND ME RRJET
- KËNDE KNAUFIT NGA ALUMINI
- RRJETA PËR FASADË



Lagja Arbanë Prizren
mahmut_holding@hotmail.com



Mob: +377 044 242 468
+377 044 230 751
+377 044 339 452
+377 044 390 538

Turk/Mob: +90 537 887 1210



BOJRA AMERIKANE

Adresat: Kompleksi Bexhisteni, në Rus / Shkodër, Koplik, Lezhë, Tiranë, së shpejti edhe në Kosovë
Mobil: +355 67 2288016 email: ethnic12alb85@yahoo.com

Firma ILIRIA sh.p.k. me qendër në Shkodër

Pajisje për ambjente lokalesh
Prodhim dyer e dritare
Dhma fëmijësh, Pajisje kuzhine
Pajisje zyrash, Dhma gjumi

Mobil: 00355 (0) 69 2523565



Tel: 029 242 132 / Mob: 044/049 280 502
Rr. Sheshi i Lidhjes nr. 7 / E-mail: kamaciciban@hotmail.com

ORDINANCA SPECIALISTIKE GJINEKOLOGJIKE “GJENEZA”



Dr. Bleita Baruti Domi
Gjinikologe - Obstetër

Rr. "M. Frashëri" nr. 82 GJAKOVË
(përballë Medresës Madhe - Rr. e Cabavit)
Tel. 044 253 604; 0390 329 404
email: bleita_gym@hotmail.com



Lubizhdë - Prizren
Tel/Fax: +381 (0) 29 240 093
Tel/Fax: +381 (0) 29 44 974
Mob : +377 (0) 44 119 631

Xhelall Miftari
Director

Këtu mund të ishte
reklama juaj!

Këtu mund të ishte
reklama juaj!



Office: Tel: ++381(0)390/324 026
Fax: ++381(0)390/324 135
Mob: +377(0)44/134 498
Mob: +386(0)49/134 498
Mob: +377(0)44/204 150
Mob: +386(0)49/204 150
e-mail: info@wearandgojeans.com
wearandgojeans@hotmail.com
www.wearandgojeans.com
Rr./Str. "Skenderbeu" p.n. n.n
Gjakovë - Kosovë

WEAR & GO

Jeanswear Company

Predhojmë të gjitha llojet e
veshjeve të jashtme nga Tekstili !!!

AUTO ELITE

QENDËR RIPARIMI AUTOMJETESH



Tregon pjesë këmbimi shumicë-pakicë

- Distributor i autorizuar i Shell.al

Ofiçinë mekanike

- Sistem kolaudimi i 2010 CE
- Gomisteri - Konvergjencë
- Motorrist - Pompist
- Diagnositifikim elektronik multimarkë



vita
milk qumësht

Burim i jetës

3,2%

Ynydëri qumështi / milk fat

vita
qumësht milk

Dumështi me vata të gjithë
më i shëndetshëm i produksionit
industriale. Perputhen
kohë të gjatë.
ushqyece, të jetë
i pakëtuar me
shumë vitamine
mineralet dhe
mund i
qumështit
burim i

Long
indus
high



N.P. "LUX DEKOR" - Prizren

NRB: 80249179, adresa: rr. Tirana p.n. (zona industriale ish - Voqare)
e-mail: luxdekor4@hotmail.com, tel/fax : + 381 29 242 174, mob.: (vala + 377)&(ipko + 386) 198 709, 141 253



prodhues i KUZHINAVE



D prodhues i **KOMODA**
D rregallave, **D** ioma tē fjetjes, **D**



D prodhues i **KOMODA**
D paradhoma dhe tē gjitha llojet e orendive shtëpiake dhe zyre



D prodhues i **KUZHINAVE**

Lux Dekor është firmë private e specializuar për prodhimin e KUZHINAVE si dhe orendive të ndryshme shtëpiake dhe të zyreve, bën shitjen e materialit - iverëplaka, mdf, folje për vakum press, dhe të aksesoarëve përcjellëse për mobiljeri. Bën prodhimin e balloreve - m veshjen me ultrplast - Laminat, si dhe plastifikimin VAKUM PRES - BALLONPRESS te balloreve me folje te pvc-se në dimenzone të kerkuara nga

KLIENTI, GRAVIRIM IN e fronteve me makinë CNC, kandim in - qitjen e shiritëve pvc dhe abs, prerjen e pllakave, të gjitha keto kryhen me makina te persosur kualitet dhe cilësi te lart.



INDUSTRIA USHQIMORE - PRIZREN
FOOD INDUSTRY - PRIZREN



Industria Ushqimore
"ABI & ELIF 19"
Zona Industriale rr. Tirana nr. 9.
20000 Prizren, Kosovë
tel&fax: +38129242433
tel&fax: +38129222322
tel&fax: +38129244005
e-mail: info@abielf19.com
<http://www.abielif19.com>

